

Konferencë Drita për NATO në fund të tunelit

Fq.3



ME MANDAT TË RREGULLT Pollozhani zgjidhet Rektor i UNT-së

Fq.4



IKARDI Nuk besoj se do të luajë në Botëror

Fq.21



Koha

www.koha.mk



Vrasësit elitë të Hitlerit

Fq.12

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3352 · e premte 27 prill, 2018

14°C | 27°C

15 DEN

EDITORIAL

A po zbehet fuqia e krahasimit?



Shumë vite e dekada më parë, ngjarje e zhvillime të bujshme në Kosovë, merreshin si model dhe frymëzonin shtresa të shumta njerëzish në Tetovë, Dibër, Strugë, Kërçovë... Ishte '68-ta, vit ky që koïncidonte me dy ngjarje të mëdha - me 500-vjetorin e vdekjes së Gjergj Kastrioti Skënderbeut dhe organizimit të demonstratave të mëdha të rinisë shqiptare të Kosovës. Si fëmijë, me kureshtjen e nxënësit të fillores, ende i kam...

Fq.2

MOZAIK

Youtube "mbron" dhunën izraelite

Fq.13

RAJON

Porosia gjer- mane për Ramën: Nise me Saimir Tahirin...

Fq.14



PROTESTË PARA GJYKATËS PENALE, ZAEVI PËRGJIGJET NË PARLAMENT

HETIM SHITESË PËR "MONSTRËN"



"Babai i njërit prej djemve të vvarë ka pasur mundësi sepse janë prindër të shohë si personi i akuzuar Fejzi Aziri bisedon me kryetarin e atëhershëm të Gostivarit, Nevzat Bejta, duke e lutur t'i paguhen subvencionet dhe këtë e ka parë, e kanë parë edhe të gjithë dhe ashtu është dorëzuar. I ka parë madje edhe telefonat të cilat gjoja ishin fshehur...", tha Zaevi

Fq.5

Revizorët s'ka kush i dëgjon

Shkup, 26 prill - Enti Shtetëror për Revizion ka kryer mes 50 dhe 60 revizione në vit për institucione të ndryshme dhe jep rekomandime për përmirësimin e punës së tyre, ndërsa atje ku do të konfirmojë punë joligjore ose ka dyshim për punë joligjore, e ndjek raportin deri te Prokuroria Publike, Komisioni Antikorrupsues dhe Ministria e Punëve të Brendshme. Gjatë vitit 2016 dhe 2017 në bazë të raporteve të tilla

janë ngritur procedura parahetimore, ndërsa janë caktuar akuzat për kundërvajtje. Këtë e potencuan pjesëmarrësit në debatin e djeshëm të titulluar "Implementimi i rekomandimeve të Entit Shtetëror për Revizion, prioritet i lartë shoqëror". "Problem kyç është që në një pjesë të madhe të raporteve të Entit Shtetëror për Revizion ka mungesë të veprimit sipas rekomandimeve përkatësisht për rreth...

Fq.7



EDITORIAL

A PO ZBEHET FUQIA E KRAHASIMIT?



Emin AZEMI

Disa të frikësuar nga humbja e primatit opozitar, nuk po ofrojnë kurrfarë hapësire për të zëvendësuar njëtrajtshmërinë pushtetore me ide të reja, më aktive, e më energjike...

Shumë vite e dekada më parë, ngjarje e zhvillime të bujshme në Kosovë, merreshin si model dhe frymëzonin shtresa të shumta njerëzish në Tetovë, Dibër, Strugë, Kërçovë... Ishte '68-ta, vit ky që koincidonte me dy ngjarje të mëdha - me 500-vjetorin e vdekjes së Gjergj Kastrioti Skënderbeut dhe organizimit të demonstratave të mëdha të rinisë shqiptare të Kosovës. Si fëmijë, me kureshtjen e nxënësit të fillores, ende i kam të fiksuara imazhet dhe jehonat e atyre ngjarjeve. Gjashtëdhjeteteta, flamuri, Demaçi, Gjergj Kastrioti, Universiteti, Rilindja, Republika, Kosova po thadroheshin në kujtesën tonë si arketipa që s'mund t'i gjenim në librat oficiale shkollor.

Pastaj shumë ujë kaloi nën urë. Vite e dekada u rrokullisën mbi pelgun e gjerë të kohës, duke fundosur mbetjet e një kohe të pakthim, në njërin anë dhe, duke mbajtur në sipërfaqe idetë që do të lëvizin levat e proceseve të rëndësishme kombëtare, në anën tjetër.

Të diplomuarit në Prishtinë u kthyen në Maqedoni. Disa ngelën në Kosovë... disa u bënë emra, disa të tjerë u bënë viktimë të ambicieve të tyre të tepruara dhe joreale... thjesht u tretën në 'ujin' e sertë të konkurrencës... Por, ajo që ngel e pakontestuar është fakti se shumë ngjarje që do të zhvillohen në hapësirën shqiptare në Maqedoni, do të kenë vulën e intelektualëve të shkolluar në Prishtinë. Thjesht, refleksioni i gjithë asaj energjie iluministe që akumulohet në Kosovë, gjente mënyra e sebepe të zbrazet në Maqedoni. Ngjarjet madhore (UT dhe UÇK), ishin dy shtyllat e larta të risementazimit të një krenarie të fjetur kombëtare, që me kalimin e kohës, në momente e rrethana të caktuara, derivuan nga idetë sublimë në trajta "pragmatike" të përfitimeve të çastit.

Shumëkush, nëse jo publikisht, së paku në vete, është pyetur këto vitet e fundit - a thua janë shterur modelet e Kosovës në Maqedoni? Apo, ndoshta, ato modelet u përdorën vetëm sa për të instaluar një komoditet të radhës, që hëpërhe, po faturohet vetëm si arritje kulmore që nuk ka nevojë për oponencë, për kontestim, për garim idesh e veprimesh alternative?

Mendimi ndryshe. Kush e përfaqëson në Maqedoni? Ose, ata që pretendojnë se po mendojnë ndryshe sa ka të ngjarë që me apo pa vetëdije t'i djegin shanset e një alternative të njëmendët. Disa të frikësuar nga humbja e primatit opozitar, nuk po ofrojnë kurrfarë hapësire për të zëvendësuar njëtrajtshmërinë pushtetore me ide të reja, më aktive, e më energjike, pos që ëndërojnë në zëvendësojnë partnerin e tanishëm shqiptar me vetveten. Naivitetin e sotëm duan ta zëvendësojnë, nesër, me inferioritetin e tyre.

Nëse në kohë më të vështira dinim të huazonim modelet për të rivitalizuar jetën kombëtare këtu, tani, në kohë të qeta, po del se te-tovarët e pasticherive në Maribor, Split, Poreç, Sarajevë po tregohen më vigjilent kundrejt kauzës kombëtare, sepse vetëm ata nuk po e këmbëjnë zanatin e tyre ballëdjersitur me favorët që të jep revolucionin i ndryshimit të biografive brenda natës.



"MOS LEXONI SHUMË SE BAHNI BUDALLË"

"E kam pasë ni shkok i cili lexojke shumë. Kurrë nuk u nalke tu lexu. Lexo, e lexo ... dikur teptisi e lujti pi menve. Krejt mahalla bajshin hajgare me te. Me ju thanë t'drejten, u ba mirë për mue se e pashë se çka po bojka vaki me ata që lexojnë shume. E ndala hovin e leximit se edhe une bukur marakli jam konë. Ama, une tash jam saksalem pi menëve se e kom rujtë vetin. Kesh t'u shku posht edhe une. Porosia: Mos merni shumë yrysh n'lexim se bahni budallë si ai shoku jem", shkruan në profilin e tij në Facebook, publicisti nga Londra, Daut Daut.

INTELEKTUALI I SODIT

"T'i thuash vetit intelektual dhe mos të guxosh kurrë të shprehesh as edhe një mendim apo qëndrim tëndin për ndonjë fenomen apo ndodhi, është diçka e palogjikshme! Nëse ato titujt e shumtë shkencorë, me të cilët ke përfitu skajshmërisht duke u krekos vend e pa vend, nuk shërbejnë sadopak për të mirën e përgjithshme, atëherë ti je veç një bythaxhi i pangopur. Respektoj njerëzit me qëndrime të qarta, edhe atëherë kur mendoj se e kanë gabim!", shkruan në profilin e tij në FB, dr.Selver Jashari.

NISI PAGESA E DËMEVE

"Sot u paguan 85 milionë denarë dëmshpërblime për rajonin e Resnjës, i cili ishte më i godituri nga ngricat e vitit 2017. Gjithsej 2355 fermerë nga Resnja të cilët kanë pësuar humbje tani mund ti marrin paratë e tyre. Me këtë pagesë filloi dëmshpërblimi dhe do të paguhen mbi 4 milionë euro për dëmshpërblimin e 17.500 aplikantëve në të gjitha rajonet e prekura nga fatkeqësitë e motit të vitit 2017. Bëhet fjalë për fatkeqësitë natyrore të cilat ndodhën në prill, dy fatkeqësi natyrore në qershor, korrik dhe shtator të vitit 2017, të përcjella me reshje të dendura të shiut, shi intensiv, erë e fuqishme, shkarkime elektrike, breshër. Me fatkeqësitë natyrore u kapluan 36 komuna", shkruan në profilin e tij në FB, sekretari shtetëror në Ministrinë e Bujqësisë, Nefrus Çeliku.

TE VARRI I ALIJA IZETBEGOVIC DHE TE MONUMENTI I 1601 FËMIJËVE TË VRARË NË SARAJEVË

"Gjenocidi në Kosovë i pranverës së vitit 1999, u zbatua nga operacioni ushtarak i Serbisë 'Patkoi' i cili i dëboi rreth 860 mijë shqiptarë nga Kosova dhe vrau afër 10 mijë civilë të paarmatosur. Gjenocidi në Sarajevë u zbatua përgjatë gati katër vjetëve, saktësisht 1.425 ditëve, aq sa zgjati rrethimi i hekurit i qytetit. U vranë 11.541 civilë (nga të cilët 1.601 fëmijë) kurse u plagosën a lënduan mbi 50 mijë të tjerë. Për çdo ditë mbi qytet binin mesatarisht 329 granata. Gjatë qëndrimit në Sarajevë bëra nderim dhe vendosa lule të freskëta te varri i kryetarit të parë të B&H, Alija Izetbegovic, dhe te monumenti i fëmijëve sarajevas të vrarë gjatë luftës", shkruan në profilin e tij në Facebook, lideri i Vetëvendosjes, Albin Kurti, duke publikuar foto nga vizita e varreve të civilëve të vrarë në Sarajevë.



MEDIA Citate

Pa normalizim të marrëdhënieve, Kosova e Serbia nuk afrohen me BE-në

Presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk ka porositur institucionet kosovare që të angazhohen në normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë si dhe zbatimin e marrëveshjeve të arritura në bisedime, në të kundërtën Kosova nuk mund të avancojë drejt Bashkimit Evropian. Gjatë vizitës së tij në Prishtinë, Tusk tha se Kosova ka shënuar progres duke veçuar kështu votimin në Kuvend të marrëveshjes për demarkacionin me Malin e Zi. Mirëpo, sipas Tusk, ende mbetet punë për tu bërë, sidomos në procesin e bisedimeve me Serbinë. "Pa një normalizim gjithëpërfshirës të marrëdhënieve me Serbinë dhe implementim të plotë të marrëveshjeve, unë nuk di se si mund të arrihet përparim në raportet me Bashkimin Evropian. E di se do të jetë e vështirë, por unë ende jam optimist, dhe pas takimit të djeshëm me Aleksander Vuçiqin dhe takimit të sotëm me presidentin tuaj jam më optimist", ka deklaruar presidenti, Donald Tusk. Presidenti Tusk, tha po ashtu se vizita në rajon kishte për qëllim parapërgatitjet për Samitin për Ballkanin Perëndimor që do të mbahet me 17 maj në Sofje të Bullgarisë. Këto komente, Tusk i bëri pas takimit me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, i cili deklaroi se ai është i përkushtuar ndaj procesit të dialogut mes Kosovës e Serbisë. Presidenti Thaçi, tha se procesi i bisedimeve duhet të përfundojë me njëhje reciproke mes të të dyjave vendeve. "Me presidentin Tusk u pajtuam që është krijuar një momentum pozitiv dhe se ka shumë gjëra që mund t'i bëjmë së bashku, por natyrisht se duhet të kalohen pengesat politike. Në këtë drejtim folëm për përkushtimin tonë në procesin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet shtetit të Kosovës dhe të Serbisë të lehtësuar dhe udhëhequr nga Bashkimi Evropian".

(REL, 26 prill)

NËSE NUK E KENI DITUR...

ÇFARË DIHET PËR MALIN E TOMORIT?

Tomori është një nga malet më të larta e më të njohura të Shqipërisë në kufirin midis rrethit të Beratit, Skraparit dhe pjesërisht Gramshit me lartësinë më të madhe 2416 m (Çuka Partizani), me gjatësi 19 km dhe gjerësi 6 km. Në jug qafa e Kulmakës e ndan nga mali i Kulmakës. Dallohet për lartësinë e madhe relative ndaj

trevës përreth dhe nga majat e shumta mbi 2000 m. Relievi i Tomorit është i ashpër, me maja të mprehta e të dhëmbëzuara, rrëpira e gremina qindra metra të thella. Nga këmbët e tij dalin burime të shumta e të fuqishme karstike (Sotirë, Kërpicë, Ujanik Kapinovë, Bogovë etj.) Është qendër e ushtrimit të sporteve dimërore dhe alpinizmit.

KONFERENCË PËR INTEGRIMIN EUROATLANTIK DHE SFIDAT

DRITA PËR NATO NË FUND TË TUNELIT

Çelësi për integrimin e vendit në NATO gjendet në procesin e reformave inkluzive që do të duhet të ndërmarrë Maqedonia, me përfshirjen e gjithë shoqërisë, kthimin e besimit tek institucionet që duhet të respektojnë të drejtën dhe standardet profesionale, si edhe zgjidhjen e kontestit për emrin me Greqinë dhe përmirësimin e marrëdhënieve me Bullgarinë



NATO-n në Shkup, Gorazd Bartol, është decid sa i takon interesimit të Aleancës Veriatlantike për të bashkëpunuar me vendet që nuk janë anëtare. Edhe për të kyçi qëndron tek progresi i vendit në sferën e reformave, zgjidhjen e kontestit për emrin dhe përmirësimin e marrëdhënieve me Bullgarinë.

"Është një parim bazë që vend suveren të ketë të drejtë të zgjedhë rrugën e vet dhe Shkupi zgjodhi që

të jetë anëtare të NATO. Reformat, të cilat janë të domosdoshme për anëtarësim, janë të ndërlikuara dhe të vështira, kërkojnë kohë e para, megjithatë shtetet anëtare të NATO posedojnë potenciale ekonomike, por edhe mundësi për të marrë vendime politike", ka thënë Bartol. Çelësi për integrimin e vendit në Nato gjendet në procesin e reformave inkluzive që do të duhet të ndërmarrë Maqedonia, me përfshirjen e gjithë

shoqërisë, kthimin e besimit tek institucionet që duhet të respektojnë të drejtën dhe standardet profesionale. Me këtë mesazh ambasadori i Gjermanisë, Tomas Gerberih iu drejtua pjesëmarrësve në konferencë.

"Jo vetëm që drita në fund të tunelit është e qartë, por edhe me orientimin e duhur. Ndërsa roli kyç i mbetet procesit të reformave. Për disa reforma të caktuara nevojitet kohë që të zbatohen dhe angazhim

më i madh. Shoqëria gjendet përballë një procesi të madh rikonstruktues, si politik, ashtu edhe ekonomik. Dhe këto reforma janë të vështira dhe jo gjithmonë shumë popullore, por në interes të vendit dhe qytetarëve", është shprehur Gerberih.

Vlerësimet pozitive nga raporti më i fundit i Komisioni Evropian sipas Viktor Dimovski, sekretar shtetëror në MPJ janë nxitëse për Maqedoninë dhe realizimin e aspiratave për integrim. Po ashtu edhe vizitat e përfaqësuesve më të lartë të NATO dhe BE.

"Mogerini tha se për një kohë të shkurtër ne arritëm shumë, komisionari Johannes Han tha se Maqedonia duhet të merret si shembull për ndryshimet demokratike dhe për këtë KE na dha rekomandim të pakushtëzuar që të fillojmë bisedimet për hyrjen në NATO. Maqedonia është në rrugë të mbarë", tha Dimovski. Sipas tij, përsheptimi i proceseve euroatlantike dhe anëtarësimi i Maqedonisë nuk është thjesht në interes të vendit dhe qytetarëve të saj, por edhe mënyra më e mirë për të ruajtur stabilitetin në rajon është.

Hyrja e Maqedonisë në fazat më të avancuara të integritimeve euroatlantike mund të arrihet vetëm me angazhimin e brendshëm të forcave politike, ka deklaruar Steve Pendarovski, koordinatori nacional i NATO. Sipas tij, ky proces nuk mund të konsiderohet si një dhuratë, por produkt i një satisfaksioni politikanësh të përgjegjshëm.

Koha

Evis HALILI

Shkup, 26 prill - Vazhdimi i procesit të pakompromis të reformave, zgjidhja e çështjes së emrit me Greqinë janë disa prej sfidave që duhet të kapërcehen për të përsheptuar integrimin e vendit në Aleancën Veriatlantike. Kështu deklaruan pjesëmarrësit në konferencën e Institutit të hulumtimeve gjeostrategjike dhe politikës së Jashtme në Ministrinë e Punëve të Jashtme, "Integrimi Euroatlantik, sfidat e reja dhe shanset", organizuar në bashkëpunim me Qendrën e studimeve të sigurisë Xhorxh Marshall.

Shefi i zyrës së lidhjeve me

STOLTENBERG: PËR ANËTARËSIMIN NË NATO NUK VENDOS RUSIA

Sekretari gjeneral i NATO, Jens Stoltenberg ka deklaruar se vetëm Maqedonia dhe 29 vendet e tjera anëtare mund të vendosin për anëtarësimin e vendit në Aleancën e Veriatlantikut. I pyetur lidhur me deklaratat e ambasadorit rus në Maqedoni se vendi mund të shndërrohet në një "shënjestër legjitime" në rast të një konflikti nëse do të anëtarësohej në NATO, Stoltenberg i komentoi si qëndrime të kundërta me angazhimet e NATO. "I gjithë koncepti se Rusia nuk do të pranojë anëtarësimin e disa vendeve në NATO është ide e sferave të ndikimit, ku

fuqi të mëdha duan të kontrollojnë shtetet më të vogla. Para së gjithash është e rëndësishme që çdo vend të zgjedhë vetë rrugën dhe marrëveshjeve të sigurisë, princip ky fundamental i NATO. Por edhe Rusia u angazhua për këtë princip me disa marrëveshje, si ajo e Helsinkit, e dokumente të tjera. I takon Shkupit të vendosë për rrugën e vet dhe nëse do të bëhet pjesë e Aleancës. Maqedonia dhe 29 vendet e tjera anëtare vendosin për këtë dhe askush tjetër nuk ka të drejtë të ndërhyjë në këtë proces", ka thënë Stoltenberg.

KITAROVIQ ARRIN NË SHKUP

Çështjet bilaterale paralelisht me eurointegrimet

Shkup, 26 prill - Maqedonia dhe Kroacia kanë marrëdhënie jashtëzakonisht të mira pa çështje të hapura. Kroacia është mbështetëse e madhe e Maqedonisë në rrugën e saj drejtë BE-së dhe NATO-s dhe do të bëjë gjithçka që sa më shpejt ta përfundojë. Çështjet e hapura me vendet e tjera nuk duhet të jenë pengesë në këtë rrugë. Ato mundën dhe duhet të zgjidhen paralelisht me mbajtje të negociatave për anëtarësim në BE. Ky është vlerësim i përbashkët i presidentëve të Maqedonisë dhe Kroacisë, Gjorge Ivanov dhe Kolinda Grabar Kitarović i dhënë pas takimit të tyre në Shkup. "E përshëndesim rekomandimin e KE-së për hapjen e negociatave inkadruese për anëtarësimin e RM-së në BE, dhe Kroacia do të bëjë gjithçka që është në dorën e saj deri në qershor të sillt vendim për datën e fillimit të negociatave", tha Grabar Kitarović në konferencën për media pas takimit. Ajo theksoi se



Kroacia do të vazhdojë ta mbështesë Maqedoninë në Këshillin e BE-së të sillt vendim për fillimin e negociatave, siç tha, si në drejtim të diplomacisë së hapur, ashtu edhe pas dyerve të mbyllura, përmes krijimit të koalicioneve të shteteve të cilat vlerësojnë se Maqedonia duhet t'i fillojë negociatat, përmes planifikimit të aktiviteteve të përbashkëta, argumentimit dhe bisedave me ato vende të cilat me këtë nuk dakordohen. Grabar Kitarović vlerëson se çështjet e hapura bilaterale jo vetëm që mundën por

duhet të zgjidhen paralelisht me eurointegrimin. "Mendoj se duhet të tregohet pjekuri dhe gatishmëri e dialogut me respekt të ndërsjellë dhe respektim të së drejtës ndërkombëtare për problemin e të dy vendeve t'i gjejnë vetë pa imponim të zgjidhjeve prej anash", tha Grabar Kitarović. Ajo thotë procesi i zgjerimit duhet të vazhdojë dhe se me ngecjen krijohet vakum i rrezikshëm të cilin do ta plotësojnë palët e treta të cilat nuk kanë interes nga progresi i vendit në rrugën e anëtarësimin të BE dhe

TAKIMI I VJENËS, TAKIM LIDERËSH NUK ËSHTË PLANIFIKUAR

Presidenti i Republikës së Maqedonisë, Gjorge Ivanov, deklaroi se nuk ka informata për rrjedhën e bisedimeve të djeshme për kontestin me emrin që në Vjenë i zhvilluan ministrat e Jashtëm të Maqedonisë dhe Greqisë, Nikolla Dimitrov dhe Nikos Koxias, nën patronatin e ndërmjetësit të KB-së, Methju Nimic. Ivanov theksoi edhe se tani për tani nuk është planifikuar mbajtja e takimit të liderëve. "Nga takimi i djeshëm ende nuk kemi kurrfarë informata. Për tjetër çka është biseduar duhet ta pyesni ministrin e Punëve të Jashtëm dhe këtë çështje t'ia parashtroni Qeverisë", deklaroi presidenti Ivanov duke u përgjigjur në pyetjen e gazetarëve në konferencën për shtyp pas takimit me kolegën e tij kroate, Kolinda Grabar-Kitarović.

NATO, gjë për të cilën, siç tha, është i vetëdijshëm edhe Unioni. Sipas Ivanovit, për t'u përshëndetur është qëndrimi i Republikës së Kroacisë se kontestet bilaterale nuk duhet të jenë pengesë në rrugën euroatlantike. "Në rajonin tonë ekziston përvojë pozitive e lëvizjes paralele të negociatave për gjetjen e zgjidhjes së përbashkët për çështje të hapura. Ky është shembulli mes Republikës së Kroacisë dhe Republikës së Sllovenisë, i

cili mund të zbatohet në rastin me Republikën e Maqedonisë", theksoi presidenti i Maqedonisë. Ai tha se në takimin me presidenten Grabar Kitarović kanë këmbyer mendime për mundësitë për bashkëpunim edhe në sfera të tjera të interesit të përbashkët. Janë dakorduar se ka potencial të pashfrytëzuar për thellimin e bashkëpunimit ekonomik mes të dy vendeve dhe se duhet të punohet në avancimin e tyre.

Me 11 vota "për", asnjë kundër dhe asnjë të përmbajtur, Senati i Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup ka zgjedhur ushtruesin e detyrës së rektorit, prof.dr.Aziz Pollozhanin Rektor me mandat të rregullt katër vjeçar

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 26 prill - Siç edhe pritej, prof.dr.Aziz Pollozhani është zgjedhur të enjten Rektori i parë me mandat të rregullt katër vjeçar i Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup. Në garën për këtë post, Pollozhani ishte kandidati i vetëm i propozuar nga Fakulteti Teknologjik, ku paraprakisht i është dhënë edhe thirrja akademike profesor i rregullt.

Kandidatura e Pollozhanit ishte mbështetur në mënyrë unanime dhe nga Fakulteti i Informatikës, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, Fakulteti Teknik dhe Fakulteti i Shkencave Sociale, duke i dhënë në këtë mënyrë mbështetje Programit të Punës për periudhën 2018-2022, të cilin e kishte prezantuar në këshillat mësimore-shkencore të fakulteteve në fjalë. Emërimin me mandat katër vjeçar në pozitën e Rektorit e ka konfirmuar edhe organi më i lartë akademik, Senati i UNT-së ku në votim të fshehtë, sikurse bëri të ditur prof.dr.Suzana Aliu, kryetarja e Komisionit për mbikëqyrjen e procesit dhe numërimin e votave, kandidati Pollozhani mori të gjitha votat. "Nga 11 anë-

TANI EDHE ME MANDAT TË RREGULLT KATËRVJEÇAR



POLLOZHANI ZGJIDHET REKTOR I UNT-së

tarë të Senatit, 11 votuan 'pro', asnjë kundër dhe asnjë i përmbajtur.

Nga cilësia e kryetares, më bie në hise mua ta shpall prof.dr.Aziz Pollozhanin për Rektor të UNT-së", tha ajo. Duke i dëshiruar Rektorit suksese në punën e tij katër vjeçare, Aliu ka kërkuar nga anëtarët tjerë të Senatit që ti rrinë për krah Rektorit në realizimin e Programit 2018-2022. Prof.dr.Pollozhani, zgjidhet me mandatin e rregullt katër vjeçar të rektorit të UNT-së pas ushtrimit për dy vite të detyrës së Rektorit, pra ushtruesit të detyrës ku ishte caktuar nga Senati i përkohshëm i UNT-së. Ky Universitet e konsolidoi Senatin me anëtarë me mandate të rregullta më 13 prill, ndër-

sa dhjetë ditë para kësaj, Parlamenti që është edhe themeluesi i këtij Universiteti, kishte miratuar Statutin e tij.

UNT u themelua në 24 dhjetor të 2015-ës, kur Parlamenti miratoi Ligjin për themelimin e këtij universiteti, ndërsa nisi me punë më 27 tetor të 2016-ës. Deri më 4 prill të 2018-ës, Universiteti funksiononte me Statut dhe organe të përkohshme, ndërsa pas miratimit të Statutit, në atë datë iu hap rruga konsolidimit këshillave mësimore-shkencore, organizatës së studentëve, Senatit dhe emërim të rektorit me mandate të rregullt katër vjeçar. Prof.dr.Pollozhani është i pari rektor me mandat të rregullt në UNT, por i fundit që zgjidhet me mandat katër vjeçar,

pasi zgjedhja e tij është bërë sipas Ligjit ende në fuqi të arsimit të lartë.

Siç dihet, në Parlament është në procedurë e sipër nxjerrja e Ligjit të ri për arsim të lartë në Maqedoni, ku mes shumë ndryshimeve, është edhe ai që ka të bëjë me mandatet e rektorëve. Sipas propozim-ligjit në fjalë, mandatet e rektorëve nuk do të jenë katër, por tri vjeçare, me të drejtë rizgjedhje edhe për një mandate. Pra në total, Rektorët e universiteteve nuk do të mund të qëndrojnë në këtë post më tepër se gjashtë vjet, për dallim prej Ligjit në fuqi që ua mundëson të njëjtën deri në tetë vjet, respektivisht 10 vjet nëse llogarisim këtu edhe mandatet e përkohshme,

apo të ushtruesit të detyrës së rektorit, sikurse është rasti me rektorin e UNT-së.

Në pesë fakultetet dhe 19 programet studimore të UNT-së, gjatë dy viteve të kaluara janë regjistruar 240, respektivisht 500 studentë. Janë punësuar deri tani 72 profesorë me thirrjet e nevojshme shkencore, ndërsa pritet leja për punësimin e 11 profesorëve të tjerë, për vendet që nuk u realizuan në konkursin e vitit të kaluar. Për mungesë të objekteve të veta, Universiteti është i shpërndarë si qiraxhi në godinën e Lidhjes të Sindikatave të Maqedonisë, afër Qendrës së Vjetër Tregtare dhe në hapësirat e Shkolës Filllore "Kongresi i Manastirit", në Komunën e Çairit.

Arrestimi i deputetëve, me kërkesës të prokurorisë

Shkup, 26 prill - Të gjitha urdhrat për arrestime për dhunën nga 27 prilli në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë janë dhënë nga gjykatësi në procedurë paraprake në bazë të kërkesës paraprake të prokurorit publik për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Ndërsa lidhur me deputetët, nuk bëhet fjalë për parburgim por për arrestim, deklaroi ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski duke u përgjigjur në pyetjet e deputetëve.

"Deputetët në Kuvendin e Maqedonisë kanë imunitet funksional, jo imunitet material. Edhe imuniteti funksional nënkupton mosmiratim të parburgimit pa i miratuar Kuvendi vendimet për heqjen e imunitetit. Këtu nuk bëhet fjalë për parburgim, por



për arrestim, ndërsa në bazë të rregulloreve me të cilat punon MPB-ja për mënyrën në të cilën u arrestuan të gjithë nga ngjarjet e 27 prilli, thuhet se gjatë arrestimit, mbahet llogari e veçantë për të miturit, personat me aftësi të kufizuara dhe gratë shtatzëna", tha Spasovski. Persona të tillë, sipas ministrit të Punëve të Brendshme, nuk ka pasur në ato që u

arrestuan. "Veçanërisht deputetët - nuk janë as të mitur, as të paafte, mundeshin t'i hapin dyert me dy duar në Kuvend, as gra shtatzëna nuk ka pasur. Dhe në këtë pjesë është bërë menjëherë kontrolli i brendshëm Sektorit i kontrollit të brendshëm ka vepruar pa dhënë ndonjë drejtim për punë të tillë dhe raporti është dhënë deri te

Avokati i Popullit të Republikës së Maqedonisë", theksoi Spasovski. Sipas tij, Avokati i Popullit ka të drejtë të vlerësojë, i ka marrë të gjitha aktet, të gjitha dispozitat, urdhrat nga gjykatësi dhe mund të vlerësojë dhe të sjellë raporte. "Vetëm tregoj se në bazë të të gjitha dispozitave ligjore dhe normave policia ka vepruar në bazë të Ligjit, Kushtetutës dhe akteve nënligjore në bazë të të cilave ne veprimë", tha ministri.

Spasovski tha se për akuzat për arrestimin e deputetëve nga policia ka dhënë disa herë përgjigje, por përgjigje edhe njëherë siç tha duke iu drejtuar deputetëve nga VMRO-DPMNE, në "natën e 27 prillit kur organizuat dhe e sulmuat Kuvendin dhe e prishët rendin kushtetues të Republikës së Maqedonisë.

300 deri 650 euro dënim për prindërit që nuk vaksinojnë fëmijët

Shkup, 26 prill - Dënimet e 130 prindërve që vjet refuzuan t'i vaksinojnë fëmijët e tyre do të sillen prej 300 deri në 650 euro. Kështu thonë nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor. Për prindërit kanë tre opsione: të paguajnë dënimin, të vaksinojnë fëmijët ose të përfundojnë në gjykatë. Të dhënat tregojnë se gjatë periudhës së fundit prindërit në hapësirat urbane më së paku i kanë vaksinuar fëmijët, me çka imunizimi ka rënë dhe kjo e ka futur Maqedoninë në grupin e shteteve me rrezik të sëmundjeve të ndryshme. Personat mjekësorë sqarojnë se mbrojtja e fëmijëve bëhet me vaksinim dhe kjo ndikon në fuqizimin e imunitetit.

"Babai i njërit prej djemve të vuarë ka pasur mundësi sepse janë prindër të shohë si personi i akuzuar Fejzi Aziri bisedon me kryetarin e atëhershëm të Gostivarit, Nevzat Bejta, duke e lutur t'i paguhen subvencionet dhe këtë e ka parë, e kanë parë edhe të gjithë dhe ashtu është dorëzuar. I ka parë madje edhe telefonat të cilat gjoja ishin fshehur...", tha Zaevi

PROTESTË PARA GJYKATËS PENALE, ZAEVI PËRGJIGJET NË PARLAMENT

HETIM SHITESË PËR "MONSTRËN"



Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 26 prill - Zbulimi i së vërtetës për vrasjen e pesëfishtë afër Liqenit të Smilkovës më 12 prill të vitit 2012 dhe dënime për kryesit, kërkuan dje pjesëmarrësit e protestës para Gjykatës penale në Shkup. Qindra qytetarë porositën që gjykata dhe institucionet e tjera kompetente ta konfirmojnë të vërtetën dhe t'i dënojnë fajtorët për rastin e njohur si "Monstra". Kërkuan nga kryeministri Zoran Zaev t'i zbulojë informatat për këtë lëndë, për të cilën ka thënë se i posedon derisa ishte në opozitë. Në protestë nuk ishin të pranishëm të afërmit e të vuarëve. Disa prej tyre edhe parapakisht thanë se nuk do të marrin pjesë në protestë dhe se nuk duan të keqpërdoret vdekja e fëmijëve të tyre.

Megjithatë, pjesëmarrësit nuk thanë se kush është organizuesi i protestës. Thonë se janë organizuar me vetëiniciativë përmes rrjeteve sociale. Në ndërkohë, protestuesve dhe deputetëve të opozitës i është përgjigjur kryeministri Zaev. "Nëse do të kishte dëshmi konkrete, besoni, si çdo bombë ashtu edhe këtë bombë do ta publikojë deri në fund. Por, atje ka indikacione serioze dhe obligimi im para së gjithash si qytetar dhe në atë kohë si shef i opozitës, është që komplet t'i dorëzoj tek Prokuroria Speciale Pu-

blike", deklaroi Zaevi, duke u përgjigjur në pyetje të gazetarëve për atë nëse ka dëshmi që mund ta zbardhin vrasjen e pesëfishtë tek Liqeni i Smilkovës të njohur si rasti "Monstra". Deputeti i VMRO-së, Zoran Iljoski, në seancën për pyetje të deputetëve, e akuzoi Zaevin se po manipulon me ndjenjat e prindërve të djemve të vuarë dhe se ka përgjegjësi morale për të thënë pse e bën këtë dhe nëse me të vërtetë ka dëshmi me të cilat do të zbardhet vrasja te Liqeni i Smilkovës.

Zaevi ndërkohë ishte i drejtpërdrejtë se dëshmitë nga fillimi deri në fund dhe gjithçka tjetër që ka poseduar janë dorëzuar deri tek PSP-ja dhe se me to është njoftuar edhe babai i njërit prej djemve të vuarë. "Babai i njërit prej djemve të vuarë ka pasur mundësi sepse janë prindër të shohë si personi i akuzuar Fejzi Aziri bisedon me kryetarin e atëhershëm të Gostivarit, Nevzat Bejta, duke e lutur t'i paguhen subvencionet dhe këtë e ka parë, e kanë parë edhe të gjithë dhe ashtu është dorëzuar. I ka parë madje edhe telefonat të cilat gjoja ishin fshehur. Pse?

Për atë që ndoshta nuk kam të drejtë publikisht të publikoj të dhëna tjera, por kam të drejtë njërit prej prindërve i cili e ka humbur fëmijën e vet, këtë t'ia tregoj", theksoi Zaev.

Prindërit e viktimave, siç tha kryeministri, meritojnë hetim shtesë në këtë rast, sepse ka edhe dëshmi shtesë që duhet të hetohen. "Nuk ka kurrfarë sekretit ashtu që, absolutisht, vendosja e çështjeve të tilla mund të jetë vetëm një populizëm i zhveshur, por transparenca në udhëheqjen e politikave të kësaj Qeverie askush nuk do të arrijë t'i kthejë. Sado që të jetë e dhimbshme, sado që të jetë vështirë, sado që të jetë diçka e përditshme në punë, deri në fund qytetarët meritojnë përgjigje dhe nga kjo Qeveri t'i marrin të gjitha përgjigjet e mundshme", thekson Zaev. Tha se nuk guxon të lejojë si politikan të jetë hulumtues dhe prokuror.

Zaev gjithashtu tha se e drejta dhe shteti juridik është përmirësuar në shtet, lufta me korrupsionin është efikas dhe Qeveria vazhdon ta avancojë me efekte edhe më të mëdha. "Nga

të gjitha 22 rastet e vrasjeve, duke filluar nga fillimi i vitit 2017 e dhe pse kjo Qeveri është nga 1 janari i vitit 2017, i kanë trashëguar lëndët strukturat e reja të MPB-së dhe vazhduan t'i punojnë, vetëm dy nuk janë zbuluar deri në fund, ndërsa vazhdon hetimi. patëm raste të tilla, janë bërë publike dhe transparente dhe për këtë qytetarët janë të informuar", tha kryeministri. Sipas tij, çështja është nëse mund të zbulohen edhe kryerësit e vrasjeve tek Liqeni i Smilkovës, të zbardhen deri në fund rastet e Kumanovës dhe vdekja e gazetarit Nikolla Mladenov për çka në opinion ka interes serioz.

"Çështja është pse dikur qeveria paraprahe madje edhe i ka fshehur vrasjet, këtë e kanë parë të gjitha sistemet", tha Zaev në seancën e sotme për pyetje të deputetëve. Ndryshe, vrasja afër Liqenit të Smilkovës ka ndodhur më 12 prill të vitit 2012, gjatë të Premtes së Madhe, para Pashkëve, kur u vranë të rinjtë Kire Triçkovski, Filip Sllavkovski, Cvetanço Ackovski, Aleksandar Naqevski dhe peshkatarin Borçe Stefanovski.

KRONIKË

Gruaja me sforc shpëton rrëmbimin e 14-vjeçarit

Të mërkurën në fshatin Pallaticë është tentuar të kidnapohet një fëmijë 14 vjeçar nga persona të panjohur. Siç njoftoi policia e Tetovës, 39 vjeçari me iniciale Z.I nga fshati Pallaticë, në orën 7 e 45 minuta së bashku me djalin e tij, 14-vjeçar, me veturë Pezho me targa të Kumanovës, ka qenë duke shkuar për në shkollën fillore në Pallaticë, dhe në një moment rrugën ia ka prerë një veturë Mercedes me targa të Shkupit. Nga vetura kanë dalë katër persona të panjohur të cilët kanë tentuar me forcë t'ia marrin djalin në veturën e tyre. Në këtë moment, ka dalur një grua fqinje e cila ka patur një sforc në dorë, ndërsa të panjohurit kanë ikur në drejtim të panjohur. Janë marrë masa për zbardhjen e plotë të rastit

Burri sulmon gruan dhe vajzën

Të mërkurën rreth orës 16.00, 39-vjeçarja me iniciale SH.O nga fshati Tenovë, ka denoncuar dhunë që e ka ushtruar babai i saj S.O, 66-vjeçar. Sipas denoncimit, babai ka ushtruar dhunë edhe ndaj saj, por edhe ndaj nënës Gj.O, 57-vjeçare. Dy bashkëshortët fillimisht kanë patur një zënkë verbale, dhe më pas babai ka goditur gruan e tij. Vajza ka ndërhyrë që ti ndalojë, por edhe ajo është sulmuar, ndërsa më pas vajza bashkë me nënën kanë arritur që të mbyllin derën. I denoncuar S.O ka marrë një vegël bujqësore dhe ka tentuar ta hap derën, por nuk ka arritur përveçse e ka thyer dritaren. Më pas, 66-vjeçari është arrestuar dhe punohet në zbardhjen e plotë të rastit.

Vajza shtantazon djalin me foto komprometuese

23 vjeçari B.T nga Gostivari, të mërkurën rreth orës 11 ka denoncuar se një vajzë e panjohur me të cilën është njohur në rrjetin Facebook, ka shpërndarë foto kontroverse. Pas një kohe, vajza sërish e ka kërcënuar se do të publikojë ende foto nëse nuk i jep rreth 1000 euro. Më pas, kur i ka thënë se s'ka aq para, janë pajtuar që ti jep 100 euro dhe ajo që të fshijë të gjitha fotot. Në vend të kësaj, e panjohura ka vazhduar të kërkojë ende para. Janë marrë masa për zbardhjen e plotë të rastit.

Gjendet thikë në oborrin e shkollës

Një 64-vjeçar, tetovar, me iniciale Z.S mësues në shkollën fillore "Bratsvo-Migjeni", në Tetovë, të mërkurën ka denoncuar se rreth orës 17.00 në afërsi të kontejnerit për mbeturina ka gjetur një thikë. Sipas rrëfimit të tij, thikën e ka hedhur një nxënës, i cili është vërejtur me thikën në korridor. Thika është marrë dhe punohet në zbardhjen e plotë të rastit. (U.H)

Argëtim Vojnika, komandant i policisë në Dibër



Dibër, 26 prill - Argëtim Vojnika prej dje është komandanti i ri i Stacionit Policor

me kompetenca të përgjithshme në Dibër, konfirmojnë nga Sektori i Punëve të Brendshme nga Ohri.

Ai në këtë funksion është emëruar me vendim të ministrit të Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski. Vojnika është tridhjetë e tre vjeçar i cili ka diplomuar në Fakultetin Juridik, ndërsa në Ministri është që nëntë vjet. Në funksionin e ri vjen nga

vendi komandant në vendkalimin kufitar "Bllatë" në kufirin Shqipëri-Maqedoni afër Dibrës, ndërsa parapakisht ka qenë edhe zëvendëskomandant k kalimit kufitar "Xhepishë" gjithashtu në kufirin Shqipëri-Maqedoni afër Dibrës. Funksionin komandant i SP me kompetenca të përgjithshme në Dibër deri më tani e ka kryer Rashid Ismaillovski.

Ambasadorët pastrojnë bregun e Vardarit



Shkup, 26 prill - Nën moton "Pastro, Posto në Tuitër", dje u mbajt aksion ekologjik vullnetar për pastrimin e bregut të Vardarit me çka u përfshinë brigjet e të dy anëve të lumit në rajonin qendror të qytetit të Shkupit. Aksionin, i cili promovohet edhe përmes Tuitërit, e organizuan Birraria e Shkupit, Ambasada e Mbretërisë së Holandës dhe kompania Pakomak, ndërsa në aksion u përfshinë edhe ambasadori britanik Çarls Geret dhe ambasadori i SHBA-së, Xhes Bejli me ekipet e tyre. Llambe Patçe, menaxher për marrëdhënie me publikun dhe komunikim në Birrarinë e Shkupit tha se përmes aksioneve të tilla dëshirojnë të dërgojnë porosi dhe apel drejtë kompanive të tjera dhe gjithë shoqërisë se të gjithë duhet ta ndër marrin pjesën e tyre të përgjegjësisë dhe më shumë të angazhohen në zgjidhjen e problemit me ndotjen e ajrit, me çka do të krijojmë të ardhme të qëndrueshme për ne dhe për gjeneratat e ardhshme. Ambasadori holandez, Vilem Vauter Plomp i përshëndeti pjesëmarrësit e aksionit vjetor, i cili njëkohësisht është edhe pjesë e aktiviteteve për shënimin e "Ditës së Mbretit" - festa kombëtare e Holandës. "E bashkuam të bukurën me të dobishmen dhe edhe një herë tentuam ta japim kontributin tonë për zvogëlimin e ndotjes së ajrit i cili është problem për njerëzit dhe natyrën. Mënyrë e vetme efektive për tejkalimin e përherëshëm të këtij problemi është më shumë punë, angazhim dhe bashkëpunim në mes sektorit publik, kompanive dhe qytetarëve. Me angazhimin tonë të sotëm dëshirojmë të tregojmë se secili nga ne mund të jetë shembull personal për të tjerët dhe ta inkurajojë zgjidhjen e çfarëdo problemi", theksoi Plomp. Ky është aksioni i tretë ekologjik me radhë të cilin e organizojnë Birraria e Shkupit, Pakomak dhe Ambasada e Holandës. Në dy aksionet e mëparshme ishin pastruar bregu dhe ujërat e liqenit të Matkës, si dhe bregu i lumit Vardar.

Orientimi në veprimtaritë ekonomike, do t'iu mundësojë grave të sjellin më shumë fitime, siç janë eksporti dhe inovacionet, përfshi teknologjinë informatike, ekonominë e gjelbër, dhe sipërmarrjen sociale

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 26 prill - Koha është që gratë të orientohen, jo ndaj mbijetesës së bizneseve, por ndaj veprimtarive ekonomike që sjellin fitime më të mëdha. Gjithashtu sipërmarrëset nga radhët e grave duhet të rrisin edhe fitimin e bizneseve të tyre që është shumë më i vogël në raport me kompanitë që posedojnë burrat. Nga Shoqata e grave afariste të Maqedonisë thonë se në këtë drejtim do të ndihmojë edhe projekti evropian "WE MAKE", ku do përdoren edhe përvojat kroate.

"Me vite të tëra flasim për zhvillimin e sipërmarrjes së grave në Maqedoni dhe rëndësinë e saj për zhvillimin ekonomik të shtetit. Tani ka ardhur koha që gratë të rrisin pjesëmarrjen e tyre prej 10 për qind të fitimit në nivel të shtetit në më shumë, përkundër asaj se posedojnë 30 për qind të bizneseve në Maqedoni. Pra, gratë do të ndihmojnë të orientohen në veprimtaritë ekonomike që sjellin më shumë fitim siç janë eksporti dhe inovacionet përfshi teknologjinë informatike, ekonominë e gjelbër, dhe sipërmarrjen sociale. Projekti do të realizohet në mënyrë të barabartë në të gjithë Maqedoninë, ndërsa ligjëratat dhe trajnimet do të mbahen edhe në gjuhën shqipe", thotë Valentina Disovska kryetare e Shoqatës së grave afariste të Maqedonisë. Sipas saj projekti "We Make", është i financuar nga Bashkimi Evropian, ndërsa realizohet me ndihmën e GTF, apo Iniciativës për rritje të qëndrueshme nga Kroacia në bashkëpunim me Shoqatën e

ORIENTIMI I GRAVE SIPËRMARRËSE

RRITJE TË PROFITIT, JO MBIJETESËS



grave afariste të Maqedonisë. Projekti ka filluar më dhjetor të vitit 2017 dhe do të zgjasë deri më prill të vitit 2019, duke përgatitur fillimisht trajnuesit apo lehtësuesit lokal, ndërsa projekti është i dedikuar për gratë dhe vajzat e reja, sipërmarrëset potenciale dhe ekzistuese si dhe palët e interesuara nga ana e institucioneve shtetërore dhe shoqëria civile. "Qëllimi është që gratë të ndihmojnë Maqedoninë që të jetë më konkurruese në tregjet e jashtme duke eksportuar teknologji të reja, dhe shërbimet e sipërmarrjeve sociale dhe ekologjike. Projekti ynë do të fokusohet për rritjen e sipërmarrjes duke filluar nga shkollat e mesme, do të formohet edhe biznes klaster i grave të Maqedonisë, do të këmbehen përvoja me gratë e rajonit si dhe do të hapet portal që do të ndihmojë eksportin e shërbimeve të ndryshme jashtë Maqedonisë", thotë Meri En Cipetiç drejtore e GTF, Iniciativës për rritje të qëndrueshme

nga Kroacia, që mbështet projektin kushtuar rritjes së konkurrencës vendore. Përgjatë projektit do të ndahen përvojat më të mira kroate dhe evropiane në favor të përkrahjes së sipërmarrjes së grave.

Në kuadër të projektit do të realizohen më shumë aktivitete në disa faza në Tetovë, Strugë, Manastir, Veles, Kumanovë, Shtip, Strumicë dhe Shkup. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të rrisë konkurrencën e ekonomisë së Maqedonisë, përmes përkrahjes së ekosistemit të ndryshëm të sipërmarrjes, duke inkuadruar gratë dhe shoqërinë civile. Me projektin parashikohet nxitje dhe përkrahje për sipërmarrjen e grave përmes përmirësimit të përdorimit të teknologjisë, rritëzimin si dhe ndërtimit të kapaciteteve të Shoqatës kombëtare për sipërmarrje të grave. Aktivitetet projektuese parashikojnë programe për së paku 500 nxënëse të shkollave të mesme. Do të mundësohen edhe trajnime të ndryshme

për 150 start ap biznese të grave.

Ndryshe, sfera e sipërmarrjes sociale në Republikën e Maqedonisë ofron mundësi për punësim dhe ri-integrimin e personave të papunësuar, të cilët janë pa punë në periudhë më të gjatë kohore, si dhe punësimin dhe ri-integrimin e personave të cilët janë më pak konkurentë në tregun e punës. Njëherësh ekonomia e gjelbër, apo projektet për mbrojtjen e mjedisit paraqesin një shans të mirë zhvillimi për Maqedoninë dhe mundësi të shkëlqyer për tërheqjen e investimeve të huaja, rritje ekonomike dhe hapjen e vendeve të reja të punës. Ekspertët thonë se tre sektorë janë kryesor për orientimin ndaj ekonomisë së gjelbër në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm si burimet rinovueshme të energjisë, si era, uji apo dielli, efikasiteti energjetik që nuk është vetëm kursim i energjisë, por paraqet shfrytëzimi efikas të energjisë si dhe prodhimtaria e qëndrueshme organike bujqësore.

REAGIM I LËVIZJES BESA

"MPB dhe Komuna po i rrjepin qytetarët e Çairit"

Shkup, 26 prill - Lëvizja Besa përshëndet çdo aksion për rregullimin e kaosit në trafik dhe askush nuk mund të ketë asgjë kundër kësaj, por siç duket, aksioni policor që po zhvillohet këtyre ditëve në Komunën e Çairit, në koordinim me autoritetet komunale, më shumë se për rregullim të trafikut, po bëhet me qëllim të rrjepjes së qytetarëve dhe rritje të kaosit. Kështu thuhet në reagimin e Lëvizjes BESA, sipas të cilës, qytetarët e Çairit nuk janë aq të padisiplinuar sa dëshiron t'i paraqesë policia dhe Komuna, por ata janë të detyruar të gjenden si munden gjatë parkimit të makinave pikërisht për shkak të mungesës së parkingje-



ve. "Ne do të besojmë në sinqeritetin e këtij aksioni sikur paralelisht Komuna të fillonte edhe me ndërtimin e garazheve në kate, siç kanë premtuar (gënjyer) gjatë fushatës

zgjedhore dhe sikur të dënoheshin njësoj, si qytetarët - edhe aktivistët e funksionarët e BDI-së, që i parkojnë makinat e tyre në trotua-re e në hapësira të gjelbra, madje

edhe e rrahin policinë nëse u kërkon ta lirojnë rrugën. Mirëpo, në situatë kur nuk ndërmerret asgjë në këtë drejtim, vlerësojmë se qëllimi i aksionit është vetëm mbushja e buxhetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe asgjë më shumë. Për këta arsye kërkojmë që Komuna e Çairit urgjentisht të fillojë të punojë në gjetjen e alternativave, të krijojë kushte parkimi dhe ashtu të ndihmojë veçmas në zhvillimin e bizneseve, edhe ashtu të pakta e të vogla, sepse dënimi i qytetarëve - që edhe ashtu jetojnë në mjerim në Çair - vetëm mund ta rrisë mjerimin e tyre", thuhet në reagimin e BESËS.

"Problem kyç është që në një pjesë të madhe të raporteve të Entit Shtetëror për Revizion ka mungesë të veprimit sipas rekomandimeve përkatësisht për rreth 30 deri në 40 për qind të rekomandimeve që janë dhënë nuk ka kthim të përgjigjeve nga ana e institucioneve", tha Damir Neziri nga Fondacioni për demokraci Uestminster

Koha

Zejnulla VESELI

INSTITUCIONET NUK I ZBATOJNË REKOMANDIMET

REVIZORËT S'KA KUSH I DËGJON



Shkup, 26 prill - Enti Shtetëror për Revizion ka kryer mes 50 dhe 60 revizione në vit për institucione të ndryshme dhe jep rekomandime për përmirësimin e punës së tyre, ndërsa atje ku do të konfirmojë punë jologjore ose ka dyshim për punë jologjore, e ndjek raportin deri te Prokuroria Publike, Komisioni Antikorrupsion dhe Ministria e Punëve të Brendshme. Gjatë vitit 2016 dhe 2017 në bazë të raporteve të tilla janë ngritur procedura parahetimore, ndërsa janë caktuar akuza për kundërvajtje. Këtë e potencuan pjesëmarrësit në debatin e djeshëm të titulluar "Implementimi i rekomandimeve të Entit Shtetëror për Revizion, prioritet i lartë

shoqëror". "Problem kyç është që në një pjesë të madhe të raporteve të Entit Shtetëror për Revizion ka mungesë të veprimit sipas rekomandimeve përkatësisht për rreth 30 deri në 40 për qind të rekomandimeve që janë dhënë nuk ka kthim të përgjigjeve nga ana e institucioneve", tha Damir Neziri nga Fondacioni për demokraci Uestminster.

Ai shtoi se në periudhën e viteve 2016 dhe 2017 dhjetëra raporte të Entit Shtetëror për Revizion që janë ndjekur deri te PP dhe sipas informatave prej atje veçmë udhëhiqen procedura parahetimore. Analiza për ndjekjen e punës së Entit Sh-

tetëror për Revizion tregon se në vitin 2017 deri te PP janë parashtruar raportet për VQL Prilep, klinikat për pulmologji dhe alergologji, për traumatologji, për sëmundje ortopedike, anestezi, rianimim dhe shërim intensiv dhe Qendra urgjente, ndërsa deri te Komisioni për ndalimin e korrupsionit janë parashtruar raporte revizore për Universitetin për shkencë informatike dhe teknologji "Shën Apostol Pali" Ohër dhe Klinikën universitare për pulmologji dhe alergologji. Procedurat, siç qëndron në analizë janë në rrjedhë. Për Nezirin, pikë kyçe në të cilën duhet të drejtohet fokusi në të ardhmen është si të bëhet

presion më i madh ndaj institucioneve t'i respektojnë dhe t'i implementojnë rekomandimet.

Sipas tij, ka disa mekanizma përmes PP-së, Komisionit Antikorrupsion, Kuvendit, por edhe mediave dhe shoqëritë civile. Qëllimi i punës së institucioneve të bëhet më efikas dhe më efektiv, që do të vrente edhe kursimi i parave të qytetarëve. Ambasadori britanik Çarls Garet, gjithashtu, potencoi në përfundimin e kapacitetit të Entit shtetëror për revizion, por edhe në bashkëpunim më të madh me institucionet e tjera dhe sektorin civil.

"Enti shtetëror për revizion nuk mund të punojë në mënyrë të pa-

varur. Ato varen edhe nga institucionet e tjera që punojnë në drejtim të njëjtë dhe mes tyre janë edhe institucionet jashtë strukturës së Qeverisë. Ky projekt i bën së bashku organizatat civile dhe institucionet e shtetit siç janë Enti shtetëror për revizion dhe Kuvendi. Bëhet partneritet dhe përforcohet kapaciteti", tha Garet. Deputeti Dragan Cuklev tha se në periudhën e fundit me një pjesë të kolegëve shqyrtojnë mundësi të ndryshme të modaliteteve për përdorim më të madh të raporteve revizore nga ana e Kuvendit. Gabriela Dimovska nga Qendra për analiza ekonomike potencoi se njëra nga opsionet është raportet të shqyrtohen në seancë plenare, tjetër në Komisionin e financave dhe buxhetit ose sërish në nënkomisionin i cili do të detyrohet për shqyrtim të këtyre raporteve. Debatit i djeshëm ishte ngjarje përfundimtare e projektit "Përfundimi i llogaritjeve financiare dhe transparencës në Maqedoni", që në dy vitet e fundit ishte zbatuar nga ana e Fondacionit për demokraci Uestminster në bashkëpunim me Qendrën për analiza ekonomike dhe Institutin për studime komunikuese, ndërsa me përkrahje të Ambasadës Britanike në Shkup.

TAKIM AFARIST ME DELEGACIONIN IRANIAN TË BIZNESIT

TREGTI ME IRANIN

Shkup, 26 prill - Afaristët nga Irani e shohin Maqedoninë si portë për hyrje në rajon dhe vendet e tjera të Evropës. Nga ana tjetër Irani me pozitën e saj gjeografike dhe kalimi në rrugët tokësore dhe detare kryesore botërore në vend apo në afërsi të saj, si dhe kufijtë tokësor dhe ujor me 15 vende ofron mundësi të mëdha për kompanitë e Maqedonisë. Këtë, në forumin biznesin e djeshëm në Odën Ekonomike të Maqedonisë dhe takimet afariste me delegacionin e biznesit nga Irani e porositi kryetari i Odës së Tregtisë, Industrisë, Minierës dhe Bujqësisë së Iranit, Golam Hosein Shafei. Ai theksoi se shkëmbimi tregtar midis dy vendeve është simbolike dhe theksoi se duhet të merre nismë për lehtësimin regjimit të vizave dhe të nënshkruhen marrëveshje për lehtësimin e procedurave doganore.

"Është e domosdoshme të shfrytëzohen mundësitë dhe kapacitetet përkatëse që të nxiten marrëdhëniet midis dy vendeve", tha Shafei dhe shtoi se vitin e kaluar Maqedonia ka importuar mallra nga Irani në vlerë prej 4,76 mi-



lionë dollarë, ndërsa ka eksportuar për 401.000 dollarë. Mundësi për bashkëpunim me Odën Ekonomike të Iranit, e cila ka më shumë se 60 anëtare, 34 oda lokale dhe më shumë se 200 shoqata dhe organizata, potencoi, ka në shërbimet teknike dhe inxhinierike, ndërtim të termocentraleve, rrugëve, urave, teknologjisë informatike, infrastrukturës detare, industrisë së aviacionit, ndërtim të rafinerive, prodhim dhe përpunim të naftës, gazit dhe prodhimeve ushqimore, pajisje mjekësore dhe farmaceutike, minierës, blegtorisë, bujqësisë dhe pajisjes ndërtimore. "Propozojmë bashkëpunim midis sektorit privat të të dyja vendeve me formimin e kompanive të përbashkëta me qëllim që të prodhohet mall me brend të përbashkët dhe të eksportohet në

vendet rajonale", tha Shafei dhe shtoi se shpreson në mbështetjen e Maqedonisë për kyçjen e Iranit në OTB. Kryetari i Odës Ekonomike të Maqedonisë, Branko Azeski theksoi se Irani me 80 milionë e tij, ndërsa së bashku me tregun më të gjerë nga rrethimi i tij 400 milionë banorë është një ndër lojtarët më të mëdhenj rajona botëror dhe paraqet sfidë për çdo biznes, kompani dhe shtet. Kjo, siç tha, është vend me potenciale dhe mundësi të fuqishme zhvillimore dhe me strukturë të fuqishme të lëndëve të para dhe jo rastësisht është synim i interesave të të gjitha vendeve evropiane. "Irani është partner i yni tradicional me të cilin mbajmë marrëdhënie nga viti 1993, por largësia dhe luftërat e ndryshme rajonale e bëjnë të veten. Mendojmë se tani është

momenti të bëjmë hap përpara dhe t'i intensifikohet bashkëpunimi", tha Azeski dhe shtoi se ekzistojnë mundësi për bashkëpunim me Iranin në shumë fusha, sepse është njëra ndër vendet e rralla që ka balanc të barabartë të shërbimeve dhe të industrisë në formimin e BPV-së. Bashkëpunimi i dërritashëm, theksoi, është në nivel shumë të ulët. Sepse, siç tha është i domosdoshëm shkëmbimi i informacioneve, vizita e manifestimeve të panairëve, video-konferencave, takimeve B2B, si dhe të shqyrtohet mundësia për hapjen e përfaqësisë diplomatike të Maqedonisë në Iran. Në këtë drejtim ishte nënshkruar memorandum për bashkëpunim midis të dyja odave dhe ish-in organizuar takime B2B me delegacionin e Iranit. (F.P)

Maqedonia kryeson me papunësinë në Evropë

Shkup, 26 prill - Shkalla e punësimit në 28 shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (BE) për vitin 2017 është regjistruar me 53.5 për qind, kurse ai i papunësisë 7.6 për qind, ndërkohë që shkalla më e lartë e papunësisë është regjistruar në Maqedoni me 22.4 për qind, transmeton Anadolu Agency (AA). Instituti Statistikor i Turqisë njoftoi se shkalla e punësimit në 28 shtete anëtare të BE-së te popullsia e moshës mbi 15 vjeçe u realizua me 53.5 për qind. Shteti me shkallë më të lartë të punësimit në mesin e 33 shteteve në gjithë Evropën ka qenë Islanda me 80.6 për qind, kurse shteti me shkallë më të ulët të punësimit ka qenë Greqia me 40.9 për qind. Ndërkaq, niveli i punësimit të Turqisë për vitin e kaluar u regjistrua me 47.1 për qind. Shkalla e papunësisë për vitin 2017 te popullsia e moshës 15-74 vjeçe në 28 shtetet anëtare të BE-së u regjistrua me 7.6 për qind. Në 33 shtete në gjithë Evropën, shkalla e papunësisë ka variuar nga 2.7 për qind në Islandë deri në 22.4 për qind, që është shënuar në Maqedoni. Shkalla e papunësisë në Turqi për vitin 2017 u regjistrua me 10.9 për qind.

Shpallja publike numër 03/2018

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor publikon shpallje për angazhimin e 2 personave - konsulentë në kuadër të projektit 'Forcimi i kapaciteteve për zhvillimin e regjistrave kombëtarë të ndotësve dhe transferimit të ndotësve (PRTR) dhe mbështetja e zbatimit të SAICM në dy vende me ekonomi në tranzicion, Republika e Moldavisë dhe Republika e Maqedonisë ', e cila zbatohet nga Zyra për Ndotësit Organik të Qëndrueshëm edhe atë:

1. Angazhimi i 1 (një) eksperti të lartë për përgatitjen e vlerësimit të hollësishtë të zbatimit dhe implementimit të kornizës legale dhe institucionale për mirëmbajtjen adekuate të regjistrave kombëtarë të ndotësve dhe transferimit të ndotësve (PRTR) në praktikë

Kandidati për këtë pozitë duhet t'i plotësojë kushtet e mëposhtme:

- Arsimin universitar në fushën e teknologjisë, mjedisit, kimisë ose shkencave të tjera teknike
- Shkalla e Masterit do të konsiderohet si një përparësi
- Përvoja në ratifikimin dhe zbatimin e protokollit PRTR - do të konsiderohet si një përparësi
- Përvoja në projektet ndërkombëtare që lidhen me protokollin e PRTR - do të konsiderohet si një përparësi
- Njihuri të avancuara të gjuhës angleze
- Njihuri të avancuara të aftësive kompjuterike

Përvoja e përgjithshme profesionale

- Të paktën 10 vjet eksperiencë të përgjithshme profesionale në fushën e mbrojtjes së mjedisit, zvogëlimit të ndotjes industriale, transportit, ndotjes së ajrit ose përgatitjes së inventarëve kombëtarë

Përvojë specifike profesionale

- Njihje e legjislacionit kombëtar në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe legjislacionit të lidhur me PRTR
- Përvojë në të paktën në një projekt lidhur me zbatimin e PRTR

Qëllimi i angazhimit është:

- Vlerësimi i kuadrit institucional dhe ligjor
- Mekanizmat e pajtueshmërisë dhe zbatimit
- Monitorimi, informimi, pjesëmarrja publike dhe edukimi
- Marrëveshje dhe angazhim ndërkombëtar
- Rishikim i sektorit
- Rishikim i ndotjes
- Konkluzione dhe rekomandime

2. Angazhimi i 1 (një) Konsulenti kombëtar për përgatitjen e udhërrëfyeseve / manualeve për vlerësimin e emisioneve

Kandidati për këtë pozitë duhet t'i plotësojë kushtet e mëposhtme:

- Arsimin universitar në fushën e kimisë, ekologjisë, teknologjisë ose shkencave të tjera teknike
- Njihuri të avancuara të gjuhës angleze
- Njihuri të avancuara të aftësive kompjuterike
- Shkalla e Masterit do të konsiderohet si një përparësi
- Përvoja në ratifikimin dhe zbatimin e protokollit PRTR - do të konsiderohet si një përparësi

Përvoja e përgjithshme profesionale

Të paktën 10 vjet eksperiencë të përgjithshme profesionale në fushën e mbrojtjes së mjedisit, zvogëlimit të ndotjes industriale, transportit, ndotjes së ajrit ose përgatitjes së inventarëve kombëtarë

Përvojë specifike profesionale

- Përvojë në të paktën dy projekte që lidhen me përgatitjen e inventarëve të emisioneve
- Njihje e legjislacionit kombëtar për mjedisin për emisionet e ajrit dhe përvoja e PRTR në përdorimin e Manualit EMEP / EEA
- Anëtarësime aktuale ose të mëparshme në organet profesionale që lidhen me emisionet e ajrit do të konsiderohen si një përparësi
- Nevojitet përvoja në zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare që lidhen me emisionet e ajrit

Dërgesat e pritshme:

1. Manual për vlerësimin e emisioneve në industrinë metalike dhe kimike
2. Manual për vlerësimin e emisioneve nga prodhimi i energjisë dhe ngrohjes
3. Manual për vlerësimin e emisioneve në bujqësi dhe ferma
4. Manual për vlerësimin e emisioneve nga repartet e djegies së mbeturinave dhe repartet e trajtimit të mbeturinave

Kohëzgjatja e angazhimit: 4,5 muaj, pra 15 javë pune për një periudhë prej 8 muajsh.

Krahas kualifikimeve të përmendura më lart, kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet e përgjithshme në vijim: të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë dhe me aktgjykim të plotfuqishëm të gjykatës të mos ketë qenë i dënuar për mos kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kandidatët e interesuar duhet t'i dorëzojnë dokumentet e mëposhtme: letër motivuese, biografi të shkurtër, kopje e certifikatës së shtetësisë, kopje të diplomës për fakultetin e kryer e notariuar në noter, si dhe diploma dhe certifikata të tjera që i posedon, e janë të rëndësishme për vendin e punës. Dokumentet të cilat e konfirmojnë përvojën e nevojshme që kërkohet në kushtet e cituara për të dy pozicionet.

Dokumentacioni i nevojshëm të dorëzohet në një zarf të mbyllur direkt në Arkivin e **Ministrit të Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, ose me postë në adresën e mëposhtme: Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor bul. „Goce Dellçev“ nr. 18, 1000 Shkup (me shenjën „shpallje për punësim“)**

Afati për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm është pesë (5) ditë, llogaritur nga data e publikimit të shpalljes.

Aplikimi dhe dokumentacioni i vonuar dhe i pa-kompletuar nuk do të shqyrtohet. Pas selektimit të kandidatëve të paraqitur për plotësimin e vendit të cituar të punës, kandidatët e përzgjedhur sërish do të ftohet në intervistë në hapësirat e Ministrisë.

NDËRMARRJA PUBLIKE PËR VEPRIMTARI ENERGETIKE
“STRUMICA – GAS” STRUMICË

Deri te
Lëndë: Kërkesë për publikim të shpalljes publike për plotësim të vendit të lirë të punës

Të nderuar,
 Në pajtim me nenin 34 të Ligjit për nëpunës administrativ (Gazeta Zyrtare e RM numër 27/2014, 199/2014, 154/2015, 05/2016, 142/2016 dhe 11/18) kërkohet të publikoni shpallje publike për plotësimin e vendit të lirë të punës për punësimin të 1 nëpunësi publik në NPVE "Strumica Gas" Strumicë.

Të dhënat për institucionin që parashtron kërkesën
 Emri: NPVE "Strumica Gas" Strumicë, rr. Boro Xhoni nr. 10, Strumicë
 Numër i vetëm tatimor: 4027010511534
 Numri i vetëm personal: 6589812
 Numri rendor i kërkesës për vitin aktual: 01/2018
 Data e parashtrimit të kërkesës: 25.04.2018.

Të dhënat për vendet e punës që duhet të publikohen

1. KDR 01 02 V01 067 Këshilltar për punë administrative juridike dhe menaxhim me resurset njerëzore, Departament për punë profesionale administrative dhe të përgjithshme, Shërbimi profesional administrativ,

(1) realizues.

Shkalla e nevojshme dhe lloji i arsimit: niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe të aritura së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VIII të mbaruar, shkencat juridike;

Përvoja e nevojshme e punës: pa përvojë pune;

Kompetencat e përgjithshme të nevojshme të punës:

- zgjidhje e problemeve dhe vendim për punë nga fushëveprimi i tyre
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- realizim të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- vetëdije strategjike
- orientim ndaj palëve/palët e tanguara dhe
- menaxhim financiar

Niveli i nevojshëm i njohjes së gjuhës së huaj:

- Njihje aktive të një prej gjuhëve më shpesh të përdorura të Bashkimit Evropian (angleze, frënge, gjermane),

Niveli i nevojshëm i njohjes së punës me programe kompjuterike për punë në zyrë:

- Njihje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë

Orari i kohës së punës:

- Ditët e punës: e hënë – e premte
- Orët e punës në javë: 40
- Orari i punës prej 08:00 deri më 16:00

Shuma në të holla e pagesës fillestare: **20.979,00 denarë**

Të dhënat për anëtarët e Komisionit për përzgjedhje për punësim në lidhje me shpalljen publike dhe zëvendësit e tyre nga institucioni në pajtim me nenin 37 të Ligjit për nëpunës administrativ:

Duke patur parasysh numrin vogël të vendeve të sistematizuara të punës Ndërmarrja publike për veprimtari energjetike për momentin nuk ka të punësuar në Departamentin për punë profesionale administrative dhe të përgjithshme, Shërbimi administrativ profesional, person i cili është përgjegjës për menaxhim me resurse njerëzore. Sipas nenit 37 paragrafi 2 i Ligjit për nëpunës administrativ, Kërkojmë nga Agjencia për administratë të caktojë person për realizim të papenguar të procedurës. Vendet e punës të cilat do të plotësohen, në njësitë e tyre organizative për momentin nuk ka drejtues edhe pse janë paraparë me sistematizim, por nuk janë plotësuar, dhe prandaj kërkohet nga Agjencia të caktojë anëtarë të Komisionit dhe zëvendës të tyre nga nëpunësit administrativ nga Sektori për përzgjedhje të kandidatëve në Agjencinë.

Personi udhëheqës i NPVE "Strumica-Gas" Strumicë është Blagoj Millanoviç, me adresë elektronike blagoj.milanovik@strumicaqas.mk dhe numër të telefonit mobil 075 412 003

Të dhënat për përcaktimin e numrit të vendeve të shpallura të punës sipas përkatësisë të komuniteteve:

-në punësimet e parapara në pajtim me planin vjetor të institucionit për vitin 2018 për vendet e shpallura të punës parashihet të jetë Maqedonas.

Shpallja të publikohet në tri gazetë ditore në vijim: Utrinski vesnik, Siloboden pečat dhe Koha.

Afati për paraqitje në shpalljen publike të jetë 15 ditë nga dita e publikimit në gazetë ditore.

Të bashkëngjitur me Kërkesën ju parashtrime:

- Planin vjetor për punësim për vitin 2018 të NPVE "Strumica-Gas" Strumicë me nr. 01-410/1 të datës 28.11.2017.
- Mendimin pozitiv të planit vjetor për punësim për vitin 2018 të marrë nga Ministria e shoqërisë informatike dhe administratës me nr. ark. 12/6-4084/3 të datës 26.12.2017.
- Nxjerrje nga Rregullorja për sistematizim të vendeve të punës në NPVE "Strumica-Gas" Strumicë me përshkrim të vendit të punës që shpallet.
- Konkluzion për dhënie të pëlqimit të Planit vjetor për punësim të NPVE "Strumica-Gas" Strumicë për vitin 2018 me nr. 08 – 7804/1 të datës 07.12.2017, të sjellë nga Këshilli i Komunës së Strumicës.
- Vendim për mjete të siguruar financiare për plotësimin e vendeve të punës në NPVE "Strumica-Gas" Strumicë me nr. 09-44/2 të datës 05.01.2018 të sjellë nga Kryetari i Komunës së Strumicës.

Strumicë
 Nr. 03 –175/1
 25.04.2018.

NPVE "Strumica-Gas" Strumicë

Drejtor
 Blagoj Millanoviç



Republika e Maqedonisë
 Ministria e Mjedisit Jetësor
 dhe Planifikimit Hapësinor

Në bazë të nenit 22, paragrafi 1, alinesë 1 dhe paragrafi 3 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 62/05, 106/08, 161/08, 130/09, 114/09, 130/09, 10/12, 11/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 167/15 dhe 27 / 16) Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor shpall:

SH P A L L J E NR. 2/2018

Për punësimin e tre ekzekutuesve për kohë të caktuar në Njësinë e Projektit për zbatimin e projektit "Rindërtimi dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit dhe ndërtimi i stacionit për trajtimin e ujërave të zeza"

1. Këshilltar monitorimi për zbatim

..... **3përmbaues**

Njësia e Projektit për zbatimin e projektit "Rindërtimi dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit dhe ndërtimi i stacionit të trajtimit të ujërave të zeza"

- **Komuna ku ndodhet vendi i punës:**

Tetovë - 1 përmbaues
Kërçovë - 1 përmbaues
Manastir - 1 përmbaues

- Arsimi i lartë, me së paku 240 kredi sipas EKTC ose që e ka të përfunduar shkallë e VII / 1 të Ndërtimtarisë dhe Menaxhimit të Ujërave, Arkitekturës, Urbanizmit dhe Planifikimit, Energjetikës, Mjedisit, Inxhinierisë Industriale dhe Menaxhimit, Elektronikës dhe Automatizimit
- Të paktën 3 vjet përvojë pune
- Njihuri aktive për një nga tre gjuhët më të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht),
- njihuri aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- Orari i punës: E hënë - e premte nga ora 07.30 / 08: 30 deri në ora 15.30 / 16: 30
- Paga neto: 24,998 denarë

Përveç kushteve të veçanta, kandidatët duhet t'i plotësojnë edhe kushtet e përgjithshme sipas Ligjit.

Punësimi është për një periudhë të caktuar kohe nga regjistrimi deri më 31.12.2018. Vendi i punës ndodhet në 3 komuna.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë një kërkesë (letër interesi), në të cilën do të tregojnë se në cilën vende pune aplikojnë, biografi të shkurtër në gjuhën maqedonase, kopje të diplomës ose certifikatës së arsimi të përfunduar dhe dëshmi të përvojës në punë.

MMJPH synon që të sigurojë përfaqësim të barabartë të grave dhe pakicave në të gjitha aktivitetet e saja dhe i inkurajon të gjithë kandidatët që janë të interesuar dhe që i plotësojnë kushtet të aplikojnë në këtë shpallje.

Aplikimet me dokumentet për përmbushjen e kushteve duhet të dorëzohet me postë në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, bul. Goce Dellçev nr. 18 ose personalisht në arkivin e Ministrisë (ndërtesa e RTVM kati i 10-të).

Afati i aplikimit është 10 ditë llogaritur nga data e publikimit.

Dokumentacioni i vonuar dhe i pa-kompletuar nuk do të shqyrtohet. Do të intervistohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet. Të gjithë kandidatët e paraqitur do të kenë mundësi të barabarta për t'u pranuar në përputhje me aftësitë, arsimin, përvojën dhe kapacitetin e tyre personal.

FAMILJA NGA SHQIPËRIA APEL PËR NDIHMË PËR TË OPERUAR VAJZËN

ANISËS I DUHET NDIHMJA JONË



Familja 7 anëtarëshe jeton në lagjen Cetinska të Tetovës, në një shtëpi që nuk plotëson kushtet elementare për jetesë, por ndihmë kërkojnë vetëm për operacionin e vajzës dhe jo për ushqim. Të gjithë ata që kanë mundësi për të ndihmuar këtë familje, mund të drejtohen në numrin e telefonit 071 973 368



Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 26 prill - Ai është nga qyteza e Peqinit - rrethina e Librazhdit të Shqipërisë. Asqeri Hyskja, së bashku me gruan e tij dhe pesë fëmijët tash e pesë vite jetojnë në Tetovë. Ndonëse ende nuk e ka rregulluar tërë dokumentacionin, megjithatë ai ka arritur që të regjistrojë të gjithë fëmijët në shkollën fillore "Andrea Saveski Kikish". Punon si punëtor krahu në Tetovë, ndërsa jeton me qira në një shtëpi me kushte jo të mira për jetesë. Por, banimi nuk është problemi i tij, as ushqimi, por vajza Anisa 7-vjeçare, e cila ka probleme me kyçet. Ajo me këtë problem jeton që kur ka lindur në Spitalin e Librazhdit. Operacioni kushton shumë për këtë vajzë, ndërsa ai vet nuk mund të përballojë harxhimet.

"Vajza Anisa që është në klasë të parë, ka probleme me kyçet. Gjatë lindjes, mjekët nuk kanë patur kujdes. Ajo kohë pas kohe ka

dhimbje dhe çalon kur ecën. Kam bërë analiza edhe në Spitalin e Tetovës dhe sipas mjekëve, shërimi i saj kushtin shumë rreth 20 mijë euro. Duhet nga dy operacione në dy këmbët. Unë nuk kërkoj ndihmë për ushqim, për veshmbathje apo shtëpi, por kërkoj që të më ndihmohet për operacionin e vajzës", thotë Hyskja. Sikur problemet dhe hallet e kësaj familje të mos kenë fund vetëm me këtë problem. Probleme shëndetësore kanë edhe dy fëmijët tjerë, djali Antonio 8-vjeçar dhe Elandra 6-vjeçare.

"Djali Antonio ka probleme me sytë nga temperatura dhe kjo i shkakton problem nervore. Disa herë i kam blerë syza, por të njëjtat i thyen sepse ka probleme edhe me nervat nga kjo sëmundje. Vajza tjetër Elandra ka problem me sytë dhe me këmbët. Jo sa vajza e parë, por edhe kjo ka probleme", shprehet Hyskja.

Krahas këtyre problemeve edhe vet burri e grua kanë problem

shëndetësore, por ata i kanë harruar dhimbjet e tyre vetëm për të shëruar fëmijët. "Gruaja ka shqetësimet e saja, por ajo është pajtuar që më shumë të kujdesemi për fëmijët se sa për shëndetin e saj. Unë kam patur operacion në Itali për shkak të ngritjes së peshave të rënda. Një dimër kam qenë i palëvizshëm për shkak të problemeve në shtyllën kurrizore. Të gjitha këto i

kam harruar për shkak të vajzës. Atë dua ta shëroj, ne tjetër mund të mbijetojmë", apelon ai. Sipas kryefamiljarit, ndihmë ka kërkuar edhe në Shqipëri, por atje nuk u ka ndihmuar askush. Tash e pesë vjet Asqeri Hyskja jeton në Tetovë, me një leje qëndrimi, por duke shkolluar fëmijët e tij dhe duke punuar për të mbijetuar, ndërsa shpreson që një ditë të marrë edhe shtetësi. Ai thotë se edhe shërbimet mjekësore i merr këtu në Tetovë. Kjo familje 7 anëtarëshe jeton në lagjen Cetinska të Tetovës, në një shtëpi që nuk plotëson kushtet elementare për jetesë, por kjo familje kërkon ndihmë për operacionin e vajzës dhe jo për mëshirë. "Për ushqim dhe për mbijetesë kam aq mundësi sa të punojë punë fizike dhe të mos dal të kërkoj lëmoshë, por shërimi i vajzës është më i rëndësishëm se gjithçka tjetër. Të gjithë ata që kanë mundësi për të ndihmuar këtë familje, mund të drejtohen në numrin e telefonit 071 973 368.

UT hapi dyert për maturanët

Tetovë, 26 prill - Nxënës të shkollave të mesme të Tetovës dhe nga qytete tjera, dje kanë marrë pjesë në Ditët e Hapura në Universitetin e Tetovës, ku edhe janë njohur për së afërmi me ofertën akademike të këtij universiteti shtetëror. Maturanët kanë patur mundësi që të njihen me kampusin, me infrastrukturën jashtë dhe brenda këtij universiteti, nëse ata vendosin që në të ardhmen të studiojnë në këtë universitet. Në kuadër të aktivitetit të "Ditët e Hapura", në hapësirat e Universitetit të Tetovës është organizuar edhe panairi i industrisë ushqimore në të cilin kanë marrë pjesë kompanitë më të njohura nga vendi ynë të cilat kanë shpalosur ofertën e tyre si dhe kanë promovuar produktet që ata prodhojnë. "Sikur edhe vitet tjera ashtu edhe këtë vit, Universiteti I Tetovës organizon ditën e hapur, në kuadër të së cilës ditë maturanët nga qytetet si Tetova, Gostivari, Shkupi, Kumanova, Presheva, Kërçova, Prilepi, Struga dhe Dibra kanë mundësi që të njohën me ofertën akademike për vitin 2018-2019. Të gjithë maturanët e interesuar dhe të pranishëm sot, do të kenë mundësi që nga ana e stafit akademik të UT-së, të njihen me programet studimore që ofron ky universitet ynë përkatësisht të njihen me 60 programet studimore që l kemi në 13 fakultete", tha Reshat Qahili, prorektor për arsim. (U.H)

PLATFORMË EDHE ONLINE PËR KOMUNIKIMIN ME KOMUNËN

Raporto për Gostivarin

Gostivar, 26 prill - Sot e tutje, banorët e Komunës së Gostivarit mund të raportojnë në mënyrë të lehtë ankesat e tyre për problemet e kategorive siç janë mbeturinat, gropat në rrugë, ndotësit e ajrit, ndriçimi publik, trotuarët e dëmtuara, rrugë të papastruara nga bora dhe akulli, si dhe probleme të tjera komunale me të cilat ballafaqohen në vendet ku banojnë dhe gravitojnë. Kjo falë vënies në funksion të Platformës online Raporto.mk. Në promovimin e kësaj platforme, që u bë dje para përfaqësuesve të administratës komunale, sektorit civil dhe qytetarëve në sallën e Këshillit të Komunës së Gostivarit, kryetari i Komunës Ar-

ben Taravari theksoi se zbatimi i një Platforme të tillë i ka lindur si ide gjatë vizitës në Bashkinë e Tiranës ku tashmë implementohet një Platformë e ngjashme e quajtur "Tirana ime" dhe ka vendosur që Gostivari të jetë pilot komuna e parë në Maqedoni ku do të vihet në funksion Platforma Raporto.mk. "Komuna e Gostivarit është e para që vendos në funksionon një mjet të komunikimit të qytetarëve me shërbimet komunale duke përdorur veglat teknologjike në Maqedoni. Jemi të përcaktuar që të vazhdojmë me transparencë dhe llogaridhënie ndaj qytetarëve duke zhvilluar mjete tjera teknologjike për zhvillim të demokraci-

së", theksoi mes tjerash Taravari. Ai falënderoi me këtë rast, Shoqatën Nexus CC, Ambasadën Amerikane në Shkup dhe OJQ Democracy Lab që bënë të mundur jetësimin e kësaj Platforme. "Plani ynë është që pas një periudhe të përdorimit të suksesshëm të kësaj platforme nga ana e qytetarëve të Gostivarit, e njëjta të aplikohet edhe në Komunat tjera më të mëdha urbane në Maqedoni, ku komuna e Gostivarit do të shërbejë si një shembull pozitiv. Do të falënderoja me këtë rast kryetarin Arben Taravari që na i dha mundësinë për implementimin e këtij projekti, si dhe administratën komunale për organizi-



min e këtij eventi sot", theksoi kryetarja e Nexus CC. Fjalë përshëndetëse mbajti edhe përfaqësuesi i Ambasadës së SHBA-ve në Shkup, Albion Abdullahi, i cili tha se ndjehet krenar që përkrah një projekt të këtillë në Komunën e Gostivarit dhe beson në sukseshmërinë e të njëjtit. Raporto.mk realisht do të pasqyrojë të gjitha vështirësitë që hasin qytetarët e Gostivarit, ndërsa vendosmëria e

udhëheqësisë së Komunës së Gostivarit është shumë e qartë dhe do të tentohet që me resurset njerëzore me të cilat disponon, të zgjidhen sa më shumë raste ato që do të raportohen përmes platformës. Raporto.mk është krijuar në bazë të platformës së hapur FixMyStreet të MySociety dhe e ofruar përmes DemTools të Institutit Kombëtar Demokratik (NDI). (U.H)

Rrethi i kompetencës

Nga

Ramize FERATI



Para më shumë se dhjetë vjetësh, isha angazhuar për të përkthyer një seri ligjëratash në fushën e prokurimit publik në një universitet në Prishtinë. Pasi kisha trajtuar disa herë të njëjtat module dhe pothuajse të njëjtat tema, nuk do mend se puna shkonte rrjedhshëm. Kur në fund të programit studentëve, që në këtë rast ishin zyrtarë të lartë të prokurimit, iu shpërndanë certifikatat, një grup i tyre më pyeti, nëse kisha menduar ndonjëherë të organizoj në mënyrë të pavarur trajnime nga fusha e prokurimit. Edhe pse pohova se unë nuk vija nga fusha përkatëse dhe se njohuritë e mia në këtë lëmi kufizoheshin në njohjen e koncepteve themelore profesionale, terminologjike dhe shkathtësive të komunikimit gjuhësor dhe me këtë mjaftonin për të kryer si duhet punën time, ata "sugjeronin" me këmbëngulje madje, që ta marr seriozisht idenë. "S'ka rëndësi", pohonin me bindje, përderisa paraqitja ime paskësh qenë bindëse.

Idenë nuk e mora seriozisht, jo për mungesë vetëbesimi a guximi. Kam refuzuar edhe intuitivisht, sepse jam habitur me mendimin se si njeriu mund të përpigjet të shtrijë ndikimin te të tjerët për një temë të caktuar, pa qenë vetë plotësisht i bindur për idetë që mëton t'i shpërndajë, bindje e cila del si pasojë e të qenit i vetëdijshëm për limitet e kapacitetit profesional. Që kam pasur të drejtë, e kam mësuar më vonë. Në ligjëratat e tij, një ndër profesorët më të shquar të fushës së investimeve dhe biznesit, Charli Munger asnjëherë nuk harron të shtjellojë çështjen e asaj që ai e quan "Rrethi i kompetencës", një teori, të cilën ai e ka zhbërthyer së bashku me kolegun e tij, Warren Buffet, specialistin që nga një fabrikë tekstili ka ngritur konglomeratin më me influencë të kompanive amerikane dhe botërore të shekullit XX dhe XXI, Berkshire Hathaway.

Secili individ, sipas Buffet dhe Munger ka një rreth të caktuar të kompetencës. Suksesi i kësaj teorie bazohet në njohjen e kompetencave vetanake dhe në përqendrimin në to. Me këtë rast është plotësisht irrelevante të jesh "ekspert" në sa më shumë fusha, ndërsa është thelbësore të dish ku janë kufijtë e kompetencave tua. Këtë koncept Munger dhe Buffet e kufizojnë me vlerësimin se njerëzit që dinë të lëvizin dhe përqendrohen vetëm në rrethin e kompetencës së vet, kanë shumë gjasa të jenë të suksesshëm, ndërsa probabi-

liteti tek ata, të cilët ndodhen vazhdimisht jashtë atij rrethi, është tejet i lartë që të hasin në vështirësi të vazhdueshme dhe të dështojnë.

Këtë strategji ata e kanë aplikuar në fushën e biznesit dhe investimeve, në mes tjerash si rekomandim për këshilltarët përkatës, gjatë vlerësimit të kompanive aksionare, mirëpo ajo përbën një teori të aplikueshme pothuajse në të gjitha sferat e jetës. Sipas Munger, ekzistojnë dy lloje të dijes: dija e vërtetë që e kanë nxënë njerëzit nëpërmjet arsimimit të angazhimit, duke investuar mund dhe kohë dhe dija e supozuar, të cilën pretendojnë se e kanë njerëzit që bëhen kinse dinë. Se sa të shpeshta janë rastet, kur edhe një njeri tejet inteligjent dhe me përvojë të madhe mund të bjerë në grackën e grupit të dytë, këtë ai e ilustron nëpërmjet një shembulli, sa interesant, aq edhe autentik, personazhe të të cilit janë nobelisti Max Plank dhe shoferi i tij.

Të tillë, sikurse studentët e prokurimit që, le të themi kanë rënë pre e besimit në dijen supozuar, për fat të keq kam takuar pa numër që nga ajo kohë. Gjuhëtarë që hiqen për njohës të politikës së jashtme, ndërsa zor se mund të përkufizojnë qëllimin e ekzistimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, ekonomistë që hiqen për

ekspertë të biologjisë, sepse nga një video fast motion kanë arritur të kuptojnë "në thelb" procesin e fotosintezës, këngëtarë që mëtojnë të japin mendime për politikën makro-financiare, politikanë, të cilët duke u thirrur në relativen mbahen për njohës të apasionuar të artit, biznesmenë që trajtojnë "me seriozitet" ligjin e arsimit, apo gazetarë që merren me sqarimin e teorive konspirative, ndërsa supozojnë se dinë gjithçka! Por cilat janë arsyet për një sjellje të tillë dhe aktrimi si intelektualë? Mbase qasja joserioze ndaj arsimimit të mirëfilltë, mungesa e leximit dhe injoranca. Është fshehtësi publike blerja e diplomave universitare.

Me këtë fakt mjaftohen të interesuarit e nuk çajnë kokën me libra. Shtrirja e internetit pothuajse falas gjithandej, iu ka mundësuar mediave që ekzistojnë pa kriter, shpërndarjen e informacioneve të cekëta e krejtësisht të pavërtetuara, ndërsa mungesa e dijes themelore, mbi të cilën do të mund të ndërtohej dija e argumentuar, shtyn lexuesin modern që të gjitha informacionet e reja, të pafiltruara t'i marrë për fakte të kryera. Më tej, rrjetet sociale ofrojnë hapësirë shumë të volitshme edhe për grupe të tëra pseudo-intelektualësh, të cilët përhapin qëndrime të paqarta

Rrjetet sociale ofrojnë hapësirë shumë të volitshme edhe për grupe të tëra pseudo-intelektualësh, të cilët përhapin qëndrime të paqarta rreth pothuajse të gjitha temave aktuale në botë. Ato e kanë lehtësuar tej mase shndërrimin e njerëzve në injorantë



rreth pothuajse të gjitha temave aktuale në botë. Ato e kanë lehtësuar tej mase shndërrimin e njerëzve në injorantë. Këtë e dëshmon më së miri edhe, por jo vetëm, shfrytëzimi i këtyre rrjeteve për vetëpromovim të tepër, i cili nga një aspekt stimulum i është kthyer në një imperativ me qëllim parësor - reklamimin e vlerave të paqena.

Përqendrimi në një fushë të caktuar që njeriu e njeh, sepse ka nxënë njohuri akademike, ka mbledhur përvojë praktike dhe ka dëshmuar se di të argumentojë çështje të ndryshme të ndërlidhura mes vete - proces nga i cili është në gjendje të nxjerrë dije të re - është i pamohueshëm, nëse dëshirojmë të jemi të suksesshëm në jetë.

Ndërsa njohuritë plotësuese, qoftë sipërfaqësore, apo deri diku solide në fusha të tjera duhen parë vetëm si vlerë e shtuar, brenda dijes së përgjithshme. Asgjë më shumë.

Këtë e kanë kuptuar kaheerë paraardhësit tanë, shumë nga të cilët për dallim nga ne, nuk e kanë pasur fatin as të ndjekin studime në universitetet e as të marrin pjesë në trajnime të thjeshta a të avancuara në institute prestigjioze, por kanë ditur të thonë: "Zanarit të huej veç puna e m'arë thuej!". (Zëri.info)

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përtheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribucioni: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 koggio | Data e shtypjes e enjte 26 prill | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Macroni, kundërhelmi për Trumpin

Nga
Michael KNIGGE



Vizita e zgjeruar e Emmanuel Macron në SHBA ishte e ndarë në dy pjesë: Në qendër të pjesës së parë ishte vetë presidenti francez dhe presidenti Trump, sepse ai e ftoi presidentin francez për vizitë shtetërore në Uashington. Macron nga ana e tij i shpjegoi me mirësjellje diferencat politike, por u përball me respekt me mikpritësin. Presidenti francez nuk mund t'i shpëtonte ashtu si edhe krerë të tjerë qeveritarë trajtimit tipik Trumpian. Në përpjekjen për të nderuar mikun, shprehimisht për ta bërë "më të bukur", Trumpi i pastroi me dorë zbokthin nga xhaketa e kostumit Macron. Ai i dhuroi një puthje në ajër presidentit francez dhe e tregoi veten të stuhishëm si gjithmonë.

MACRON NUK E NDRYSHOI QËNDRIMIN E TRUMPIT

Në deklaratat publike dhe gjatë konferencës së shtypit, Trump nuk ndryshoi pozicion për temat që kishin rëndësi për presidentin francez: zgjatja e marrëveshjes atomike me Iranin, an-

Vizita e presidentit francez, Emmanuel Macron tek Donald Trump ishte e suksesshme. Në fjalimin e tij të fuqishëm para Kongresit Amerikan, Macron tregoi se di t'i dalë përballë mikut të tij Trump

gazhimin e mëtejshëm të SHBA në Siri, luftën kundër ndryshimit të klimës, dhe dhënien fund të kërcënimeve për futjen e doganave ndëshkuese për mallrat nga BE. Macron ia doli të anashkalojë këtë e të mos e jepte veten, para spektaklit pa stil të Trumpit.

Pas kësaj pjese të parë, mund të kishë përshtypjen, se Trump nuk e trajton Macron si partner të barabartë. Madje as nuk mund ta mënjanojë simpatinë për Macron për këtë. Trump e mbushi me komplimente homologun e ri, i tregoi rezidencën e George Washingtonit në Mount Vernon, dha një banket shtetëror për nder të tij. Por më vonë publikisht ai i hodhi tutje propozimet e Macron. Nga Shtëpia e Bardhë, Macron nuk mori me vete më shumë se formulën standarde: "Do ta marrim vesh shpejt".

MACRON MBRON VLERAT EUROPIANE

Por pas kësaj erdhi akti i dytë i vizitës së Macron në SHBA, momenti kur foli para senatorëve dhe deputetëve të Kongresit Amerikan. Këtë fjalim ai e

mbajti në anglisht, gjë e pazakontë për një president francez. Ajo që parashtrio Macron nuk ishte gjë tjetër, veçse një refuzim direkt i politikës Trumpiane dhe taktikës që e solli atë në pushtet. Macron mbrojti me pasion demokracinë, lirinë, tolerancën e të drejtat e njeriut si edhe bashkëpunimin ndërkombëtar - një pretendencë e fuqishme e vlerave të sulmuara perëndimore.

E të gjitha këto Macron i tha para një kongresi të kontrolluar nga republikanët, që me pak përjashtime e mbështet presidentin Trump, i cili shpesh i injoron këto vlera. Fakti që fjalimi u mbajt në zemër të demokracisë së Shteteve të Bashkuara i dha atij një peshë të veçantë. Por kur kjo vizitë e Macron u përbë nga dy pjesë, a mund të quhet si sukses, kur Macron nuk ia doli ta lëvizë Trumpin nga pozicionet e tij? Po, dhe kjo për dy arsye.

SUKSES PËR MACRON DHE BE

Së pari, sepse në Uashingtonin e Donald Trumpit duhet të jesh mirënjohës për çdo lloj suksesi të vogël. Pas suksesit të papritur në

zgjedhje, vëzhguesit në kryeqytetin amerikan spekulonin gjysmë me shaka, se banketi i parë shtetëror do të shtrohej për kryeministrin hungarez, Viktor Orban. E aq larg realitetit këto spekulime nuk ishin, në fund të fundit politikani i parë europian, që e vizitoi Trumpin pas zgjedhjes së tij ishte Nigel Rafege, strategu i Brexitit. Dhe tani Trump e cilëson diktatorin koreanove-ror "një njeri të nderuar".

Para këtij sfondi ftesa për Macron, presidentin e një vendi tradicionalisht aleat por edhe një anëtar qendror në BE- nuk ishte e vetëkuptueshme. Përkundrazi: Ajo mund të shihet si një sukses si për Macron ashtu edhe Bashkimin Europian. Së dyti Macron e përdori vizitën e tij, e sidomos fjalimin e tij para kongresit amerikan, për t'i risjellë në vëmendje vlerat perëndimore dhe për t'i mbrojtur ato. Duke e bërë këtë me emocion dhe retorikë të shkëlqyer ai skicoi vizionin e një bote, që mund të përshkruhet si kundërpesha e botëkuptimit të Trumpit. Nxjerrja në pah e kësaj alternative ishte sa e shumëpritur aq edhe e nevojshme.

Mediat në kthetrat e autokratëve

Nga
Volker WAGENER



Nerdhi një letër nga Hungaria. Një ish-zyrtar i lartë i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Hungarisë i ka shkruar Deutsche Welles, se si ai dhe mijëra të tjerë humbën vendin e punës në vitet e fundit. Ai do të dëshironte të paraqiste sfondin e largimit nga detyra dhe nxjerrjen masive në rrugë të zyrtarëve të papreferuar dhe gazetarëve në Hungarinë e Orbanit. Dhe pyet a mund ta botojë Deutsche Welle këtë...Po mundemi. Kjo edhe sepse nuk është e mundur për të në vendin e tij. Nuk ia boton më kush. Dhe nëse po, atëherë e ardhmja e kësaj medieje është vënë në rreth të kuq.

Letra nga Budapesti dhe raporti vjetor për lirinë e shtypit në botë të Reporterëve pa kufi puqen me njëra-tjetrën. Hungaria, dikur prototipi i një vendi shembullor europianolindor bie me 50 vende në rangun e 73 në çështjet e lirisë së shtypit. Edhe në vende të tjera të Europës Lindore e Juglindore gjendja nuk është më e mirë, madje më keq. Ndërkohë në Maltë dhe Sllovakia mund të lësh edhe jetën në kërkim të së vërtetës. Ose ndryshe për të mbajtur nën rogat të vërteta të pakëndsh-



me, shkelje kriminale politike kryhen vrasje. Thënë shkurt: Europa në lindje të Perdes së dikurshme ideologjike-politike është sërish një territor medial në krizë. E kush thotë se probleme ka vetëm në Afrikë dhe Azi?

Këtë e ilustron më qartë "pacienti bullgar". Vendi që ka presidencën e radhës në BE qëndron në vendin e 111 nga 178 vende në listën e lirisë së shtypit të Reporterëve pa kufij. Në fund të vendeve europiane. Me vendin e 15 as ne gjermanët nuk duhet të hapim

shumë gojë duke dhënë leksione. Sepse ky rezultat nuk shkon me vetëdijen tonë si nxënësit më të mirë të klasës.

Por sidomos BE e ka një problem. Kur presidenti francez, Emmanuel Macron kërkon të ndajë unionin ekonomikisht në dy pjesë me shpejtësi të ndryshme, kjo vlen në radhë të parë për realitetin medial. Pikërisht vendet e Vishegradit, në stekën lindore pak a shumë elitare, ndërhyjnë paturpshëm në zanatin e fjalës së lirë. Hungaria zë vendin e 71, Polonia vendin e 58 në këtë

Europeanëve u pëlqen roli i më të mirit në klasë. Lirinë e kemi të shenjtë, edhe lirinë e medias, ku ka shumë probleme, sidomos në Europën Lindore

listë, Sllovakia të 27-in, Çekia vendin e 24 - një dëftesë e dobët për ndërgjegjen e këtyre vendeve që e vendosin veten në zemër të Europës.

Javën e shkruar një medie e bindur ndaj Orbanit publikoi një "listë të zezë të gazetarëve". Në rend të parë të korrespondentëve të padëshiruar ishte reporter i Deutsche Welles, Keno Verseck. Lista është një sinjal i dyfishitë. Ajo nuk qëndron vetëm simbolikisht për realitetin mediatic hungarez, sipas motos së Orbanit, që kërkon të praktikojë demokracinë iliberale, por me konsekuencë kërkohet të bëhet "iliberale" edhe peizahi mediatic.

Sinjali tjetër është ai që Brukseli, Parisi e Berlina duhet ta regjistrojnë. Radioja e jashtme në epokën digjitale mund të përjetojë një bum të ri. Si një zë alternativ nga jashtë. Kur në Poloninë e partisë PiS apo Hungarinë e Fidesz instalohen faktikisht autokratë, që monopolizojnë për veten "të vetmet të vërteta ekskluzive", atëherë duhen alternativa të tjera.

Jo më kot së fundmi në Berlin janë krijuar disa qarqe gazetareske për vendet nga Lindja. Dikur ne këta i quanim disidentë. (DW)

Waffen-SS kishin vendosur një mënyrë promovimi mjaft inovatore, filmoheshin në aksion, në mes të flakëve me uniformat e tyre të veçanta dhe mahnitja e publikut ishte gjithçka. Miti po përhapej, ata ishin elita. Kjo bindje e gabuar u vu re shumë vonë. Doli gjatë hetimeve të bëra nga aleatët, ku u bënë të dukshme ndryshimet me këmbësorinë e zakonshme të ushtrisë

Nëndetëset gjermane mund të kishin kthyer rrotën e historisë, Adolf Hitleri fitoi para një sulmi të Jozef Stalinit, ushtari amerikan nuk dinte të luftonte, Waffen-SS ishin të përbërë nga ushtarë elitë. Këto janë disa nga mitet e krijuara gjatë Luftës së Dytë Botërore. Disa versione janë marrë si të vërteta absolute para, gjatë dhe pas luftës. Këto të vërteta u krijuan nga makineria e majtë e Joseph Goebbels-it, përhapësi i regjimit nazist. Që nga zyrat e ministrisë për lustracionin publik dhe propagandën, ai ushqente mitet që përsëriteshin sistematikisht nga mediat masive të Rajhut të Tretë si dhe nga posterat e shumtë në rrugët e Gjermanisë naziste dhe në qytetet e pushtuara. Aty instrumentalizoi një plan që popullsia të perceptonte Erwin Rommel si një strateg në nivelin e admiralit Horatio Nelson. Bëri të pamundurën që vrasarja Waffen-SS të shihej nga rivalët dhe nga të tijtë si një forcë elite. Këta luftëtarë avangardistë analizohen nga historiani Jean-Luc Leleu, i cili përshkruan me detaje gënjeshtat kirurgjikale që u qepën në mënyrë që këta oficerë të shiheshin si anëtarë të një brigade ushtarake perfekte. Sipas Leleut, ideja e një fanatizmi që i çoi ushtarët SS drejt një përçmimi të rrezikut në fushat e betejës u instalua tek populli gjerman në fund të dimrit të parë në luftën e lindjes. Këtu kjo brigadë u pagëzua me frikën dhe forcën. "Për të përcaktuar elitizmin ushtarak duhet të flasësh për një aftësi të trupave për të përmbushur misionin e vet me shpejtësi dhe efikasitet, me sa më pak humbje, - shprehet autori, - diçka larg realitetit të jetuar për agentët e Waffen-SS".

Urdhri i zi, kështu thirreshin së brendshmi forcat SS, adhuronin elitizmin racial. Kandidatët për të bërë pjesë në këtë skuadër vrasësisht të idealizuar seleksionoheshin sipas kriterëve mjekësorë të gjatësisë, të aparancave fizike dhe nga prejardhja. Një akreditim që me krenari anëtarët garantonin para popullit gjerman vlera dhe trimëri duke përmbushur para-



WAFFEN-SS,

VRASËSIT ELITË NËN

URDHRAT E FYHRERIT



metrat e një pastërtie që pretendonte regjimi nazist. Nëse bëje pjesë në forcat SS ishte sepse kishe kredenciale raciale të papërlyera. Ata ishin superiorë rastësisht. Propaganda dhe lobi i brendshëm i Himlerit bëri që Adolf Hitleri të kishte një dobësi për forcat e Waffen-SS. Vetshpallja elitare e SS-ve bazohej tek siguria e mishërimit të ideologjisë nacionalsocialiste

më të pastër dhe që ishte organi ekzekutiv më i besueshëm në shërbim të regjimit dhe të vetë shefit, Adolf Hitlerit, - shpjegon Leleu. Por virtytet që e bëjnë një ushtar të mirë nuk u përmbushën nga ata që kishin një S të dyfishtë në uniformat e tyre.

Një instruksion ushtarak i dobët, shumë nga nënoficerët e parë kishin një formim të ulët në

kohë dhe në cilësi, - kështu shkruhet në një shkrim të Heer-it, ushtria e Wehrmacht-it, forcat e armatosura gjermane. Kandidatët SS merrnin një instruksion që shtrihej prej 10-16 muaj, ndërsa trupat e tjera të zakonshme i nënshtroheshin stërvitjes prej 24 muajsh dhe me më shumë pajisje dhe me më shumë oficerë me përvojë. Ideja e përkatësisë së një trupe elitare raciale që i përgjigjej urdhrave të Hitlerit ishte e pazezueshme. Në terrenin e luftës treguan një mungesë profesionalizmi, por humbjet nuk zvogëluan vullnetin e këtyre forcave për t'u quajtur elitë. Raprezaljet kundër civilëve dhe ushtarakëve të kapur ndihmuan në fshirjen e dështimit të tyre, - shprehet autori. I tillë ishte ekzekutimi i qindra robërve britanikë të luftës në Wormhout në maj të vitit 1940, ku u duk qartë poshtërsia dhe mungesa e disiplinës ushtarake që përfaqësonin. Tmerri dhe frika që përhapnin ata



ishite thjeshtë një propagandë dhe këtë e tregojnë numrat gjatë fushatave. 5 muaj nga krijimi i operacionit Barbarosa gati 9% e trupave të Waffen-SS kishte vdekur.

"Një numër i lartë vdekshmërie, gati dy herë më i lartë se ai i ushtrisë së zakonshme dhe për këtë disfatë ata nuk bënë autokritikë, - shprehet Leleu. Ajo çka bënë ata ishte së ndërronin vazhdimisht formacionin e trupave dhe vunë në krye të tyre një fanatik Theodor Eicke, një ish komandant i rojeve në kampet e përquadrimit. Ky oficer arriti të përmirësonte cilësinë e trupave SS. Forcat SS kishin mangësi në luftime të këmbësorisë, luftime në xhungël ose natën, për t'u kamufluar, në mësymje të shpejtë, ruajtjen e një disipline zjarri, - thotë akademiku. Himleri shfrytëzoi ekstremisht çdo sukses të vogël të këtyre forcave politike dhe i paraqiti si gjenocid i trimërisë të trupave të tij. Këto ia çoi në vesh Hitlerit për t'i quajtur si trupat e partisë dhe kjo krijoi mundësinë të kërkonte resurse më të mëdha për njerëzit e tij. Pas dështimit të operacionit Barbarosa, Hitleri i konsideroi si shembulli i një Wehrmacht-i nacionalsocialist të ardhshëm. Për të ushqyer mitin tek popullata forcat SS punësuan një grafist të njohur, Ottomar Anton, afishet e të cilit me estetikën e tyre u dhanë forcave të Waffen-SS një imazh tejet tërheqës dhe që ngjallnin vokacione tek të rinjtë. Ishte një mënyrë rekrutimi i të rinjve që aspironin të bëheshin pjesë e forcave të Fyhrerit.

Megjithatë propaganda nuk mbeti vetëm tek afishet, Himleri krijoi një shoqëri të përbërë nga korrespondentë luftime që shoqëronin ushtarët gjatë operacioneve të tyre dhe sillnin mijëra boletinë me informacione mbi bëmat të përsëritura dhe të shumëfishuara në të gjitha mediat. Kinematë projektonin dy ose tri lajme mbi uniformat elitë në emisionet e tyre javore. Kjo ishte mënyra për të qenë mbi forcat e armatosura. Ky sistem i përhapjes u ruajt deri në fund të luftës, sipas historianit. Propagandistët nuk i lanë asgjë rastësisë. Waffen-SS kishin vendosur një mënyrë promovimi mjaft inovatore, filmoheshin në aksion, në mes të flakëve me uniformat e tyre të veçanta dhe mahnitja e publikut ishte gjithçka.

Miti po përhapej, ata ishin elita. Kjo bindje e gabuar u vu re shumë vonë. Doli gjatë hetimeve të bëra nga aleatët, ku u bënë të dukshme ndryshimet me këmbësorinë e zakonshme të ushtrisë. Dy muaj para mbarimit të luftës shërbimet sekrete amerikane filluan të rishikojnë pozicionin e forcave Waffen-SS dhe u vu re një devijim i mitit, shprehet Leleu. Megjithatë konfirmimi erdhi vonë. Miti ishte rrënjësor fort.

(bota.al)



YouTube

YOUTUBE "MBRON" DHUNËN IZRAELITE

Youtube ka vendosur kufizime në moshë ndaj një videoje të cilën filimisht e kishte larguar nga platforma dhe më pas ripostuar pas reagimeve të shumta, në të cilën shfaqet dhuna e ushtrisë izraelite ndaj civilëve palestinezë

Platforma më e madhe globale e internetit për shpërndarjen e videove, Youtube, ka ripostuar një video që tregonte vrasjet dhe dhunën izraelite ndaj civilëve palestinezë pas reagimeve të shumta për largimin e saj ditë më parë, por ka vendosur kufizime në moshë. E titulluar "Izraeli gjuan për të vrarë tekta getot e Gazës i rezistojnë rrënimin", videoja e një palestinezi me emrin Sana Kassem ishte hequr nga Youtube më 22 prill.

Pas reagimeve dhe ankesave të shumta, përfshirë ato të profesorit hebre që jeton në SHBA, Norman Finkelstein, videoja sërish është vendosur në faqe më 25 prill, por

me kufizim moshe. "Do të presin me durim derisa të vriten tërë fëmijët në Gaza nga ana e Izraelit, dhe më pas do ta ripublikojnë këtë video", tha për AA profesori Finkelstein, i cili reagoi për largimin e videos. Finkelstein ka marrë përgjigje për ankesën në Youtube pak pas deklaratës për AA. Ai njoftoi se i është thënë që videoja në fjalë "nuk është e përshtatshme për të gjitha grupmoshat" dhe se është ripostuar në platformë me kufizim në moshë. Profesori hebre Finkelstein ka ndarë me opinionin përgjigjen që ka marrë nga Youtube. "YouTube ripostoi videon e Gazës, por e klasifikon atë si porno-

grafi", tha Finkelstein në llogarinë e tij në Twitter, ku gjithashtu ndau videon. Videoja në fjalë mund të shikohet vetëm pas hyrjes me emër përdoruesi dhe konfirmimit të moshës. Videoja e gjatë katër minuta e 40 sekonda nga Sana Kassem, rrëfen shkurtimisht incidentet e sulmeve të ushtarëve izraelitë ndaj palestinezëve gjatë protestave të tyre në Rripin e Gazës. Të paktën 41 palestinezë janë vrarë dhe mijëra të tjerë janë plagosur nga sulmet e ushtrisë izraelite që nga 30 marsi, kur palestinezët filluan të tubohen në mënyrë paqësore përgjatë kufirit lindor të Rripit të Gazës me Izraelin nën moton

"Marshi i Kthimit të Madh" me rastin e "Ditës së Tokës", 42-vjetorit të pushtimit të një pjese të madhe të territoreve palestineze nga ana e Izraelit më 30 mars të vitit 1976. Tubimet janë pjesë e një demonstrate gjashtë-javore që do të kulmojë më 15 maj. Kjo ditë do të shënojë 70 vjetorin e krijimit të Izraelit, ngjarje që palestinezët i referohen si "Nakba" ose "Katastrofa".

Demonstruesit kërkojnë që refugjatëve palestinezë t'u jepet "e drejta e kthimit" në qytetet dhe fshatrat e tyre në Palestinën historike, nga e cila u dëbuan në vitin 1948 për t'i hapur rrugën krijimit të shtetit të ri të Izraelit.



I bërtiste gruaja, arratiset për 10 vite në pyll

"Isha një kopshtar dhe për 25 vite me radhë me pëlqente puna që bëja. Shkoja çdo ditë me pasion dhe dëshirë për të punuar deri kur...u martova". Kështu nis rrëfimi i pazakontë i një 62-vjeçar britanik. "Asaj nuk i pëlqente që isha për orë të gjata duke kryer punën time! Fillimisht më kontrollonte, më bërtiste e më merrte në telefon vazhdimisht deri në momentin që më kërkoi të hiqja dorë nga puna që bëja", vijon rrëfimin e tij, 62-vjeçari Malcolm Applegate nga Birminghami. "Vitet kalonin dhe ajo bëhej gjithmonë e më shumë kërkuese e xhelozë. Kërkonte të më kontrollonte vazhdimisht", shton ai. I lodhur nga bezdisja e gruas, Malcolm nuk iu drejtua gjykatës për divorc, por vendosi ta braktisë bashkëshorten pa lënë "nam e nishan". "Jetova për 10 vite në pyll pranë Kensingtonit. Kisha ndërtuar një kasolle aty. Dilja në qytet për të punuar si kopshtar, për të blerë ushqimet bazike dhe rikthehesha sërish atje", tregon ai. Pas një dekade mes pyllit, me energjitë që po i shteronin për shkak të moshës dhe i sigurtë se gruaja nuk do ta bezdiste më, Malcolm vendos t'i rikthehet gjirit të njerëzimit. Ai aplikoi për t'u strehuar në një strehë sociale të quajtur "Emmaus Greenwich". Pikërisht kjo e fundit ka publikuar në faqen e saj të internetit historinë e pazakontë të Malcolm.



Tre hapat për ta lënë duhanin

Më poshtë gazeta KOHA ju sjell tre hapat që duhet t'i kaloni për ta lënë duhanin:

1. Mendoni mirë nëse doni vërtet ta lini duhanin. Nikotina është jashtëzakonisht adiktive dhe duhet vendosmëri për ta lënë. Pyeteni vetën nëse jeta pa duhan është më e mirë se sa të vazhdoni me duhan. Nëse i përgjigjeni vetes PO, atëherë keni arsye për ta lënë duhanin.
2. Vendosni pse doni ta lini duhanin. Bëni një listë të të gjitha arsyeve që doni ta lini. Kjo do t'ju ndihmojë t'ia sqaroni vetes se pse doni ta lini duhanin.
3. Jini të gatshëm për simptomat që do të shfaqen kur nikotina fillon të largohet nga trupi. Duhani e mbush trupin tuaj me nikotinë, kur nikotina fillon ta braktisë trupin, ju do të përjetoni ankth, depresion, lodhje, apetit të rritur dhe shtim të peshës, po ashtu probleme në përqendrim.



Në Gjermani, dëmtimi i foleve të grerëzave mund të arrijë gjobën deri në 15 mijë euro, ndërsa të grerëzave të llojit të veçantë, deri 50 mijë euro

Të rrezikshme, por mbytja e një grerëze kushton deri 50 mijë euro

Edhe pse për shumicën e njerëzve, insektet paraqesin shqetësim, ata janë të mbrojtur në mënyrë të veçantë. Ai i cili e zë, e lëndon apo edhe e mbytë një grerëz pa ndonjë arsye të duhur, në Baden-Württemberg duhet të llogarisë në gjobë prej 15 mijë eurosh. Po qe se gjatë kësaj bëhet fjalë për ndonjë insekt të llojit të veçantë, gjoba mund të arrijë shumë deri në 50 mijë euro. Lloje të mbrojtura të grerëzave janë edhe grerëza e ashtu-

quajtur centrifugale dhe grerëzat me brirë, shkruan "Berliner Zeitung", përcjell Albinfo.ch. Dëmtimi i foleve të grerëzave mund të arrijë gjobën deri në 15 mijë euro, ndërsa të grerëzave të llojit të veçantë, deri 50 mijë euro.

Gjoba për grerëzat dallon sipas rrethit në Gjermani, psh në Thüringen dhe Nordrhein-Westfalen duhet llogaritur në 50 mijë euro gjobë pa marrë parasysh se për çfarë grerëzash bëhet

fjalë, ndërsa në Brandenburg edhe deri në 65 mijë euro gjobë. Në rastin e bletëve, gjobat janë më të rrepta dhe duhet llogaritur deri në 50 mijë euro gjobë po që se lëndohet, mbytet apo dëmtohet një bletë. Në Brandenburg kjo shumë arrin shifrën deri 60 mijë euro. Deri më tani nuk ka pasur ndonjë rast konkret para gjykatave, ka pohuar Dr. Melanie von Orlow nga Organizata për mbrojtjen e natyrës në Berlin.

Kryeministri Edi Rama ka pasur një ditë të sikletshme të mërkurën në Berlin për shkak të deputetëve të djathtë gjermanë.

POROSIA GJERMANE PËR RAMËN: NISE ME SAIMIR TAHIRIN...

Sipas Deutsche Welle, pikërisht për të mënjauar këto rezerva, Edi Rama, kërkoi ndihmë ku të mundte. Ai u takua me presidentin e Bundestagut, Wolfgang Schäuble, një nga figurat më të vjetra të partisë, fjala e të cilës është me peshë, si edhe pati një dëgjim pikërisht në Komisionin e Bundestagut për Çështje të BE-së, që drejtohet pikërisht nga Günther Krichbaum, politikani CDU që u përfol aq shumë nga disa media në Shqipëri, pasi nuk iu bashkua euforisë që kishte kapluar Shqipërinë pasi komisioni dha rekomandimin.

Në mbrëmje, Rama pati një takim më të ngrohtë, në fondacionin e Partisë Socialdemokrate, simotërës së Partisë Socialiste në kuadër të Internacionales Socialiste. Rama ishte ftuar aty të diskutonte me Ministrin Gjerman për Evropën, Michael Roth, për Shqipërinë dhe mundësinë e çeljes së negociatave.

Roth vuri në dukje se çelja e negociatave nuk pritet me eufori nga vendet anëtare të BE-së. "BE po kalon kohë të vështira, sepse ka një sërë problemesh të brendshme dhe nuk është e gatshme për anëtarë të rinj".

Veç lëvdatave për arritjet në procesin e vetingut, Roth nuk harroi t'i kujtonte mikut të tij socialist, se reforma gjyqësore pa një proces



kundër ish-ministrit të brendshëm, Saimir Tahiri, nuk mund të bëhet.

"Ndaj duhet filluar procesi gjyqësor kundër ish-ministrit të Brendshëm Saimir Tahirit për të dëshmuar kështu se pavarësia e gjyqësorit me të vërtetë funksionon," tha Roth.

Sipas gazetës gjermane Tagespiegel, takimet nuk kanë shkuar siç duhet për kryeministrin Edi Rama. Në një shkrim të saj kjo gazetë shkruan se Merkel nuk është angazhuar për bisedimet për hapjen e negociatave për Shqipërinë.

"Kancelarja nuk u angazhua për

paraqitjen e përbashkët me Ramën në Kancelari, nëse ajo mbështet fillimin e negociatave të pranimit. Merkel tha se do të formonte një opinion përfundimtar deri në kohën e samitit vendimtar të BE në qershor", shkruhet në shkrimin e gazetës gjermane.

Por media gjermane shkruan se jo të gjithë deputetët janë dakord për të votuar për hapej ne negociatave për Shqipërinë.

Ndërsa gazeta Koha Jonë shkruan se priten arrestime të bujshme.

"Kryeministri Rama dhe delegacioni që e shoqëronte e nisi rrugëti-

min e lobimit për hapjen e negociatave nga Gjermania, vendi që ka peshën kryesore në BE. Mesazhet që i përcolli dje Merkel e bëjnë edhe më të paqartë vendimin e Këshillit të Ministrave të BE në muajin qershor. Nëse Gjermania, një vend që ka investuar këtu dhe ndjek nga afër reformat ende nuk është e bindur për Shqipërinë, çfarë qëndrimesh do të kenë Franca dhe Holanda që kanë më pak interesa në rajon? Por mbi të gjitha, qeveria ka një detyrë konkrete të përbushë kushtet e Gjermanisë deri në 29 qershor. Nëse qeveria e shpalli të përfunduar çeljen e negociatave me marrjen e rekomandimit, Angela Merkel dje tha se do të verifikohet plotësimi i kriterëve në ditët në vijim. Pyetje shtrohet se çfarë ka kërkuar në kushtet shtesë Gjermania? Detyrat e shtëpisë duhet ti jenë dorëzuar Edi Ramës në takimin "kokë më kokë" dhe lista e kushteve duket se nis që nga lufta e krimit të organizuar dhe deri te menutë me "peshq të mëdhenj".

Një informacion i fundit tregon për "Koha Jone" se është marrë vendimi nga prokuroria (detyruar nga presioni i kryeministrit Rama prej dajakut Merkel) për arrestimin e tre ish-ministrave dhe një ministër aktual, si dhe po piqet hallva e fundit për ish-kryeprokuroren dhe ish-ministrin e brendshëm.

Janë në listë ndalimi tre kryetarë bashkish. Që të gjitha arrestimet para fundqershorit," shkruan gazeta.

Londra presion Beogradit për Kosovën

Portali nga Beogradi "Srbija Danas" (Serbia sot), ka shkruar se Britania e Madhe ka hyrë në luftë të haptë me Serbinë në të cilën nuk do të zgjedhë mjete.

Sipas këtij portali qëllimi i kësaj lufte është për ta rrëzuar Vuçiqin dhe pushtetin në Beograd, për ta ndarë Serbinë nga Rusia dhe për t'ia siguruar Kosovës pavarësinë e plotë dhe ulësen në Kombet e Bashkuara. Nga Londra, gjithnjë sipas këtij portali, ka arritur mesazhi i qartë për Serbinë dhe për vendet që rishqyrtojnë njohjen e tyre të Kosovës ose që Serbinë e përkrahin në ndonjë mënyrë:

"Do ta shkelim çdo kë që do ta përkrahë Serbinë". Ndryshe edhe Franca sot është raportuar se do t'i dërgojë notë proteste çdo shteti që në të ardhmen, eventualisht, me kërkesë të Serbisë, do të tërheqë njohjen e pavarësisë së Kosovës, transmeton RTV21.



Vuçiq për Kosovën: Pranojmë kompromise, por jo poshtërime

Presidenti serb, Aleksandar Vuçiq gjatë takimit me presidentin e Këshillit Evropian, Donald Tusk në Beograd ka folur edhe mbi projektet e infrastrukturës. Vuçiq ka thënë se është diskutuar për autostradën Nish-Prishtinë e cila është e rëndësishme për të gjithë rajonin. Sipas tij, lidhja e shqiptarëve dhe serbëve në të ardhmen do të kontribuojë edhe në rritjen e ekonomisë, përcjellë lajmi.net.

Ai ka treguar që projekti i financuar nga Serbia është 77 kilometra i gjatë dhe kushton rreth 350 milionë euro. Sa i takon zgjidhjes së çështjes së Kosovës, Vuçiq ka thënë se Serbia mund të pranojë çdo kompromis por jo poshtërimin e saj. "Ne duhet të luftojmë që fëmijët tanë të mos e kenë të njëjtin problem që e kemi ne sot", është shprehur Vuçiq.

Administratë gjigante, por pa efikasitet

Grupi i Veçantë për Reformën e Administratës Publike (GVRAP) ka mbajtur mbledhjen e radhës ku u vuri në pah rëndësia e vullnetit politik në rrugën e reformave shtetërore.

Derisa Komisioni Evropian kërkon sqarime lidhur me numrin e madh të zëvendësministrave në Qeverinë e Kosovës.

Ministri i Administratës Publike, Mahir Yagcilar, tha se ashtu siç është paraparë në Strategjinë për Modernizimin e Administratës Publike 2015–2020, Ministria e Administratës Publike në tetor të vitit 2017 ka filluar procesin e rishikimit të Planit të Veprimit për zbatimin e kësaj Strategji.

Ai ka përmendur edhe zgjedhjet me të cilat u përshkrua viti i kaluar, me ç'rast tha se përkundër kësaj, është arritur progres konkret në kuadër të të gjitha konkluzioneve të takimit të fundit të Grupit, që është mbajtur më 18 maj të vitit të kaluar.

"Modernizimi i administratës publike në Kosovë, transformimi dhe avancimi i saj, është një investim në



demokrasi dhe ekonomi, në përmirësimin e cilësisë së jetës për qytetarët tanë dhe në afrimin e shtetit tonë me pranë Bashkimit Evropian, që është interesi më i lartë shtetëror i yni", u shpreh ai.

Ndërsa David Cullen nga Komisioni Evropian ftoi për një zotim të përbashkët të të gjitha palëve për të çuar përpara reformat në administratën publike.

"I kemi disa pyetje serioze të cilat do t'i adresojmë, sa i përket masave sa

ndikojnë, dhe objektivin e një administrate të përgjegjshme dhe kompetente. Në raport kemi vërejtur një trend në rritje të zëvendësministrave të cilët në mandatin e kaluar ishin 45, ndërsa tash janë rreth 80. Duam të dimë se si ky numër i lartë i zëvendësministrave siguron efikasitetin. Për këtë do të japim edhe rekomandimet. Ka pasur një numër të procedurave të emërimeve, dhe emërimet në administratat publike janë çështje shumë e rëndësishme", tha ai.

Koha, e premte 27 prill, 2018

GJERMANIA KËRKON RREGULLA TË QARTA NË RRJETET SOCIALE



“Facebook-u është një rrjet jotransparent. Parimet etike bëhen viktime të interesave komerciale”, tha ministrja gjermane e Drejtësisë, Katarina Barley. Specialisti i Facebook-it, Hendrik Unger, në një bisedë me Deutsche Welle, megjithatë nuk beson se Facebook-u do të ndryshojë shumë në të ardhmen

Numri i përdoruesve të Facebook-it të keqpërdorur nga Cambridge Analytica është më i madh se që u tha në fillim. Zuckerberg shpreh keqardhje dhe bën autokritikë, por ekspertët janë skeptikë.

Skandali i të dhënave në Facebook vazhdon të ketë konsekuenca. Ndërsa në fillim u tha se numri i përdoruesve të rrjetit social, të dhënat e të cilëve janë përdorur nga firma kërkimore Cambridge Analytica, tani flitet për 87 milionë anëtarë. Të dhënat e një shumë përdoruesve u shfrytëzuan në fushatën zgjedhore të SHBA, por edhe përdoruesit gjermanë janë të prekur, gjithsej 310 mijë.

Në fakt prej këtyre vetëm 65 përdorues kishin plotësuar formularin e Cambridge Analytica, me

anë të të cilit, kjo kompani u ka vjedhur të dhënat atyre dhe miqve të tyre, dhe miqve të miqve të tyre e kështu me radhë. Ndërtë tjera, të dhënat i janë dhënë stafit të fushatës zgjedhore të Donald Trump-it.

Facebook-u e dinte qysh në vitin 2015 se Cambridge Analytica vidhte datat e përdoruesve. Por ky fakt vetëm tani depërtoi në publik.

“Facebook-u është një rrjet jotransparent. Parimet etike bëhen viktime të interesave komerciale”, tha ministrja gjermane e Drejtësisë, Katarina Barley.

Barley i bën thirrje rrjetit social që të marrë masa në nivel ndërkombëtar dhe bëri të ditur se tashmë po kontrollohet mundësia e rregullimit në nivel evropian.

“Duhet të caktojmë kërkesa të qarta për operatorët e rrjeteve sociale në nivel evropian”, tha ajo.

Përveç kësaj, Facebook-u duhet t’u zbulojë autoriteteve të BE-së mënyrën e funksionimit të algoritmeve të tij.

Në një telekonferencë me gazetarët të mërkurën, themeluesi i Facebook-it, Mark Zuckerberg ishte treguar vetëkritik, duke thënë se Facebook-u nuk kishte bërë mjaft për të mbrojtur përdoruesit e tij.

“Ky ishte gabimi ynë, ky ishte gabimi im”, pranoi Zuckerberg.

Rrjeti social ndërkohë e ka hequr funksionin e kërkimit të anëtarëve nëpërmjet adresave të e-mailit ose numrave të telefonit dhe e ka kufizuar qasjen e zhvilluesve të aplikacioneve të të dhënave e përdoruesve.

Zuckerberg do të dalë më 11 prill para Kongresit amerikan. Ai theksoi në telekonferencë se e gjen të mirë rregulloren e re evropiane për mbrojtjen e të dhënave personale që do të hyjë në fuqi më 25 maj.

“Rregullimet janë diçka shumë pozitive”, tha ai.

Specialisti i Facebook-it, Hendrik Unger, në një bisedë me Deutsche Welle, megjithatë nuk beson se Facebook-u do të ndryshojë shumë në të ardhmen.

“Zuckerberg-u duhet të kërkonte falje në emër të aksionarëve të aksioneve të tij. Por Facebook-u është një rrjet i hapur, ku ne paguajmë me të dhënat tona dhe çdo reklamues mund të na adresohet”, thotë Unger. /Telegrafi/



Papa: Më mirë ateist, sesa katolik hipokrit

Papa Françesku, ka thënë se është më mirë për të qenë ateist, e jo si shumë katolikë që sipas tij bëjnë jetë hipokrite të dyfishtë.

Duke ju bërë kritika disa prej anëtarëve të Kishës Katolike, ati i shenjtë ka thënë: Është skandaloze të thuhet diçka, e të diçka tjetër. Kjo është jetë e dyfishtë.

“Ka disa që thonë se “Jam katolik i vërtetë, cdo herë shkojë në meshë, i përkas kësaj apo asaj shoqate”, ka thënë Papa, shkruan Independent, përcjell Klan Kosova.

Ai ka thënë se disa njerëz duhet të thonë “Jeta ime nuk është krishterimi, nuk i paguaj të punësuarit siç duhet, shfrytëzoj njerëzit, bëj biznes të ndotur, pastroj para, unë bëjë jetë të dyfishtë”.

“Ka shumë katolikë që janë kështu dhe bëjnë skandale”. “Sa herë kemi dëgjuar njerëzit tek thonë ‘nëse ai person është katolik, është më mirë për të qenë ateist”.



Rusia do të dërgojë sisteme të reja ajrore në Siri

Gjenerali Sergei Rudskoi tha se Moska do ta furnizojë Sirinë me sisteme të reja të mbrojtjes raketore së shpejti, por nuk e specifikoi se për cilat lloje të armëve bëhet fjalë. Sipas disa njoftimeve, Moska po shqyrton dërgimin në Siri të sistemeve të sofistikuar tokë ajër S-300. Këto zhvillime vijjnë pas sulmeve që kanë kryer Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e tyre më 14 prill, mbi objektet e dyshuara të armëve kimike të Sirisë. Ofensiva ka qenë në përgjigje të një sulmi të dyshuar kimik në qytetin Duma, që ka lënë mbi 40 njerëz të vrarë, më 7 prill. Aleatët perëndimorë kanë fajësuar Qeverinë e presidentit sirian, Bashar al-Asad, për këtë sulm. Rusia dhe Siria kanë mohuar se Damasku qëndron prapa sulmit.

Ukraina dhe Bjellorusia përkujtojnë viktimat e Çernobilit

Ukraina po shënon 32-vjetorin e katastrofës bërthamore në Çernobil, duke organizuar shërbim përkujtimor dhe një sërë ngjarjesh në kujtim të viktimave. Ndërkaq, në shtetin fqinj, në Bjellorusi po ashtu po mbahen ngjarje për të përkujtuar viktimat e kësaj ngjarjeje. Në Kiev, qindra qytetarë kanë marshuar në mesnatë drejt memorialit për Çernobilin ku kanë vendosur kurora lulesh dhe kanë nderur qirin. Presidenti ukrainas, Petro Poroshenko, ka shkruar sot në Facebook se Çernoboli “gjithmonë do të mbetet plagë e hapur për ne”.



“Sot, ne duhet të bëjmë gjithçka që të parandalojmë përsëritjen e një tragjedie të tillë... zona e Çernobilit tani duhet të bëhet vend i teknologjisë së re, territor i ndryshimit”, ka shkruar Poroshenko.

Turqia dënon me burg edhe 13 gazetarë

Një gjykatë turke dënoi 13 gazetarë me burg, nën akuzat për terrorizëm Ata kanë qenë punonjës të gazetës opozitare Cumhuriyet dhe janë arrestuar pas përpjekjes për grushtshtet në Turqi, në korrik të vitit 2016. Tre gazetarë në gjyq janë liruar. Autoritetet turke kanë akuzuar stafin e Cumhuriyet-it për mbështetje të grupeve që i kanë shpallur terroriste dhe të klerikut fetar, Fethullah Gulen, të cilin Ankara e fajëson për organizimin e grushtshtetit të dështuar. Gulen, i cili e mohon përfshirjen, jeton në mërgim në SHBA dhe autoritetet atje kanë refuzuar ta ekstradojnë në Turqi. Mbi 50,000 njerëz janë arrestuar dhe 150,000 të tjerë janë pezulluar ose pushuar nga puna, pas puçit të dështuar. Trembëdhjetë gazetarë e dënuar përfshijnë disa nga



emrat më të shquar turq, si kryedaktori Murat Sabuncu, karikaturistin Musa Kart dhe kolumnistin Kadri Gursel, përcjell rel E themeluar në vitin 1924, gazeta Cumhu-

riyet ka ruajtur pavarësinë në një mjedis të kontrolluar mediatik, duke shkaktuar zemërim te presidenti turk, Recep Tayyip Erdogan. Pas vendimit të gjykatës për gaze-

tarët, gazeta ka shkruar në uebfaqen e saj: “Do të jeni të turpëruar para historisë”. Në muajin mars, 25 gazetarë turq janë burgosur për lidhje të dyshuara me Gulenin.

KONKURS

për ndarje të shpërblimit shtetëror "11 Oktomvri" në vitin 2018

Me shpërblimin shtetëror "11 Oktomvri" jepet mirënjohje më e lartë për vepër jetësor në fushën e shkencës, artit, ekonomisë dhe veprimtarive të tjera me interes publik në Republikën e Maqedonisë.

Shpërblimi shtetëror "11 Oktomvri" sipas rregullit, ndahet çdo vit.

Shpërblimi shtetëror u ndahet individëve, grup krijuesish, ekipeve, institucioneve, shoqatave dhe shoqërive tregtare të qytetarëve të vendit.

Shpërblimi shtetëror sipas kushteve të përcaktuara në konkurs mund t'u ndahet edhe shtetasve të huaj, grup krijuesish, ekipe dhe institucione nga jashtë me interes publik të Republikës së Maqedonisë.

Individit të shpërblyer i ndahet: diplomë, pllaketë dhe shumë të hollash.

Secilit anëtar të grupit ose ekipit të shpërblyer të krijuesve u ndahen diploma pllaketë dhe pjesë të barabarta të shumës së parave.

Institucionit, shoqërisë ose shoqatës tregtare të qytetarëve të shpërblyera u ndahen diplomë dhe pllaketë.

Shuma e të hollave të shpërblimit shtetëror "11 Oktomvri" arrin pesëmbëdhjetë (15) rroga mujore mesatare në Republikën e Maqedonisë të paguara tre muajt e fundit të vitit aktual.

Në një vit mund të ndahen më së shumti deri në pesë (5) shpërblime.

Iniciativë për ndarjen e shpërblimit shtetëror "11 Oktomvri" mund të parashtrijë: institucionet, shoqatat tregtare, shoqëritë qytetare dhe qytetarët.

Parashtruesit e iniciativës për ndarjen e shpërblimit shtetëror duhet në detaje të arsyetojnë iniciativën. Në tekst duhet të jenë të përmbajtura edhe: të dhëna të sakta biografike për personin dhe të dhëna për institucionin, shoqatat tregtare, ose shoqëritë qytetare, adresë të saktë banimi: (rruga, numri, vendi, qyteti, shteti), të dhëna për rezultatet e arritura në fushën në të cilën është arritur e realizuara dhe të dhëna të tjera të cilat llogariten se do të kontribuojnë në vlerësim.

Parashtruesi i iniciativës duhet të vendosë emrin dhe mbiemrin e plotë, titullin, firmën, adresën dhe numrin e telefonit.

Teksti i iniciativës (i kompletuar) të dorëzohet në 20 kopje, ndërsa punimet, librat, publikimet etj, trajtohen si shtojca dhe duhet të dorëzohen në një kopje.

Iniciativat duhet të dorëzohen në adresën në vijim:

Ministria e kulturës e Republikës së Maqedonisë – Këshilli për ndarje të shpërblimit shtetëror "11 Oktomvri", rr. 'Gjuro Gjakoviq' nr. 61 – Shkup, Republika e Maqedonisë.

Konkursi zgjatë prej 1.05 deri më 31.05 2018.

Iniciativat e pakompletuara dhe iniciativat dhe propozimet (punimet, librat, publikimet etj) të dorëzuara pas afatit të përcaktuar për praninë në konkurs nuk do të merren parasysh.

Këshilli për ndarje të shpërblimit "11 Oktomvri"

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune, Vendimit për nevojën për punëtorë nr. 05-536/1 të datës 23.04.2018, nenit 23 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik dhe nenit 34 të Statutit të NP Komunalec, Kavadar ndërsa në pajtim me Rregulloren për organizim dhe sistematizim të vendeve të punës, UD Drejtori i ndërmarrjes, publikon

SHPALLJE

Për praninë të punëtorëve

I. NP Komunalec – Kavadar ka nevojë për praninë të punëtorëve për kohë të caktuar prej 6 (gjashtë) muajve edhe atë për vendet e punës në vijim:

1. "Udhëheqës i punëve" në departamentin për ujësjellës të rrjetit dhe kyçeve, Sektori Ujësjellësi dhe kanalizimi, 1 (një) realizues, shifra e vendit të punës KDR 0305B02108, me neto pagesë fillestare prej 17.000,00 denarë,
2. "Pastrues" në departamentin për higjienë shërbyese publike, Sektori Higjiena Komunale, 3 (tre) realizues, shifra e vendit të punës KDR 0305V02 013, me neto pagesë fillestare prej 13.500,00 denarë.
3. "Punëtor për bartjen e bërllokut" në departamentin për mënjanimin e bërllokut Sektori për Higjienë Komunale në departamentin për mënjanimin e bërllokut Sektori për Higjienë Komunale 1 (një) realizues, shifra e vendit të punës KDR 0305 V02 011, me neto pagesë fillestare prej 13.500,00 denarë,
4. "Vozitës" në departamentin për mirëmbajtje të mekanizmit dhe makinave Sektori për Higjienë Komunale, 1 (një) realizues, shifra e vendit të punës KDR 04 03 A02 004, me neto pagesë fillestare prej 15.200,00 denarë,
5. "Drejtes me makinë bujqësore" në departamentin për mirëmbajtje të mekanizmit dhe makinave Sektori për Higjienë Komunale 1 (një) realizues, shifra e vendit të punës KDR 03 05 V01 002, me neto pagesë fillestare prej 15.000,00 denarë,
6. "Instalues të ujit KUL" në departamentin për rrjetin e qytetit dhe fshatit të ujësjellësit, Sektori Ujësjellësi dhe kanalizimi, shifra e vendit të punës KDR 03 05 B04 053, me neto pagesë fillestare prej 15.600,00 denarë,
7. "Instalues të ujit" në departamentin për rrjetin e qytetit dhe fshatit të ujësjellësit, Sektori Ujësjellësi dhe kanalizimi, shifra e vendit të punës KDR 03 05 V01 004, me neto pagesë fillestare prej 15.000,00 denarë,
8. Punëtor "Murator" në departamentin për varreza (menaxhim me varreza) Sektori për shëbime të përbashkëta 1 (një) realizues, shifra e vendit të punës KDR 04 05 V01 011, me neto pagesë fillestare prej 15.000,00 denarë,

Të gjithë kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj, duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:

Për vendin e punës nga pika 1, 4 dhe 6 është e nevojshme që kandidati të ketë shkallën III dhe IV të arsimit (arsim i mesëm).

Për vendin e punës nga pika 2, 3, 5, 7 dhe 8 është e nevojshme kandidatët të kenë PKU, shkalla I e arsimit (arsim fillor)

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune, duke konsideruar nga dita e publikimit të shpalljes në tabelën për shpallje të ndërmarrjes dhe në shtypin ditor në tri gazeta ditore prej të cilave një në gazetën që publikohet në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve që e flasin gjuhën zyrtare ndryshe nga gjuha maqedonase.

Zgjedhja do të realizohet në pajtim me nenin 23 paragrafi 2 i Ligjit për marrëdhënie pune gjegjësisht nëse në shpalljen publike janë paraqitur deri në 200 kandidatë për një vend pune zgjedhja e kandidatëve bëhet në afat prej 45 ditë, prej 201 deri në 500 kandidatë për një vend pune bëhet në afat prej 90 ditë dhe mbi 500 kandidatë për një vend pune bëhet në afat prej 120 ditë, pas kalimit të afatit për paraqitje.

Kandidatët fletëparaqitjet me të gjitha dokumentet duhet t'i parashtrijë në adresën:

NP Komunalec Kavadar, rr. "Industrikska" pn, Kavadar, personalisht në arkiv ose përmes postës.

Fletëparaqitjet e dorëzuara pas afatit dhe të paplotësuara nuk do të merren parasysh.

NP Komunalec Kavadar
UD Drejtor
Gjorgji Pop Ičov



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimin të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrimit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 39/2018

për punësimin e 1 nëpunës shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Ministrinë e Drejtësisë” për vendet e punës në vijim:

1. UPR0101B03000 Ndhimës udhëheqës i sektorit për jurisprudencë 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkencë juridike
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat
- të dhënë provimin e jurisprudencës

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arrihtë të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të foltura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përkrahimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30

Rroga neto: 31.331,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afatit i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë. Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësimit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – rë: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai inicohet dhe emetohet drejtpërdrejt në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – rë: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.



KOMUN E KARPOSHIT
SEKTORI PËR VEPRIMTARI ME INTERES PUBLIK
Departamenti për arsim



Në bazë të nenit 22, paragrafi 1 pika 8, nenit 36 paragrafi 1, pika 1 dhe nenit 62 e Ligjit për vetëqeverisje lokale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 5/2002), ndërsa në lidhje me Programin për aktivitetet e Komunës së Karposhit nga sfera e arsimit për vitin 2018 (Fleta zyrtare e Komunës së Karposhit nr. 18./2017, 04/2018), ndërsa në lidhje me Vendimit për dhënie të pëlqimit për publikim të shpalljes për ndarje të mbështetjes financiare të projekteve nga sfera e arsimit për subjektet fizike dhe juridike për vitin 2018 nr. 09-3199/16 e datës 23.04.2018 („Fleta zyrtare e Komunës së Karposhit” nr. 4/2018), Komuna e Karposhit publikon

SHPALLJE Për mbështetje financiare të projekteve nga sfera e arsimit për subjektet fizike dhe juridike për vitin 2018

I. Të drejtë për paraqitje

Në shpalljen publike mund të paraqiten të gjitha subjektet fizike banorë të Komunës së Karposhit dhe subjektet juridike të regjistruara për veprimtari që përfshijnë veprimtarinë e arsimit në të gjitha sferat, ndërsa të cilët me programet dhe aktivitetet e tyre kontribuojnë në zhvillimin e arsimit në komunë dhe më gjerë.

Subjektet fizike dhe juridike obligohen në kërkesë të theksojnë shkaqet, arsyet, rezultatet e pritshme dhe qëllimin se për çka i kërkojnë mjetet.

II. Dokumentet e nevojshme dhe kushtet për pjesëmarrje

Subjektet fizike:

1. Letërjohim në kopje,
2. Projekt i përpunuar dhe
3. Plani financiar i projektit.

Subjektet juridike:

1. Projekt i përpunuar,
2. Plani financiar i projektit
3. Gjendja aktuale e dhënë nga Regjistrari qendror i Republikës së Maqedonisë, jo më të vjetër se 6 (gjashtë) muaj.

III. Kriteret për ndarje të mbështetjes financiare

1. Përkrahim i shkurtër i aktiviteteve nga vitet paraprake;
2. Pjesëmarrje të vendit dhe ndërkombëtare dhe organizim të manifestimeve nga sfera e arsimit
3. Sukses të arritura në 3 (tri) vitet e fundit.

IV. Shuma e mbështetjes financiare dhe rangimi

Varësisht nga dokumentet e parashtruara, Komuna e Karposhit shumëmbështetjes financiare do ta ndajë në kuadër të mundësive të saj.

V. Mënyra e paraqitjes

Dokumentet mund të parashtrihen përmes postës në rr. Radika nr. 9 – Shkup ose në Arkivin e Komunës së Karposhit, baraka nr. 2 me shenjë “Mos hap” dhe me shenjë “Për financim të projekteve nga sfera e arsimit për subjektet fizike dhe juridike për vitin 2018”.

VI. Afati për parashtrimin të dokumenteve

Shpallja nuk është e kufizuar në aspekt kohor dhe vlen deri në harrxhimin e mjeteve financiare, por projektet të realizohen më së voni deri më 31.12.2018.

Dokumentet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

KOMUNA E KARPOSHIT



KOMUNA E KARPOSHIT
SEKTORI PËR VEPRIMTARI ME INTERES PUBLIK
DEPARTAMENTI PËR KULTURË DHE SPORT



Në bazë të nenit 22, paragrafi 1 pika 5 e Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 5/2002), në bazë të programit të Komunës së Karposhit, në sferën e kulturës, pjesa 2. Aktivitetet programore, pika 3. Mbështetje e projekteve nga sfera e kulturës (Fleta zyrtare e Komunës së Karposhit nr. 18./2017 dhe nr. 4/2018), ndërsa në lidhje me Vendimin për ndryshim dhe plotësim të Vendimit për publikim të shpalljes për ndarje të mbështetjes financiare të projekteve nga sfera e kulturës për subjektet fizike dhe juridike nga sfera e Komunës së Karposhit për vitin 2018 nr. 09-3199/23 ("Fleta zyrtare e Komunës së Karposhit" nr. 4/2018) publikohet

SHPALLJE

Për ndarje të mbështetjes financiare të projekteve nga sfera e kulturës për subjektet fizike dhe juridike nga rajoni i Komunës së Karposhit për vitin 2018

I. Të drejtë për paraqitje

Të drejtë për paraqitje kanë të gjitha subjektet fizike banorë të Komunës së Karposhit dhe subjektet juridike të regjistruara në Komunën e Karposhit për veprimtari që përfshijnë veprimtarinë e kulturës në të gjitha sferat së paku 3 (tre) vjet, ndërsa të cilët me programet dhe aktivitetet e tyre kontribuojnë në zhvillimin e kulturës në komunë dhe më gjërë.

Konkursi për projekte nga sferat: veprimtari botuese, folklor, veprimtari muzikore-skenike dhe veprimtari të ekspozitave të artit figurativ.

Subjektet fizike dhe juridike obligohen në kërkesë të theksojnë shkaqet, arsyet, rezultatet e prishme dhe qëllimin se për çka i kërkojnë njetet.

II. Dokumentet e nevojshme dhe kushtet për pjesëmarrje

Subjektet fizike:

1. Letërnjoftim në kopje,
2. Projekt i përpunuar dhe
3. Plani financiar i projektit.

Subjektet juridike:

1. Projekti i përpunuar,
2. Plani financiar i projektit
3. Gjendja aktuale e dhënë nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë, jo më të vjetër se 6 (gjashtë) muaj.

III. Kriteret për ndarje të mbështetjes financiare të klubeve të sportit

1. Përkushtim organizativ;
2. Pjesëmarrje të vendit dhe ndërkombëtare dhe organizim të manifestimeve kulturore
3. Sukses të arritura në 3 (tri) vitet e fundit.

IV. Shuma e mbështetjes financiare dhe rangimi

Varësisht nga dokumentet e parashtruara, Komuna e Karposhit shumën e mbështetjes financiare do ta ndajë në kuadër të mundësive të saj.

V. Mënyra e paraqitjes

Dokumentet mund të parashtrihen përmes postës në rr. Radika nr. 9 – Shkup ose në Arkivin e Komunës së Karposhit, baraka nr. 2 me shenjë "Mos hap" dhe me shenjë "Për mbështetje financiare të projekteve nga sfera e kulturës për subjektet fizike dhe juridike nga rajoni i Komunës së Karposhit për vitin 2018".

VI. Afati për parashtrimin të dokumenteve

Shpallja nuk është e kufizuar në aspekt kohor dhe vlen deri në harxhimin e mjeteve financiare, por projektet të realizohen më së voni deri më 31.12.2018.

Dokumentet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

KOMUNA E KARPOSHIT



SHFK "Hristijan Karposh"
f. Nagoričan i Ri – Komuna Nagoričan i Vjetër
tel: + 389 (0) 31 497 323 faks 031 497 323
www.hristijankarpos.mk e-mail: htkarpos_mln@yahoo.com.



Në bazë të Vendimit për publikim të shpalljes për kohë të caktuar të punës deri më 31.08.2018 me nr. 04-166/1 të datës 26.04.2018, nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (teksti i pastruar) (Gazeta Zyrtare nr. 167/2015) dhe nenit 77, 79, 80 dhe 82 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare të RM nr. 103/2008; 33/10; 116/10; 156/10; 18/11; 42/11; 51/11; 6/12; 100/12; 24/13; 41/14; 116/14; 135/14; 10/2015; 98/2015; 145/2015; 30/2016 dhe 127/16), drejtori i SHFK "Hristian Karposh" f. Nagoričan i Ri, Komuna Nagoričan i Vjetër më datë 26.04.2018 publikon

SHPALLJE

Për punësim të kuadrit mësimor për kohë të caktuar të punës deri më 31.08.2018

1. 1 (një) mësimdhënës të gjuhës maqedonase me 16 (gjashtëmbëdhjetë) orë mësimore në javë dhe me neto pagesë fillestare prej 16.512 denarë.
2. 1 (një) mësimdhënës të informatikës, me 21 (njëzetën) orë mësimore në javë dhe me neto pagesë fillestare prej 20.640 denarë.
3. 1 (një) mësimdhënës të informatikës me 6 (gjashtë) orë mësimore në javë dhe me neto pagesë fillestare prej 6.192 denarë.
4. 1 (një) mësimdhënës të artit figurativ me 4 (katër) orë mësimore në javë dhe me neto pagesë fillestare prej 4.128 denarë.
5. 1 (një) mësimdhënës të mësimin klasor me orar të plotë të punës 20 (njëzet) orë mësimore në javë dhe me neto pagesë fillestare prej 20.640 denarë.
6. 1 (një) mësimdhënës të gjuhës angleze me orar të punës 21 (njëzetën) orë mësimore dhe me neto pagesë fillestare prej 20.640 denarë.
7. 1 (një) mësimdhënës të mësimin klasor (zëvendësim për drejtorin) me orar të plotë të punës 20 (njëzet) orë mësimore në javë dhe me neto pagesë fillestare prej 20.640 denarë
8. 1 (një) bibliotekist, me orar javor të punës 40 orë pune dhe neto pagesë fillestare prej 20.640 denarë.
9. 1 (një) mësimdhënës të historisë me 8 (tetë) orë mësimore dhe me neto pagesë fillestare prej 8.256 denarë.
10. 1 (një) defektolog me 40 (dyzet) orë të punës dhe neto pagesë fillestare prej 20.640 den.
11. 1 (një) mësimdhënës të arsimin qytetar me orar javor të punës prej 2 (dy) orë mësimore dhe me neto pagesë fillestare prej 2.064 denarë.
12. 1 (një) mësimdhënës të edukatës muzikore me 8 (tetë) orë mësimore dhe me neto pagesë fillestare prej 8.256 denarë.
13. 1 (një) mësimdhënës të korit të shkollës me 3 (tre) orë mësimore dhe me neto pagesë fillestare prej 3.096 denarë.
14. 1 (një) mësimdhënës të orkestrës së shkollës me 3 (tre) orë mësimore dhe me neto pagesë fillestare prej 3.096 denarë.
15. 1 (një) mësimdhënës të lëndës zgjedhore atdheu ynë me 4 (katër) orë mësimore dhe me neto pagesë fillestare prej 4.128 denarë.
16. 1 (një) mësimdhënës të lëndës zgjedhore të hulumtojmë vendlindjen tonë me 2 (dy) orë mësimore dhe me neto pagesë fillestare prej 2.032 denarë.
17. 1 (një) mësimdhënës të inovacioneve me 1 (një) orë mësimore dhe me neto pagesë fillestare prej 1.032 denarë.

Orari i punës për të gjitha vendet e publikuara të punës është prej ditës së hënë deri ditën e premte ndërrimi i parë prej ora 07:00 deri në ora 13:00.

Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me LMP, kandidatët duhet të përbushin edhe kushtet e posaçme në pajtim me nenin 80 të Ligjit për arsim fillor dhe të kenë të mbaruar arsimin përkatës në pajtim me nenin 77 dhe 79 të Ligjit për arsim fillor dhe Normativin për kuadër mësimor dhe profilin e kuadrit mësimor të paraparë me programet. Kandidatët duhet të parashtrorin lutje, diplomë për arsimin sipëror të mbaruar përkatës, certifikatë të shtetësisë (kopje të dokumenteve të vërtetuara në noter).

Lutjet të parashtrihen deri në objektet e shkollës ose përmes postës në adresën: SHFK "Hristian Karposh" f. Nagoričan i Ri, Komuna Nagoričan i Vjetër.

Dokumentet e pakompletuara dhe të parashtruara pas afatit nuk do të merren parasysh.

Shpallja është e hapur 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit në dy gazeta ditore, ndërsa zgjedhja do të realizohet brenda afatit të paraparë me ligj.

26.04.2018
Nagoričan i Ri

Drejtor
Marija Dodevska

Në bazë të nenit 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 27/14, 199/14 dhe 27/16), nenit 22, ndërsa në lidhje me nenin 14 paragrafi 1 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 74/15, 167/15 dhe 27/16) dhe nenit 143 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16 dhe 163/17), dhe pëlqimit me shkrim nr. 18-2384/5 të 08.03.2018 për pedagog dhe pëlqimit me shkrim nr. 18-3809/2 për edukator dhe përkëdhelës, të parashtruar nga ministria e financave të RM, si dhe Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në IPKÇF "Detelinka" – Kriva Pallankë nr. 0101-145/2 nga 07.09.2015, Drejtoresha e Institutit publik komunal për fëmijë – Cerdhja për fëmijë "Detelinka" Kriva Pallankë publikon

SHPALLJE PUBLIKE
Për punësim për kohë të pacaktuar

1. Pedagog.....1 (një) realizues

- Të fituar 240 kredi sipas EKTS apo të mbaruar arsim të lartë shkalla VIII/1 Fakulteti filozofik – Arsimin (Pedagogjik)

- Licencë të vlefshme për punëtorë profesional
- Me ose pa përvojë pune
- Orari i ditor I punës: 8 orë (prej orës 8:00- 16:00)
- Orari javor I punës: 40 orë (prej të hënës deri të premten)
- Neto paga themelore: 20.056,00 den.

2. Edukator..... 1 (një) realizues

- Të fituar 240 kredi sipas EKTS apo të mbaruar arsim të lartë shkalla VIII/1
- Me ose pa përvojë pune
- Licencë valide për edukator
- Orari i punës prej ora 07:00 deri në ora 13:00
- Orari javor I punës: 40 orë (prej të hënës deri të premten)
- Neto paga themelore: 19.581,00 den

3. Përkëdhelës..... 1 (një) realizues

- Arsim të mesëm të mbaruar katërvjeçar
- Me ose pa përvojë pune
- Licencë valide për përkëdhelës
- Orari i ditor I punës: 8 orë (prej orës 8:30 – 16:30)
- Orari javor I punës: 40 orë (prej të hënës deri të premten)
- Neto paga themelore: 14.780,00 den

Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për marrëdhënie pune kandidatët duhet të përbushin edhe kushtet e përcaktuara me nenin dhe 142 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve (Gazeta Zyrtare e RM nr. 23/2013, 12/2014, 44/2014, 144/2014, 10/2015, 25/2015 dhe 150/2015, 27/2016, 163/17)

Krahas fletëparaqitjes kandidatët me numër rendor 1 (pedagog), nr. 2 (edukator) dhe nr. 3 (përkëdhelës) duhet të parashtrorin dokumentet në vijim:

Dokumentet e nevojshme për paraqitje:

Fletëparaqitje për punësim certifikatë të lindjes
Certifikatë se është shtetas i Republikës së Maqedonisë
Vërtetim mjekësor se personi është psikofizikisht i shëndoshë
Vërtetim që nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës vërtetim që nuk i shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilin dënohet për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese
Diplomë për arsim të mbaruar përkatës në origjinal ose kopje të vërtetuara, të përbushë edhe kushtet të tjera të përcaktuara në aktin për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës.

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrihen në zarf të mbyllur pa ndonjë shenjë në Drejtorinë e IPKÇF "Detelinka" Kriva Pallankë, ose përmes postës në adresën në vijim në rr. "Sv. Joakim Osogovski" nr. 51 1330 Kriva Pallankë me shenjë të vetme

"Për shpallje publike për punësim për kohë të pacaktuar"

Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve është **5 ditë pune** nga dita e publikimit në shtypin ditor, duke mos konsideruar ditën e publikimit në shtypin ditor. Zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas kalimit të afatit për paraqitje. Dokumentet jo të plota, të pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh.

IPKÇF "DETELINKA"
Kriva Pallankë

FESTIVALI MBARËKOMBËTAR I KËNGËS PËR FËMIJË

"YLBERI" - 2018, SHPALL KONKURS

Për pjesëmarrje në festivalin mbarëkombëtar "Ylberi" - 2018

Kushtet e konkursit janë si vijon:

- **Kënga duhet të jetë origjinale dhe me vlera të konsiderueshme artistike.**
- **Kompozimet duhet t'u përshtaten moshës së interpretuesëve.**
- **Tekstet duhet të jenë në frymën e moshës fëmijërore dhe të kenë vlera të mirëfillta edukative - arsimore dhe të tematizuara me tipare nga përditshmëria fëmijërore (dy kopje)**
- **Garuesit (konkuresit), materialet për konkurim duhet ti dorëzojnë në CD, me orkestrim, këndim dhe përcjellje korale, dhe partiture me vijë melodike me simbole harmonike (dy kopje).**
- **Të drejtën e konkurimit e kanë të gjithë autorët të interesuar pa përku-fizime shtetërore ose të çdo lloji tjetër.**

Festivali do të mbahet në muajin tetor 2018 në Shkup, R. Maqedonisë

Konkursi është i hapur nga data 25 prill deri më 25 maj 2018
Të gjithë të interesuarit, materialet duhet t'i dorëzojnë në adresën:
Rr. Xhon Kenedi Nr 9B 2/26 (FEST-YLBERI - 2018)

Tel i kontaktit: +389 70 27 27 88 ose +389 72 21 95 05
e-mail: adem_ymeri@hotmail.com

URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit ginekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221

TJETËR-BOTA E REBELIZMIT NJERËZOR

(Resul Shabani, "Dashuria e Kapitenit", roman. Botoi Onufri, Tiranë, 2017)

Dr. Eris RUSI

- Kemi kohë, pra, si jo, kemi kohë. Sa të duash kemi kohë. Vetëm kohë kemi dhe asgjë tjetër. Asgjë. Ah, gati harrova, edhe pak shpresë.

Po e nis me një citim nga libri, që vërtet i jep një lloj vërtetësie të kurdohershme këtij romani, i botuar për herë të parë në vitin 1983, e që ky është botimi i gjashtë. Dyzet vjet që kanë kaluar nga momenti i përfundimit të këtij teksti, e koha sot vazhdon të jetë me tepri në jetën tonë, një kohë e mbushur me gjëra të vogla, me mangësi që ngjajnë si cikërrima pa vlerë. Por, ndryshe nga dje, sot dhe shpresa ngjan të jetë bjerrë.

Romanin "Dashuria e Kapitenit", e lexova me përkushtim. Ai nis në formën e një dialogu të vazhdueshëm mes dy miqsh: një kapiteni dhe një profesori, të cilët që kanë mbi tridhjetë vjet miqësi me njëri-tjetrin dhe presin çastin të ndahen, e shtynë atë çast, edhe pse kjo duket e pashmangshme. Resul Shabani rrëfen jetën e kapitenit, botën misterioze të këtij personazhi që e bën fatin e tij të trishtuar dhe melankolik, por që nuk dorëzohet lehtë.

Ata që ende nuk e kanë lexuar librin, mund të presin të dalë nga ky tekst një subjekt, ku dashuria siç e dëshirojmë ne, ajo shpirtërore por edhe fizike, të mbizotërojë

përgjatë rrëfimit. Në fakt, para-prakisht, ne mund ta pyesim veten, si lexues dhe si njerëz të kësaj bote: Çfarë është dashuria? Të gjithë kemi një përgjigje tonën individuale për këtë, askush nuk mund të reagojë njëloj përpara një pyetjeje të tillë.

E megjithatë, po të më pyesnin kush është e kundërta e dashurisë, do të përgjigjesha indiferenca.

Sot, ne jetojmë në një kohë kur indiferenca nuk është më habi, nuk është provokim, pasi bota ku jemi ngjan e gjitha indiferente, po njëloj anormale dhe njerëzit janë të izoluar dhe të kufizuar brenda interesave të vogla, personale. Indiferenca ngjan sikur tashmë është rregulli, e jo përjashtimi mes nesh. E gjithë ekzistenca jonë, edhe ne vetë, gjendemi të përfshirë në të.

Dhe kjo është keq. Ne jetojmë në një kohë të shqetësuar, ku ndjehet pasiguri në fillim dhe në mbarim të ditës, ku gjërat shpesh ndodh të bëhen të vështira pa asnjë motiv dhe ku nuk është e thjeshtë t'i shpëtosh tundimit të banales, rënien thellë në baltën e monotones, të zyrtës dhe prozaikes, që i bën jetët tona të zbeh-ta, apatike e deri diku qesharake.

Në komunikimin e përditshëm të gjithë jemi të përndjekur nga indiferenca: botë indiferente, jetë indiferente, rrjedhje indiferente e gjërave, dashuri indiferente, buzëqeshje indiferente, ekzistencë e til-

lë dhe harresë e hidhur në fund. Por në fjalët e krijimit letrar të Resul Shabanit, gjithçka ndryshon dhe asgjë nuk është më indiferente, por e shemb këtë paranojë të madhe të njeriut dhe afrohet me lirinë. Prandaj, dashuria për të cilën flasim, është një kundërpërgjigje e veçantë ndaj indiferencës.

Personazhi i kapitenit është i veçantë dhe mbizotëron në të gjithë dialogët, duke e shpalosur veten ndaj marrëdhënieve që shtjellohen me miqtë dhe botën e tij. Por fati i këtij njeriu, është në udhëkryq, jeta e tij nuk vlen më, nga momenti që po i privohet liria.

Pyes unë: po sot, njerëzit a mund të bëjnë dot kompromis lirinë e tyre me dëshirë? Ka që e bëjnë, ose liria është zhvlerësuar në një farë mbijetese që nuk pyet dhe nuk di ç'është frymëzimi për t'i lëvizur gjërat vetë, për t'iu përvshur punëve, apo edhe për t'u sakrifiku për një ide të vetme, si liria.

- A dashuron kapiteni? Na duket sikur kërkojmë ta dimë që në fillim e në fund të librit. Dashuria brenda tij paraqet një tjetërbotë shpirtërore, ku ngre krye vetmia dhe ankthi, tensionet e kohës dhe ëndrrat e gjymtuara të njeriut bashkëkohor. Me afirmimin e shoqërisë së masave, njerëzit humbën njëra pas tjetres liritë e tyre, ndaj perceptimi i reales u fut në krizë dhe vetëm një lloj i veçantë dashurie, ajo për liri, mund të shërbente



si gjuhë e përkthimit të njerëzve-numra, në individë me shpirta të lirë.

Një jete boheme dhe shumë trishtim, kështu ngjason sikur kërkon të më thotë libri përmes leximit të kapitenit. Edhe këtu kemi të pranishëm një lloj të veçantë kohe dhe hapësire të zgjedhur nga autori për të ambientuar historinë e tij. Struga është qyteti ku zhvillohen ngjarjet, jemi në periudhën e Luftës së Dytë Botërore dhe pushtimi nazist strukturohet në gjithë egërsinë e tij mes njerëzve dhe ndijimeve të tyre. Por çdo diktaturë e tillë është, një e keqe e madhe, një makineri që përkul jo vetëm kurrizin, por sa keq, shpirtin e njerëzve. Sikur të bëjmë një paralelizëm dje dhe sot, mund të themi që nëse dje njerëzit kishin frikë të flisnin, sot mendohen mirë para se ta bëjnë këtë, ose kur flasin, e dinë që nuk do t'i dëgjojë njeri.

Absurde, në të dyja rastet situata, dhe mendoj që vetëm letërsia mund të përfaqëtojë një zgjidhje për situatën. Kjo është një letërsi e mirë dhe që i mbijeton subjektit të saj.

Kështu dhe kapiteni vepron, megjithëse nën egërsinë e pushtetit totalitar, e drejta zhbëhet dhe denaturohet, shitet si diçka e tjetërsuar, që manipulon njerëzit dhe jep variantin e ndryshëm të

saj. Vrasja e Majorit nazist e organizuar nga kapiteni, është shenja e qartë e rebelimit ndaj së padrejtës. E kjo jepet me një teknikë shkrimi të kthjellët, të kuptueshëm, asnjëherë të komplikuar. I tillë është ky libër, dhe me vdekjen, vrasjen e kapitenit, ne e kuptojmë që njeriu e ka në dorë të zgjedhë fatin e tij tragjik, në shërbim të asaj çka është dashuri për lirinë, për të drejtën dhe të duhurën. Ndaj ky libër ngjason si një rrugë ku edhe sot mund të ecim dhe të përballemi me ide që mund të ndryshojnë bindjet tona, sjelljen tonë, indiferencën tonë, mund të gjejmë mallin për kohën e shkuar dëm, për kujtimet e lëna pas, dhe dashuri mund të gjemë. Shumë Dashuri. Pasi kapiteni i thotë lexuesit që me të ndan diçka të përbashkët, zemrën e tij. Atë që na ngroh të gjithëve, e na bën të ndjehemi të jashtëzakonshëm, qoftë edhe për fare pak, sepse kapiteni i këtij libri është i veshur me dritë, edhe kur gjithandë muzgu duket të zbrësë, i pashpresë, kërcënues, i pakuptimtë.

(Eris Rusi (1983) është doktor i shkencave filologjike. Pedagog në Universitetin "Fan Noli" të Korçës. Është autor i gjashtë librave me tregime dhe dy romaneve. Ka mbaruar studimet në Universitetin "La Sapienza të Romës")

ZBULOHEM DOKUMENTET E PANJOHURA TË FISHTËS

Këto arkiva sipas studiueses "plotësojnë atë pjesë të profilit krijues të Fishtës trajtuar pak ose sipërfaqshëm prej kritikës, por (sidomos) japin mundësinë e leximit sipas këndit të privilegjuar të fakteve, të disa aspekteve të aktivitetit letrar të Fishtës, vështruar sipas erërave politike të çastit

zia e parë e Fishtës, "Al valente poeta sig. Silvie Strahimir Kranjčević, dedikuar poetit të madh lirik kroat, që Suta e ka zbuluar në Muzeun e Sarajevës, të shkruar në vitin 1892 hedh poshtë tezën e Vehbi Balës që cilëson të parën poezi "E popullit", botuar në "Albania" të Konicës.

Edhe dëftesa me nota flet shumë... Vetëm nëpërmjet një dëftese ne zbulojmë lehtësisht sesa e ndriçuar ka qenë mendja e Fishtës, por edhe shpirtin e tij rebel. Në shkollat ku edukohet një klerik i ri, ky karakter do t'i kushtonte Fishtës "një mjaftueshëm" në sjellje në mesin e të gjitha vlerësimeve shkëlqyeshëm. Suta, Fishtën dhe

poetin kroat Kranjčević, të cilit i dedikohet poezia, i quan "dy shpirta rebelë në malësinë e Livno-s".

Blerina Suta njihet për kërkimet e pazakonta. Ajo ka bërë disa studime, ku në njërin prej tyre ka zbuluar edhe faqe të panjohura nga vepra gati pesëshekullore e Budit. Kërkimet dhe studimet për Fishtën nga Suta nuk bëhen për herë të parë. Para këtyre zbulimeve të reja, zonja Suta ka bërë edhe një studim tjetër kërkimor "Eposi i At Gjergj Fishtës përball eposit të shkrimtarëve romantikë sllavo-jugor".

Libri i ri "Hulumtime mbi veprën e At Gjergj Fishtës" (Onufri

2018), që sapo ka dalë në dritën e botimit nga "Onufri" flet me gjuhën e përpiktë të studiueses, ku një pjesë e dokumenteve janë dëshmi të rralla që plotësojnë profilin e klerikut dhe poetit Kombëtar At Gjergj Fishta.

Suta ka rrëfyer në një intervistë për "Shqiptarja.com" se me pjesën e tjetër të arkivave do të botojë një libër tjetër për Fishtën. Për të zbuluar Fishtën e vërtetë, duket se Suta ka ende punë për të bërë. Materialet i ka gjetur duke kërkuar në burime të panjohura ose pjesërisht të përmendura arkivore në Sarajevë: Guça Gora, Kraljeva, Sutjeska e Livno; Romë: Arkivi Historik i

Urdhrit Françeskan; etj.

Këto arkiva sipas studiueses "plotësojnë atë pjesë të profilit krijues të Fishtës trajtuar pak ose sipërfaqshëm prej kritikës, por (sidomos) japin mundësinë e leximit sipas këndit të privilegjuar të fakteve, të disa aspekteve të aktivitetit letrar të Fishtës, vështruar sipas erërave politike të çastit.", thotë Suta. Për studiuesen e njohur, rrimarrja në dorë e atyre materialeve vjen prej bindjes se ende nuk është bërë sa duhet për të ndriçuar një nga profilet më të qëndrueshme dhe komplekse letrare të Shqipërisë së gjysmës së parë të shekullit XX, transmeton gazeta KOHA.



Pas kërkimeve të jashtëzakonshme në Arkivat e Romës në Bosnje dhe në Kroaci, studiuesja e njohur Blerina Suta ka zbuluar fakte që hedhin dritë në jetën dhe veprën ende të panjohur të At Gjergj Fishtës, shkruan 'Shqiptarja'.

Ajo ka zbuluar poezinë e parë të At Gjergj Fishtës dhe një dëftesë të Universitetit të Livnos që e prezanton poetin dhe klerikun e njohur si student të shkëlqyer. Poe-

NJË LEKSION JETE NGA ATO PËR FILMA NGA KLAUDIO NDOJA

U SHPËTON PLUMBAVE TË 97-ës, DHE BËHET “YLL” BASKETBOLLI



Ndoja shkoi në Itali kur ishte 13-vjeç, kishte lindur atëkohë dashuria për basketbollin por siç rrëfen nuk e imagjinonte se një ditë ky do të ishte profesioni i tij, në Shqipëri shkollat ishin mbyllur, dhe një plumb qorr që plagosi motrën e tij më të vogël, i mbushi mendjen të atit që bashkë me familjen të nisej me skaf drejt Italisë, një vendim aspak i lehtë

Quhet Klaudio Ndoja, është kampion i Italisë në basketboll me Virtus Bolonjën ku është dhe kapiteni i skuadrës. Në Itali ka shkruar një libër, “Vdekja është e sigurt, jeta jo” ka takuar madje dhe Papën, por asnjëherë nuk harron origjinën e tij, Shkodrën ku ka lindur, dhe peripecitë e një jete për film, siç e titullon intervistën me të “Gazzetta Dello Sport” që i dedikon dy faqe shqiptarit që iku në

Itali si klandestin me një gomone mes plumbave të 97-ës. Ndryshe, Ndoja shkoi në Itali kur ishte 13-vjeç, kishte lindur atëkohë dashuria për basketbollin por siç rrëfen nuk e imagjinonte se një ditë ky do të ishte profesioni i tij, në Shqipëri shkollat ishin mbyllur, dhe një plumb qorr që plagosi motrën e tij më të vogël, i mbushi mendjen të atit që bashkë me familjen të nisej me skaf drejt Italisë, një ven-

dim aspak i lehtë. Në Vlorë, familjen e tij e arrestuan dhe u kërkoi para për t’i liruar, më pas skafistët paguan për ta për t’u nisur drejt Italisë në një udhëtim të frikshëm mes trafikantësh, për t’i lënë në brigjet e Barit. Një fillim i vështirë sa më s’ka në Itali, jetë prej klandestinësh deri sa një prift i ofroi adoleshentit Ndoja shansin për të luajtur basketboll me skuadrën e kishës duke e ndihmuar për të nisur procesin e legalizimit të letrave, një faktor tejet i rëndësishëm më pas për karrierën e Ndojës. Te KB Desio skuadra e tij e parë në 2001, fitoi dokumentet italiane, që atëherë suksese, dy ngjitje në Serie A me Brindisin dhe Virtus Bolonjën, tre kupa të Italisë dhe titulli kampion si kapiten. Suksesi nuk ja ka marrë mendjen, në intervistën e tij rrëfen se si qëllimi i tij nuk ka qenë që të bëhet milioner, por t’i sigurojë familjes kushtet elementare, ka vuajtur racizmin dhe ka ditur të triumfojë dhe ndaj tij, falë një jete plot vështirësi është gjithmonë në anën e më të dobëtave, edhe kur bëhet fjalë për idhujt në basketboll, një leksion jete nga ato për filma nga Klaudio Ndoja, një shqiptar që të bën krenar me shembullin e tij.

OSMANI FLET PAS BARAZIMIT NDAJ AKADEMIJA PANDEVIT



Shumë shpejtë filluam të gëzohemi

Shkup, 26 dhjetor - Kampioni i ri i Maqedonisë, KF Shkëndija nuk shkoi më shumë se një barazim 2:2 në ndeshjen përballë Akademia Pandevit, e cila u zhvillua në Strumicë. “Kuqezinjët” edhe pse në pushim shkuan me një epësi prej 0-2, me golat e Zhunior dhe Ibraimit, në pjesën e dytë pranuan dy gola dhe u desh të pajtohen me rezultatin e barabartë. Pas përfundimit të ndeshjes, trajneri i Shkëndijës, Qatip Osmani tha se futbollistët e tij shumë shpejtë të gëzohen dhe kjo u ka kushtuar atyre humbjen e dy pikëve. Ai paralajmëroi se futbollistët e tij nuk do të dorëzohen dhe në çdo ndeshje do të shkojnë për të fituar. “Mendoj se nuk e filluam ndeshjen ashtu siç duhet. Megjithatë prapë i shënuam dy gola, ku mundeshim të japim edhe golin e tretë. Fillimi i pjesës së dytë, mendoj se na kushtoi dy pika që i humbëm. Shumë shpejtë filluam të gëzohemi, sepse edhe rezultati na i lejonte atë, por futbollit është ky, duhet të jemi të gatshëm edhe në këto momente. Shkëndija sigurisht se nuk do të dorëzohet deri në fund, për çdo ndeshje do të shkojë për fitore”, deklaroi Osmani. Ndërkohë, edhe në ndeshjen e javës së 31 Shkëndija do të jetë mysafir, ku në Prilep do të përballlet me Pobodën.

Zekaj mohon se lë Serbinë për Kosovën

Jam shokuar kur lexova në gazeta “deklaratat” e mia për ndërrim të fanellës. Askush nuk më ka ftuar të luaj për përfaqësuesen e Kosovës dhe as që kam komentuar për ndonjë medium rreth kësaj çështjeje, e citon Arton Zekajn (18) gazeta e Beogradit, “V.Novosti”, transmeton KOHA. Sipas kësaj gazete, tregimi për këtë futbollist të Sopotit (Serbi) këtu përfundon sa i përket kalimit të tij të mundshëm në përfaqësuesen e Kosovës. “Kam pasur vetëm një ftesë nga ana e mediave dhe me atë rast kam folur për luftën e Sopotit për mbijetesë.

Askund nuk është përmendur asgjë që lidhet me atë temë, e pastaj shkoj në stërvitje dhe lexoj disa gjëra që nuk kanë asnjë lidhje me të vërtetën,—sqaron ku djaloshi i cili ka kaluar shkollën complete të Partizanit (të Beogradit) dhe që u ka prirë “orliqve” (nofka për përfaqësuesen e Serbisë në futboll) në kategorinë e të rinjve me shiritin e kapitenit në dorë, shkruan “Novosti”. Rreth kësaj teme për mediat e atjeshme ka folur kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Fadil Vokrri, ndërsa Zekaj zbulon se me të nuk ka pasur kurrfarë kontakti. “Nuk

kam marrë kurrfarë ftese dhe as që kam menduar ndonjëherë rreth kësaj çështjeje. Më besoni e kam kokën plot, s’pushojnë thirrjet telefonike, nuk e di çfarë të them më për diçka që nuk ka kurrfarë baze për polemika e sqarime”, citon kjo gazetë Zekajn. Më së shumti i ka penguar Zekajt në tekstin ku përmendet mundësia e të luajturit për përzgjedhësen e Kosovës (kjo gazetë, sikundër edhe politika zyrtare e Beogradit, jo vetëm kur e përmend shtetin, por edhe emrin gjeografik Kosovë e shoqëron me shprehjen përbuzëse “e ashtuquaj-



tura”, plotësim yni) është ultimatium i veçantë për Federatën tonë (të Serbisë). “Thuhet se do të luaja për Kosovën në rast se nuk përfshihem në planin e përfaqësueses A të Serbisë. Kjo është skajshmërisht jo korrekte, kush jam unë të shantazhoja ndokënd”, e citon gazeta Zekajn.



LA LIGA NË INSTAGRAM NDERON ENIS BARDHIN I pandalshëm

Shkup, 26 prill - Enis Bardhi të hënën shënoi dy gola nga gjuajtja e lirë në fitoren prej 1-3 në cilësinë e mysafirit ndaj Atletico Bilbaos, dhe me tre pikët e fituara, i mundësoi skuadrës së tij që t’ia sigurojë mbijetesën në Primera Divizion. Tani Levante ka nëntë pikë më shumë se La Korunja, e cila tani në katër xhiro para fundit, është gjithnjë e më afër rënies në Sekunda Divizion. Në 12-të ndeshje në

kampionatin spanjoll, futbollisti shqiptar, shënoi katër gola nga ndërprerja, që e bën më efikas edhe nga ylli i Barcelonës Lionel Mesi dhe ai i Realit të Madridit, Cristiano Ronaldo. Ndërkaq, profili në “Instagram” i La Liga u përkujdes që ti respektojë Bardhin dhe të shpërndajë një video nga kamera në të cilën gjendej goli i skuadrës baske, duke e emëruar futbollistin shkujpan si I PANDALSHËM.


**REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMUNA E STRUGËS**

/ SHESHI "NËNË TEREZA" P.N., 6330 STRUGË
/Tel. +389 46 781 335, 781 223, 782 015, /Faks 781 434
web: struga.gov.mk, e-mail: kryetari@struga.gov.mk, info@struga.gov.mk

Nr. 10-917/5
26.04.2018
STRUGË

Në bazë të nenit 51 dhe nenit 35 të Ligjit për planifikim hapësior dhe urbanistik /"Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16), dhe nenit 22 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për vetëqeverisje lokale /"Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 5/02 „Kryetari i komunës së Strugës , e lëshon këtë:

L A J M È R I M

Për organizimin e Prezantimit publik dhe Anketës publike për Projekt arkitettoniko urbanistik për ndryshim të kufirit të dy parcelave ndërtimore fqinje PN 17.29 dhe PN 17.28 me klasë themelore të qëllimit A1-banim në objekt individual në PDU për NJU 5 blloku 17 KK Strugë, Komuna e Strugës.

Lëndë e Projekt arkitettoniko-urbanistik për ndryshim të kufirit të dy parcelave ndërtimore fqinje PN 17.29 dhe PN 17.28 me klasë themelore të qëllimit A1-banim në objekt individual në PDU për NJU 5 blloku 17 KK Strugë, Komuna e Strugës, është ndryshimi i kufirit të parcelave ndërtimore PN.17.29 dhe PN.17.28 në NJU 5 blloku 17 KK Strugë me sipërfaqe prej 0,0698 ha (698 m²)

Përfshirja projektuese e parcelave ndërtimore PN 17.29 dhe 17.28 për të cilën përpunohet ky projekt Arkitettoniko-Urbanistik, kufizohet me parcelat kadastrale në vijim :

- Nga ana jugore me PK.nr.956/15, PK 956/18, PK 956/24, PK 956/13 dhe PK 956/14.
- Nga ana perëndimore me PK 956/13, PK 935/1 dhe një pjesë të PK 956/2
- Nga ana veriore me rrugën qasëse „1,„
- Nga ana lindore me PK 2752/2

Plani I përfshirë për parcelën ndërtimore PN 17.29 dhe 17.28 për të cilën po ndërtohet ky projekt Arkitettoniko-Urbanistik , kufizohet me nga parcelat kadastrale në vijim :

- Pjesë nga PK. 956/4
- Pjesën nga PK. 956/2

Parcelat kadastrale janë në KK Strugë, Strugë.

Anketa publike dhe prezantimi publik për Projektin arkitettoniko-urbanistik për ndryshim të kufirit të dy parcelave ndërtimore fqinje PN 17.29 dhe PN 17.28 me klasë themelore të qëllimit A1-banim në objekt individual në PDU për NJU 5 blloku 17 KK Strugë, Komuna e Strugës,do të realizohet me paraqitje të Projektit arkitettoniko-urbanistik në hapësirat e Komunës së Strugës. Projekti arkitettoniko-urbanistik është i disponueshëm në sistemin informativ e-urbanizëm.

Anketa publike do të zgjasë 5 ditë pune dhe atë nga data 02.05.2018 deri më 08.05.2018.

Lajmërimi për organizim të anketës publike është publikuar me gazetën publike dhe në sistemin informativ e-urbanizëm.

Prezantimi publik me prezantim profesional të planit do të mbahet në datë 08.05.2018 në ora 12:30 në hapësirat e Komunës së Strugës.

Në afatën e përmendur, personat e interesuar fizik dhe juridik nga territorit i përfshirë me projektin arkitettoniko urbanistik mund të dorëzojnë vërejtje, propozime dhe mendime në fletat anketuese në formë elektronike përmes sistemit informativ e-urbanizëm ose në formë të shkruar.

KOMUNA E STRUGËS
Kryetar i komunës,
Dr. Ramis Merko

Përpiloi:
Petrit Bajramoski

Lejoi:
Ark. I dipl. Natmir Nexhipi

SHPALLJE

Për parashkrimin e ofertave për ekskursion

1. FURNIZUES

SHFK "Toli Zordumis" nga Kumanova rr. "Boro Prcan" nr. 38 1300 Kumanovë tel 031 /412 311, faks 031 / 412 311 e-mail tolikumanovo@gmail.com

Personi për kontakt Millorad Jordanovski tel: 075/468-728

Informacione plotësuese, Programi për ekskursion dhe Formulari i ofertës mund të merren personalisht prej ora 08.00 deri në ora 15.00 në adresën e lartpërmendur

2. OFERTUESIT

Kushtet minimale që duhet të përmbushë ofertuesi janë:

1. Të jetë i regjistruar në pajtim me aktet pozitive në RM për kryerje të veprimtarisë përkatëse turistike;
2. Të ketë të realizuar me sukses së paku 3 ekskursione për nxënësit në 3 vitet e fundit
3. Të përmbushë kushtet për transport të grupeve të fëmijëve në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike të makinave me të cilat udhëtojnë grupet e fëmijëve;
4. Në ditën e nënshkrimit të marrëveshjes ofertuesi i zgjedhur parashtron garanci bankare për realizim kualitativ të ekskursionit në shumë prej 10% të vlerës së përgjithshme të marrëveshjes.

Oferta e cila nuk përmbushë kushtet minimale do të refuzohet nga ana e Komisionit si e papranueshme.

3. DOKUMENTET TË CILAT DUHET T'I PARASHTRONË OFERTUESI

-Dokument për veprimtari të regjistruar si dëshmi se është i regjistruar si subjekt juridik për kryerje të veprimtarisë turistike, në pajtim me dispozitat pozitive në RM,

-Marrëveshje – listë referente të ofertuesit se në 3 vitet e fundit ka realizuar në mënyrë të suksesshme së paku 3 ekskursione për nxënësit,

-Dokument për transport të grupeve të fëmijëve, në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike me të cilat udhëtojnë grupet e fëmijëve,

-Dokumentet nuk duhet të jenë më të vjetra se 6 muaj, ndërsa parashtrihen në origjinal ose kopje të vërtetuara nga ofertuesi.

4. LËNDA E FURNIZIMIT

-lënda e furnizimit është e ndarë edhe atë

1. Realizim të ekskursionit treditror nëpër Maqedoni për nxënësit e klasës së nëntë në periudhë prej 30.05.2018 deri më 01.06.2018 .
2. Realizim të mësimi në natyrë prej tri ditë në Ohër për nxënësit e klasës së pestë në periudhë prej më 28.05.2018 deri më 01.06.2018

-Loji i marrëveshjes: Shërbime me pagesë me këste

5. KRITER PËR ZGJEDHJE TË OFERTUESIT MË TË VOLITSHËM

- Çmimi më i ulët për nxënësit

6. AFATI DHE MËNYRA E PARASHTRIMIT TË OFERTAVE

-Ofertat duhet të parashtrihen në afat prej 5 ditëve të punës nga publikimi i fundit në dy gazeta, në arkiv ose përmes postës në adresën SHFK "Toli Zordumis" rr. "Boro Prcan" nr. 38 1300 Kumanovë.

-Ofertuesi e parashtron kopjen origjinale në zarfë e brendshëm të vulosur që përmban emrin e ofertuesit me tërë adresën e saktë.

Zarfë i brendshëm parashtrihet në zarfë të jashtëm të vulosur i cili:

- Është i adresuar me adresë të saktë të organit kontraktues,
- Në këndin e epërm të majtë qëndron shenja "mos hap", të mos hapet para kohe dhe data për hapjen e ofertave.

Nëse të gjitha zarfet nuk janë të vulosura dhe të shënuara siç kërkohet, organi kontraktues nuk merr përgjegjësinë për humbje ose hapje të parakohshme të ofertës.

-Periudha e validitetit të ofertave: deri më 01.06.2018.

Hapja e ofertave do të realizohet nga ana e Komisionit për realizim të ekskursionit.

Nga Komisioni për realizim të ekskursionit

I. Nr. 324/2014

SHPALLJE PUBLIKE

(në bazë të nenit 46-b, të Ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për përbarim, Gazeta Zyrtare nr. 8 të datës 17.01.2008)

Përbaruesi Vanço Markovski duke vepruar me propozim të kreditorit Eshref Ajruli, përmes aut. avokatit Branko Trajkovski nga Tetova dhe vendbanim në rr. Drenoc – Poroj nr. 8, kundër borxhitul Husein Memedi nga Tetova me vendbanim në rr. Lubo Bozhinovski Pish nr. 69, dhe borxhitul pengmarrës Imer Shaqiri nga Tetova me vendbanim në rr. Lubotenska nr. 69 në Tetovë, për shkak të realizimit në holla në shumë prej 24.600,00,00 denarë më datë 23.04.2018

FTON

Borxhliu pengmarrës Imer Shaqiri nga Tetova me vendbanim në rr. Lubotenska nr. 69 në Tetovë të paraqitet në zyrën e përbaruesit Vanço Markovski në rr. Ilindenska nr. 64 Tetovë, për parashtrim të akteve në vijim:

- Procesverbal për shlitje të dytë të pronës së patundshme përmes ankandit publik me gojë I. nr. 324/2014 të datës 26.02.2018;
- Konkluzion për shlitje të patundshmerisë në ankandin publik me gojë I. nr. 324/2014 të datës 27.02.2018;
- Procesverbal I nr. 321/2014 të datës 02.03.2018, të përpiluar në bazë të nenit 84 paragrafi 8 të LP;
- Konkluzion për shlitjen e realizuar I nr. 324/2014 të datës 16.03.2018;
- Konkluzion për dhënie në pronësi I nr. 324/2014 të datës 21.03.2018;
- Konkluzion për anulim të përbarimit I nr. 324/2014 të datës 04.04.2018;
- Konkluzion për përcaktimin e kohës së ndarjes I. nr. 324/2014 të datës 20.04.2018;

NË AFAT PREJ 1 (NJË) DITE, duke llogaritur nga dita e publikimit të fundit të kësaj thirrje publike në shtypin ditor.

PARALAJMËROHET borxhliu pengmarrës Imer Shaqiri se mënyra e këllëje e dorëzimit llogaritet si dorëzim në rregull dhe se për pasojat negative që mund të dalin i bartë vet pala.

Kjo shpallje paraqet **PUBLIKIMIN E TRETË** të thirrjes publike

PËRMBARUES
Vanço Markovski

Në bazë të nenit 126 pika 1 alineja 7 të Ligjit për arsim fillor ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 103/08, 48/09, 53/09,82/09, 88/09, 33/10, 112/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 61/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, dhe 67/17), Vendimi nr. 09-1471 të dt. 22.03.2018 nga Kryetari i Komunës – Strugë, Këshilli i shkollës pranë Shfk. "Nuri Mazari" fsh. Dologozhdë publikon:

SHPALLJE PUBLIKE

Për zgjedhjen e DREJTORIT të shkollës me mandat katër vjeçar

Kandidatët të cilët do të paraqiten në shpallje publike përveç kushteve të parapara me ligjin për arsim fillor , të kenë të kryer arsimin sipëror të plotësojnë kushtet për arsimtar dhe bashkëpunëtor profesional dhe kanë përvojë pune 5-vjeçare në veprimtari edukativo-arsimore , dhe kanë dhënë provimin për drejtor ,në momentin e emërimit me vendim gjyqësor të plotfuqishëm nuk i është shqiptuar dënimi me ndalesë për kryerje të profesionit ose veprimtarisë.

Kandidatët së bashku me lutjen të bashkëngjisin edhe dokumentacionin e nevojshëm :

- Diplomën për shkollimin e kryer;
- Certifikatë për nënshkrimin;
- Certifikatë për mosgjykim, të plotfuqishëm për veprë penale kundër dinjitetit dhe moralit.
- Vërtetim për gjendjen shëndetësore;
- Vërtetim për përvojën e punës;
- Certifikatë për dhënie e provimit për drejtor;
- Programin për punë për periudhën katërvjeçare ;
- Vërtetim për dhënie e testit psikologjik dhe testit për integritet .

Dokumentet e pakompletuara dhe jo në kohë të dorëzuara nuk do të merren parasysh.

Shpallja publike zgjat 8 ditë prej ditës së paraqitjes.

Zgjedhja e drejtorit do të bëhet në afat prej 1 muaj .

Dokumentet të dorëzohen në arkivin e shkollës nga vetë kandidatët ose me anë të postës .

Shfk "Nuri Mazari" Dologozhdë
Këshilli i shkollës ,

Në bazë të nenit 19-a dhe nenit 23 të Ligjit për Ndërmarrjet publike ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 38/96, 6/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 97/10, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15 , 61/15 dhe 64/18) dhe nenit 50 pika 9 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 5/02), Kryetari i komunës së Bogovinës paraqet:

SHPALLJE

Për pranin të një drejtori në marrëdhënie pune

- A. Për nevojat e komunës së Bogovinës , paraqitet shpallje për pranin në marrëdhënie pune një:
 1. Drejtor të NKP – "Sharri" – Bogovinë I realizues

B. Kushtet:

Kandidati përveç kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj, duhet t'i plotësojë edhe kushtet e veçanta:

- Të ketë të mara 240 kredi sipas EKTC ose të ketë të kryer arsimimin në shkollën VII/1;
- Të ketë 5 (pesë) vjet përvojë pune;

C. Shpallja është e hapur 5 (pesë) ditë nga dita e shpalljes në shtypin ditor.

Ç. Zgjedhja do të realizohet në afat prej 8 (tetë) ditësh nga dita e mbylljes së shpalljes.

D. Dokumentacioni.

Me lutjen kandidatët duhet të dorëzojnë:

-Dokument për kryerjen e shkollimit (original apo kopje e vërtetuar);

-Certifikatë për nënshkrimin të R.M.;

-Certifikatë se me vendim të plotfuqishëm të gjykatës nuk i është shqiptuar dënimi apo sanksion për kundërvajtje ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës ;

-Vërtetim për përvojë pune dhe

-Certifikatë mjekësore në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimit.

DH. Dokumentet të dorëzohen në arkivin e komunës së Bogovinës. Numër kontakti: 044/371-500

E. Dokumentet e pakompletuara si dhe ato që dorëzohen pas kalimit të afatit nuk do të shqyrtohen gjatë vendosjes.

Nr. 08-1023/1

26.04.2018 vit

Bogovinë

Komuna e Bogovinës

Kryetari

Albon Xhemali d.v.

Në bazë të nenit 82 (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/08; nr. 10/15) të Ligjit për arsim fillor dhe nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune të R. Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/15), Shkolla fillore speciale "Maca Ovçarova" nga Velesi publikon

SHPALLJE

Për plotësimin e vendeve të punës për kohë të pacaktuar të punës për vitin shkollor 2017/2018

1. Përkëdhelës me fond të plotë të orarit të punës për vitin shkollor 2017/2018 deri në.....1 realizues;

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune duhet:

- Të ketë të mbaruar shkollën e katërt të arsimit profesional shkolla e mjekësisë – fizioterapeut
- me 40 orë pune në javë, fillimi i orarit të punës është prej 07,00 deri më 15,00. Paga bazë është 16,818,00 denarë.

➤ Dokumentet e nevojshme:

Së bashku me fletëparaqitjen dorëzohet: lutje, diplomë për arsim të mbaruar dhe certifikatë të shtetësisë (jo më të vjetër se 6 muaj).

Zgjedhja do të realizohet në afat të caktuar me ligj. Dokumentet e kompletuara të dorëzohen në adresën: SHFS "Maca Ovçarova" Veles, rr. Ivo Lllolla Ribar nr. 4

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Dokumentet të dorëzohen në adresën: SHFS "Maca Ovçarova" Veles, rr. Ivo Lllolla Ribar nr. 4.

Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Telefoni për kontakt: 043/ 231 – 987

SHFS "Maca Ovçarova" Veles

Koha
E përditshme informative

<http://www.koha.mk> Search

www.koha.mk
koha@koha.com.mk
marketing@koha.com.mk
Tel: 02 3179 - 904; Fax: 02 3118 - 060;
Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovaska lok.14 - përdhësë, Shkup

Koha, e premte 27 prill, 2018



IKARDI NUK BESON SE DO TË LUAJË NË BOTËROR

Ylli i Interit, Mauro Icardi në një intervistë të dhënë për "Ole" ka thënë se nuk beson që do të luajë në Botëror. Kapiteni i zikaltërve, ka shënuar 26 gola në 30 ndeshje të Serie A këtë sezon, përfshirë katër të tillë në fitoren 5-0 ndaj Sampdorias më 18 mars. Ai u thirr në katër ndeshjet kualifikuese të Kupës së Botës në fund të vitit të kaluar, por duket që nuk është më pjesë e planit të trajnerit, Jorge Sampaoli. "Nuk ka asgjë të çuditshme, mendoj se është vetëm fakti që nuk kisha shumë minuta në fushë"- tha 25-vjeçari. Ai luajti në tre nga katër ndeshjet që u thirr me Argjentinën, për 90 minuta të plota në barazim pa gola kundër Uruguait më 31 gusht. Në barazimin 1-1 ndaj Venezuelës, më 5 shtator u zëvendësua pas 74 minutave ndërsa ndaj Perusë u la në stol pa i dhënë asnjë minutë në dispozicion. Më pas në fitoren 3-1 me Ekuadorin, u aktivizua në minutën



Unë jam 25-vjeç, për tre vite rresht jam kapiten i Interit dhe jam pjesë e klubit me golat e mi. Vazhdoj ëndërroj të luaj në Botëror, tani apo më vonë. E kam këtë qëllim. Nëse nuk ndodh tani, do të ndodhë më vonë", pohon kapiteni i Interit

e 76-të. Trajneri Sampaoli e la jashtë listës në dy ndeshjet miqësore që u zhvilluan në mars, ndaj Italisë dhe Spanjës. "Nuk e di nëse u bëra pjesë e kombëtares në kohën e duhur, për shkak të presionit që kemi pasur. Por bëra atë çfarë stafi dhe trajneri më kërkuan, dhe e vërteta është se, jam shumë i lumtur që luajta një rol në këto kualifikuese", shtoi më tej sulmuesi i Interit. Në një konferencë për shtyp, Sampaoli ka deklaruar se 80 për qind të skuadrës e ka gati për në Botëror, por kjo nuk do të thotë se lojtarët e tjerë nuk do të merren parasysh. "Unë jam 25-vjeç, për tre vite rresht jam kapiten i Interit dhe jam pjesë e klubit me golat e mi. Vazhdoj ëndërroj të luaj në Botëror, tani apo më vonë. E kam këtë qëllim. Nëse nuk ndodh tani, do të ndodhë më vonë". Icardi do të ketë shansin që të udhëtojë në Rusi me skuadrën e tij përfaqësuese, nëse Sergio Aguero

nuk do të rikuperohet plotësisht. Javën e kaluar, sulmuesi i Mançester Sinitiu nënshkrua një operacioni në këmbën e majtë. "E vetmja gjë që shpresoj është që ai të rikuperohet shpejt, sepse të gjithë duan që ai të ketë sukses dhe ai i njëjti përgjegjësitë dhe krenarinë që të jep ajo fanellë". I pyetur për lojtarët që tekniku i Argjentinës ka thirrur, ai nuk i kurseu vlerësimet ndaj tyre. "I njoh ata dhe i vlerësoj shumë si lojtarë dhe shokë. E meritojnë të jenë atje. Nëse janë zgjedhur, duhet t'i mbështesim dhe të besojmë tek ata në Kupën e Botës. Sampaoli e di që është një përgjegjësi e madhe dhe se roli ynë në skuadër ka qenë i merituar. Ai e di gjithashtu se jam i gatshëm. Në ose jashtë ekipit, do të ndihem sikur jam me shokët e skuadrës"- ka përfunduar ylli i Interit, i cili shpreson që të marrë një ftesë për Botërorin që do të fillojë më 14 qershor në Rusi.

Arsenali interesohehet për Nainggolanin

Arsenal do të kërkojë të transferojë mesfushorin e Romas Radja Nainggolan nëse punëson Luis Enrike në stolin e ekipit. Lojtari i Belgjikës vetëm së fundmi ka nënshkruar një rinovim të kontratës me Ujqërit, megjithëse shumë klube evropiane kanë kërkuar shërbimet e tij. Sipas "Sun Sport", Arsenali do të fokusohet të tundojë Nainggolan drejt Londrës nëse Luis Enrike zgjidhet për të zëvendësuar Arsen Venger sezonin e ardhshëm. Ai do të jetë 30 vjeç vitin tjetër dhe e ardhmja e tij mund të varet nga situata e "Fair Play Financiar" te Roma. Çellsit dhe Mançester Junajtedit kanë kohë që interesohen për Nainggolan, çmimi i të cilit është 50 milionë euro. Lojtarë është shprehur në mënyrë të përsëritur se mund të fitojë shumë para diku tjetër, por vlerëson jetën e tij në Romë në vend të rrugave masive.



Bellerin i mbyll derën Juventusit

Nuk do të jetë Hektor Bellerin, goditja e madhe e Juventusit në krahë. Titullari i Arsenalit, gjithashtu pranë Barcelonës, ka zbuluar se po mendon si "topçi" edhe në sezonin e ardhshëm. Në veçanti, duke folur në kanal "YouTube" të klubit, bashkë me Mertesaker dhe Holding, Bellerin pranoi: "Në verë do të kërkoj fanellën me numrin 2, drejtuesit e dinë tashmë". Në fakt,

mbrojtësi i spikatur, i cili ka rinovuar me Arsenalin deri në vitin 2023, vetëm disa muaj më parë, mban në shpinë numrin 24 të fanellës, sepse numri 2 u "pushtua" më parë nga Debushy. Për më tepër, agjenti i Bellerin zbuloi interesimin e klubeve të tjera për klientin e tij, duke konfirmuar se për momentin nuk ka pasur oferta. Dhe, në këtë pikë, ato ndoshta nuk do të arrijnë.

SEVILJA I JEP PESË NDESHJE "ULTIMATUM" Montella në "udhëkryq"

Në fund të një mbledhje që zgjati plot 5 orë e gjysmë, këshilli administrativ i Sevilja, vendosi të mos ndërhyjë, ose më saktë vendosi të presë rezultatin e ndeshjes Levante-Sevilja, që do të luhet të premten në mbrëmje, për të përcaktuar fatet e trajnerit Vincenzo Montella, i cili është në dyshim serioz pas humbjes 5-0 ndaj Barcelonës në finalen e Kupës së Mbretit. Pas vërshtimeve në "Wanda Metropolitan", ku u luajt finalja, tifozët kanë kontestuar ekipin me banderola dhe protesta para selisë së klubit, ndërsa drejtuesve nuk i ka lënë një shije të mirë vendimi i Montella për t'i dhënë 48 orë pushim ekipit, pavarësisht nga humbja, teksa personalisht ka udhëtuar për në Milano. Shtypi spanjoll mendonte se Montella do të shkarkohej dhe në pesë ndeshjet e fundit ekipi do të drejtohej nga



Zhoakiu Caparros, trajneri që fitoi Kupën UEFA me këtë ekip në vitin 2017, por bordi drejtues i mbledhur në "Sanchez Pizujan" nuk e ndryshoi situatën. Sevilja renditet në vendin e shtatë në La Liga dhe pas ndeshjes me Levante do të përballlet

me Real Madrid dhe derbin kundër Betis. Duket se të gjithë e harruan kualifikimin ndaj Mançester Junajtedit në Çampion, si pasojë e humbjeve të turpshme të kohëve të fundit dhe kësaj Montella është në udhëkryq.

PËRKUNDËR FAKTIT SE NUK SHËNOI KUNDËR BAJERNIT

RONALDO VENDOSI DY REKORDE

Ronaldo ka fituar më shumë ndeshje se çdo lojtar tjetër në këtë kompeticion, më të rëndësishmin për klubet në kontinentin tonë. Me 96, KR7 ka kaluar edhe ish-kapitenin e Real Madridit, Iker Kasilas

Rëndësia e të shënuarit nga Cristiano Ronaldo mund të ketë përfunduar të mërkurën, në "Allianz Arena", por ylli portugez i Real Madridit ende arriti të vendosë një tjetër rekord të Ligës së Kampionëve. Me triumfin e "Los Blancos", 2-1 ndaj Bayern Munich, në gjysmëfinale e parë të Ligës së Kampionëve, Ronaldo ka fituar më shumë ndeshje se çdo lojtar tjetër në këtë kompeticion, më të rëndësishmin për klubet në kontinentin tonë. Me 96, KR7 ka kaluar edhe ish-kapitenin e Real Madridit, Iker Kasilas. Marcelo dhe Marko Asensio u kujdesën për shënimin e dy golave në favor të Real Madridit të mërkurën në mbrëmje, duke hedhur një hap të madh drejt finale, me fitoren 2-1 të ndeshjes së parë gjysmëfinale. Skuadra e Zinedin Zidan, gjithashtu, vendosi një rekord si ekip, në këtë konkurrim, me fitoren në Munich. Dy herë radhazi kampionët e Evropës (në fuqi) fituan ndeshjen e 150-të në Ligën e Kampionëve, duke u bërë skuadra e parë, që e arrin këtë "shenjë". Ronaldo dhe Real Madridi do të kërkojnë t'i shtojnë të dhënat e tyre në ndeshjen e dytë, atë të kthimit, në "Santiago Bernabeu", të martën e ardhshme, kur t'i presin bavarezët e Jupp Heynkes në shtëpi.

Ndryshe, kjo ishte fitorja e 150-të e Kupës Evropiane (sot Çampionis) për "Los Blancos", një garë



që ata e konsiderojnë të tyre. Dhe kuptohet, thonë kështu, sepse e kanë fituar 12 herë, duke përfshirë tri nga katër edicionet e fundit. Sezoni e kaluar, skuadra e Zidanit mundi Bajernin në çerekfinale, edhe pse kishin nevojë për më shumë kohë në "Santiago Bernabeu", për t'u kualifikuar, pavarësisht fitores 2-1 larg, ashtu si këtë herë, në "Allianz Arena". Ndërkohë, skuadra e Jupp Henkes mendon se bëri mjaftueshëm për ta fituar ndeshjen e parë gjysmëfinale të Çampionis, por shpërdoroi raste ideale për gol. Bavarezët krijuan 17 shanse dhe shënuan një gol, ndërsa madrilenët patën 7 raste dhe shënuan dy herë. Mesatarja prej 1.75 e Bayern Munich (raste-gola) ishte më e madhja e një ekipi, që humb një ndeshje në Ligën e Kampionëve të këtij edicioni. "Opta" shikon shanset e krijuara dhe jep një numër gola sh të pritshëm për secilën palë. Bajerni e kishte këtë kuotë 2,48 të të mërkurën, ndërsa Reali vetëm 0,73. Megjithatë, ato shifra, sigurisht, nuk reflektohen nga rezultati.

Ndërkohë, pas përfundimit të ndeshjes kanë folur edhe aktorët e

saj. Kapiteni i Bayern Munich, Thomas Müller, tha se çelësi për humbjen e skuadrës së tij në shtëpi, kundër Real Madridit, ishte se të tjtë u treguan shumë naivë dhe, mbi të gjitha, nuk shfrytëzuan shanset për të shënuar. "Nëse shikoni të gjithë ndeshjen, ne ishim shumë naivë, nuk arritëm të bëjmë atë që kemi bërë në javët e fundit, duke i shfrytëzuar shanset tona, – tha Müller për mediat gjermane. – Mund të kishim një rezultat shumë më të mirë, për shkak të mënyrës se si

shkoi ndeshja. Goli i dytë erdhi nga një gabim yni individual, i pari ishte i çuditshëm, por gjëja përfundimtare është se nuk i kemi shfrytëzuar mundësitë tona", shtoi më tej sulmuesi gjerman. Përkundër humbjes, Müller beson se "ka ende shumë për të bërë në këtë raund dhe asgjë nuk është vendosur për kualifikimin". Nga ana tjetër, duke folur për "Kicker", ai pranoi se e pa Real Madridin shumë të dobët: "Ky Real Madrid është absolutisht vulnerabël, ne duhet të kemi një men-

talitet vrasës, sepse kemi mundësi reale", deklaroi Müller. Në anën tjetër, Sergio Ramos, ishte i kënaqur pas fitores së skuadrës së tij. Kapiteni nënvizoi se "e dinim çfarë do të na priste në Munich, ishte një ndeshje e mrekullueshme dhe tani duhet ta përsërisim atë në shtëpi". "Kemi luajtur në një stadium të madh dhe kemi gëzuar një lojë të madhe. Pavarësisht se kemi shënuar dy gola, ekipi ka qenë shumë solid. Jemi mbrojtur mirë dhe kemi kundërsulmuar rrezikshëm. Ndoshta njerëzit presin që ne të fitojmë 0-3, por kjo është shumë e vështirë në këtë stad të kësaj gare. Mos harroni se jemi ballafaquar me një rival të madh dhe kemi bërë një hap të konsiderueshëm përpara. Por, nuk ka përfunduar asgjë, do të luajmë kthimin në shtëpi dhe duhet të fitojmë përsëri. Të mos falim më në stadiumin tonë. Bajerni luftoi deri në fund. Ne jemi mbrojtur mirë dhe kemi arritur ta vrasim lojën me kundërsulm. Rezultati i madh për kthimin? Besoj se në jetë, gjithkush mëson më shumë nga përvojat e këqija, se nga ato të mira. Ky kompeticion kërkon shumë përqendrim, sepse çdo gabim të nxjerr jashtë. Ndeshja e kthimit do të jetë e vështirë, por ne kemi diçka ekstra, sepse luajmë në shtëpi, me tifozët tanë", deklaroi Ramos.

BOATENG DO TË MUNGOJË NË "BERNABEU"

Zherome Boateng nuk do të luajë në ndeshjen gjysmëfinale të kthimit të Ligës së Kampionëve, kundër Real Madridit. Në fakt, ai do ta humbasë të gjithë sezonin. Madje, edhe prania e tij në Kupën e Botës së kësaj vere në Rusi është në rrezik. Kjo është zbuluar nga "Sport Bild", që raporton se qendërmbrojtësi i Bajernit, i cili doli nga fusha i lënduar pas 30 minutash në ndeshjen kundër të bardhëve në "Allianz Arena", duke vuajtur një dëmtim të muskujve, i cili parashikohet ta lërë jashtë fushave për katër deri në gjashtë javë. Në minutën e 30-të të ndeshjes kundër Real Madridit, qendërmbrojtësi u largua nga fusha e lojës i mbështetur nga mjekët, duke çaluar. Në fund të



ndeshjes, ndjenjat e lojtarit dhe stafit stërvitor nuk ishin të mira. Problemet e muskujve nuk janë të reja për Boateng, i cili është detyruar të ndalojë për këtë lloj lëndimi në disa raste. Herën e fundit, nga maji deri në shtator 2017.

PAS HUMBJES KUNDËR NAPOLIT

Tifozët qortuan futbollistët e Juventusit

veçanti, sipas asaj që raportoi "La Gazzetta dello Sport", tifozët nuk e kishin marrë mirë dështimin e së dielës në mbrëmje dhe në këtë gjë ka ndikuar mosshkuarja e lojtarëve për t'i përshëndetur pas humbjes me Napolin. "Ne ishim duke pritur, ju përshëndetët napolitanët, por nuk erdhët te ne: Pse?", – kanë pyetur ultrasit bardhezinj. Kapiteni Buffon nuk ka vonuar dhe ka kërkuar falje disi: "Ne gabuam, por ishim edhe të zemëruar, ndaj nuk

erdhëm të përshëndeteshim si zakonisht". Pra, portieri, siç është raportuar nga "Il Corriere della Sera", pranoi: "Fakti që jeni këtu, është një shenjë e rëndësishme. Ju keni bërë shumë mirë. Nëse jemi në këtë situatë, ndodh për shkak se diçka të gabuar bëjmë. Të jetë krenarë për ne, deri në fund. Unë u ndala për të përshëndetur lojtarët e Napolit, sepse në pjesën e parë, shumë prej tyre na përgëzuan për fitoren tonë. Ata ishin më të uritur,

ndaj edhe fituan", shtoi më tej Buffon. Përveç Buffonit, edhe Kiellini, Markisio e Dybala kishin një bisedë të shkurtër me ultrasit, të cilët përsëritën për të gjithë sa e rëndësishme është për mjedisin që të fitojnë titullin e shtatë radhazi në Serie A. Tani, mbështetësit e "Zonjës së Vjetër" duhet të presim përgjigjen e lojtarëve në fushë, duke filluar nga ndeshja e madhe e së shtunës në mbrëmje, ndaj Interit, në "San Siro".



25 prilli ishte disi ndryshe nga ditët e tjera në "Vinovo", ku një grup ultrasish demonstruan në mënyrën e tyre para qendrës sportive të Juventusit, për ta nxjerr ekipin, pas

humbjes në ndeshjen kundër Napolit. Por, tifozët ishin aty edhe për t'i qortuar lojtarët e Juventusit, edhe pse klima ka mbetur e relaksuar dhe pa asnjë incident. Në



DASHI 21. mars - 20. prill

Përkundër angazhimeve sot ju do të gjeni një mënyrë për t'ja kushtuar vetes dhe për të rindezur pasionin e fshehur. Rigjallëro marrëdhënien me disa surpriza, partneri/ja do t'i mirëpresë! Nëse jeni vetëm dhe kërkoni dashuri, duhet ta lini zemrën të hapur ndaj ndjenjave. Sfera profesionale është e kënaqshme dhe sot gjithçka do të zhvillohet pa probleme.



DEMI 21. prill - 21. maj

Ju jeni të rrethuar nga njerëz që ju duan dhe që ju tregojnë me gjeeste që jeni në vëmendjen e tyre. Dashuria, megjithatë, duhet të jetë reciproke! Për beqarët yjet premtajn ditë pozitive, periudha është padyshim shumë e qetë. Në punë dikush do t'ju merrisë dhe ndjeshmëria juaj do të vihet në provë. Mos u përfshini.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Yjet ju përkrahin, edhe pse nganjëherë do të tundoheshit të hiqnit dorë. Dashuria kalon nëpër një periudhë jo shumë të lulëzuar dhe kjo ju dekurajon pak. Ndërsa beqarët nuk e kanë për momentin dashurinë prioritet. Ju do të jeni në gjendje të gjeni armët për të luftuar dhe për të arritur qëllimet tuaja në punë. Bashkëpunime të reja në horizont.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Një situatë e veçantë sentimentale ju bën të rriteni. Dashuria ndihet pak, e kësaj melankolie të përzier me humor të keq, ata përreth jush do të mundohen të kuptojnë se çfarë po ju ndodh. Zemrat e vetmuara sot do të duhet të përqendrohen në gjëra me të vërtetë të rëndësishme. Caktimet e reja të punës do të nxjerrin në pah cilësitë tuaja dhe do t'ju lejojnë të përparoni.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Është një periudhë e emocioneve të mëdha, dashuria është e zjarrtë, edhe pse me disa grindje të vogla. Ju do të vazhdoni të jeni aktiv! Do të ketë takime dhe mundësi të reja për beqarët, ju do të jeni të hapur dhe në dispozicion për aventura të reja. Nuk jeni shumë të fokusuar dhe nuk mund të ballafaqoheni me probleme të caktuara me qartësi dhe ftohtësi.



VIRJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Dashuria, pasioni dhe optimizmi duket se karakterizojnë këtë ditë, port të kujdesshëm siç jeni ju nuk mund të besoni se gjithçka është e vërtetë. Edhe beqarët do të bëjnë aq shumë pushtime, sot ata do të vënë shigjeta të ndryshme në harkun e tyre! Në punë do të përballeni me çdo problem me një buzëqeshje, asgjë nuk ju frikëson dhe jeni më këmbëngulës se kurrë!



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Ju po kaloni një periudhë sfiduese, por jeni duke bërë mirë. Gjendja përmirësohet dhe madje edhe nëse dashuria nuk zbulon shumë pasion, jeni të sigurt se është i pranishëm. Beqarët do të duhet të kenë më shumë besim dhe do të bindin veten se herët a vonë dashuria do të vijë. Në punë ruani qetësinë dhe kaloni çdo problem pa u përfshirë në debate!



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Dita do të rrjedhë pa asnjë lajm të veçantë në dashuri, dhe ndoshta për këtë arsye filloni të tregoni shenja të padurimit. Mundohuni të merrni disa çaste pushimi. Beqarët duhet të mësojnë të presin për dashurinë e vërtetë. Marsi i vendosur dhe i vazhdueshëm do t'ju kërkojë të mbani angazhimet e vendosura. Pak më shumë qëndrueshmëri në punë nuk do t'ju dëmtonte.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Periudha pozitive vazhdon për ju, problemet duket se janë zgjidhur. Dashuria bën mrekulli! Beqarët mund të vendosin për të kompensuar kohën e humbur dhe të vihen në kërkim të shpirtit të tyre binjak! Mos e vononi fillimin e një projekti që keni përzemër, është koha të pohoni ambiciet tuaja.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Kjo është një periudhë shumë pozitive edhe për dashurinë, ju keni sy vetëm për të dashurit tuaj. Plane për udhëtime parashikohen në horizont! Zemrat e vetmuara do të shpërblehen me takime interesante dhe njohje të reja. Jini të kujdesshëm në zgjedhjet tuaja të punës, përpikuni të krijoni investime dhe bashkëpunime sa më mirë që mundeni që të keni sukses.



UJORI 21. janar - 19. shkurt


Dashuria ju fut kaq shumë në mendime, por gjithashtu ju bën të ndiheni mjaft mirë! Duket si një kontradiktë por nuk është, është vetëm një moment kur mund të vendoseni mes dy zjarreve. Beqarët do të duhet të përpiqen të mos izolojnë veten, edhe nëse për ta kjo nuk është një periudhë e mirë! Yjet rekomandojnë të presin përpara se të marrin një vendim që mund të jetë vendimtar për punën tuaj.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Sot do të ketë shumë risi për Peshqit, dhe gjithashtu disa diskutime me partnerin/en do të përsëriten. Gjeni një pikë pajtimi dhe mos pretendoni të kuptoni. Beqarët do të duhet të vendosin se në cilin drejtim duhet të shkojë, madje edhe nëse do jenë kundër rrymës. Duke ecur përpara drejt qëllimeve që keni dëshiruar, nuk keni alternativë dhe ka ardhur koha për të vepruar.

POLITIKANI PALESTINEZ, MASRI	M	NALLANE	KANJON AFËR SHKUPIT	M	REJA RUMANIA	N	MBRETERI (VJET.)	R	POLITIKANI SHQIPTAR, FATOS	KOMPOZITORI YNË NË FOTO
MBIEMRI DHE EMRI I GAZETARES SHQIPTARE (SHQIP)			GARI NEVILL				FILM I KOMPOZUAR NGA PERSONI NË FOTO			
XH										
QYTET NË FRANCË					AKTORI AMERIKAN, XHORXH SHKRONJAT E PARA					
I SËMURË (ANG.)			LLOJ KROKODILI (SH. PASHQ.)							
			LITRI							
KOMPOZITOR HUNGAREZ										



Mensur Mamuti	PJESË E SHTEPISË, PËR KALIMIN E TYMIT	ISH FUTBOLLISTI KROAT, XHOVANI	LLOGARI NORVEGJIA	H	SHKOP PËR MBËSHETJE, PATERICA					
					NGJYRË LETRASH BIXHOZI					
AKTORJA ITALIANE, MUTI							ERSONAZH NGA MAHABHARATA			
							RADIO TELEVIZIONI ITALIAN			
POLITIKANI AMERIKAN, BAIDEN			QYTET ITALIAN (FESTIVALI I KENGËS)							
			TONI MONTANA							
MATERIAL I MBRENDSHËM RROBASH							NËNË (KRAHIN.)			REOMIRI
							ZORRO			
PROFESIONI I PERSONIT NË FOTO										

ZGJIDHJET: M, M, N, R, KHUNGA RUDINA, NANT, SIGAL, ILL, KAJMANE, BELA BARTOK, IË, S, I, PA, FLIN, MURAD, N, NË, DIOR, IM, L, H, SHTAKA, ORNELA, NAL, XHO, SAN REMO, ASTAR, ANE, KOMPOZITOR.

Shumë i lehtë **Sudoku** **mesatar**

	5			9		4		3		7		6		5		8
1				2			8			1	4			7		
	8	3				1	9						5			4
6	3			9									6		7	3
				1	5	7						1				
				8						4	3			6		
	7	2				6	1						1			2
3				4						9	7			3		
	6			9			3			2	8		5	9		7

Shumë i lehtë: 756819342, 149362578, 283745196, 635294781, 824157963, 917683254, 472538619, 391476825, 568921437. Mesatar: 347169528, 521438796, 896275134, 182596473, 673814259, 954327681, 735941862, 469782315, 218653947.

Imami nga Kosova në mesin e 100 personaliteteve me më ndikim në Nju Jork

Imami shqiptar nga Kosova, Tahir Kukaj është renditur në mesin e 100 personaliteteve me më ndikim në Staten Island të Nju Jorkut. Ai konsiderohet si një udhëheqës ndërfaqës që ka bërë një karrierë të bujshme duke ndërtuar ura të mirëbesimit mes popujve dhe etnive me religjione të ndryshme. I lindur në fshatin Terstenikë të Drenasit, imami Kukaj ka shkuar në Staten Island në vitin 2002 për të drejtuar Shkollën Islame Miraj. Atje ai është bërë edhe udhëheqës i Qendrës Kulturore Islamike Shqiptare. Kukaj, tash e 15 vjet njihet për programin e veçantë të tij pasi një herë në vit organizon një takim ku zhvillohet dialog mes komunitetit katolik dhe atij mysliman, e që përfundon me një dark të përbashkët. Në mesin e personaliteteve tjera që janë nderuar nga Staten Island ka zyrtarë qeveritarë, udhëheqës të kujdesit shëndetësor, të atij bankar e të pasurive të patundshme, akademikë, gazetarë, avokatë dhe aktivistë të ndryshëm. Imami nga Kosova para një muaj ka marrë lëndat



dhe nga kryetari i Nju Jorkut, Bill de Blasio për kontributin që po jep Qendra Kulturore Islamike Shqiptare në kultivimin e mirëkuptimit dhe tolerancës ndërfaqës në Nju Jork, shkruan AktivPress. Nëpërmjet Komisionarit të Policisë së Nju Jorkut, ai e ka përcjell një mirënjohje,

duke e cilësuar këtë Qendër si një qendër me shumë influencë. Në mirënjohje, ai ka theksuar se komunitetet fetare janë shtylla kryesore e forcimit të shtetit. Me iniciativën e Qendrës Islamike Kulturore Shqiptare, de Blasio e ka shpallur muajin prill si muaj të komuniteteve fetare.



Transplanti i parë i suksesshëm i penisit!

Operacioni doli me sukses! Realizohet transplanti i parë i penisit, ndaj një ish ushtari luftar në Afganistan, i cili kishte humbur penisin dhe këmbët, si pasojë e shpërthimit të një bombe. Ndërhyrja zgjati 14 orë, ndërsa u zhvillua dy javë më parë në Johns Hopkins University Hospital, të Baltimora, SHBA, por rezultatet e tij u prezantuan vetëm gjatë kësaj të hëne. "Pacienti është mirë dhe do të kthehet në shtëpi pas disa javësh. Në sajë të një dhuruesi, kirurgët të drejtuar nga Andrew Lee realizuan me sukses, ndërhyrjen e parashikuar prej kohësh", thuhet në deklaratën e spitalit. Specialistët presin që funksionet urinare të rikthehen së shpejti, ndërsa për ato seksuale, duhet pritur gjashtë muaj.

Porsche bën revolucion, e sjell super modelin "MISSION E"

Marka e njohur e makinave luksoze, Porsche do të lansojë modelin e saj të fundit ku pritet të sjellë revolucion për sa i përket makinave të së ardhmes. Ajo quhet "Mission E" dhe do të jetë makina e parë e gjitha elektrike e Porsche. Mësohet se kjo

makinë do të shkojë nga 0 në 100 km/h për 3,5 sekonda dhe arrin një shpejtësi maksimale prej 250 km/h. Porsche Mission E do të prezantohet në fillim të vitit të ardhshëm, ndërsa klientët mund ta kenë në garazh në fund të vitit 2019.



"Pi shumë alkool dhe krijon mjedis negativ", TRUMP E ZË BELAJA ME MJEKUN

Presidenti Donald Trump thotë se ia ka lënë në dorë mjekut të Shtëpisë së Bardhë, Admiralin Ronny Jackson, nëse do të pranojë emërimin si Sekretar i Çështjeve të Veteranëve pasi kanë dalë akuzat serioze ndaj tij për akte të papërshtatshme ose të paligjshme personale dhe profesionale. Presidenti thotë se pas këtyre akuzave, atij nuk ka ç' duhet ky post. "Unë nuk do ta pranoja. Përse? Që të

abuzohem nga një tufë politikanësh që nuk duan t'ia dinë për vendin? Nuk duhet ta pranojë emërimin, mendoj unë, por ai e ka vetë në dorë," tha presidenti. Trump i bëri komentet disa orë pasi senatorët shtynë pa afat seancën dëgjimore për konfirmimin e zotit Jackson që ishte planifikuar për të mërkurën. Senatorët po analizojnë pretendimet e ngritura kundër kandidatit për sekretar të Çë-

shtjeve të Veteranëve se ai kishte krijuar një mjedis tepër negativ e të tensionuar pune në Shtëpinë e Bardhë dhe se pinte shumë alkool. Emërimi i Ronny Jackson, aktualisht mjeku i presidentit në Shtëpinë e Bardhë, zgjoi kritika të shumta si rezultat i mungesës së eksperiencës në detyra menaxhuese për një rol udhëheqës si sekretar i Çështjeve të Veteranëve në agjencinë e dytë më të madhe të qeverisë amerikane me 377 mijë punonjës, shkruan VOA. Ronny Jackson u zgjodh për të zëvendësuar David Shulkin, sekretar i mëparshëm i Çështjeve të Veteranëve i emëruar nga Presidenti Obama, i shkarkuar nga Presidenti Trump.

1124 – Davidi I shpallet mbret i Skocisë

1296 – Beteja e Dunbarit – Skocezët munden nga Eduardi I i Anglisë

1509 – Papa Juliusi II shkishëron shtetin italian të Venedikut

1522 – Beteja e Bikaçës: Çarls I dhe Papa Adriani VI mundin Francën

1662 – Holanda dhe Franca nënshkruajnë marrëveshje ushtarake

1805 – Marinsat amerikan sulmojnë brigjet e Tripolit

1870 – Hajnrih Shljajman zbulon Trojën

1909 – Bie nga fronti Sulltan Abdul Hamidi II i Turqisë

1941 – Trupat gjerman okupojnë Athinën

1945 – Partizanët italian kapin Mussolinin

1961 – Sierra Leone shpall pavarësinë nga Britania e Madhe

1972 – Apollo 16 kthehet në Tokë

1978 – Revolucioni afgan (Dita kombëtare)

2005 – Aeroplani Suberxhambo Airbus A380 nis fluturimin e tij të parë nga Tulusi, Francë

2006 – Fillon ndërtimi i Ndërtesës së Lirisë si Qendra e Re Tregtare Botërore në Nju Jork Siti.

KALENDARI HISTORIK 27 PRILL

Kangurët për herë të parë u paraqitën në kontinentin e Australisë. Në fillim u quajt Kanguru, që në gjuhën e vjetër australiane i bie si kafshë kërcimtare. Sot, kemi kangurë në vende të ndryshme të botës.



Kur flitet për duhanin, menjëherë mendojmë për dëmtimin e shëndetit që ai na bën.

Pikërisht, duhani u soll pas luftës së dytë botërore nga SHBA-të në Europë. Nikotina (helm përbërës i duhanit) emrin e mori nga një diplomat francez Jean Nicote, i cili e zbuloi atë dhe në nder të tij e mori edhe emrin Nikotinë.



ERDHA NË PUNË

Vjen polici i Maqedonisë nudo në stacion. E takon eprori edhe e pyet: - Pse more ke i zhveshur i tëri. Polici duke belbëzuar, fillon të arsyetohet: - Ishim në një party (aheng). Në një moment, një vajzë tha: "Të gjitha femrat le të zhvishen". Dhe u zhveshën të gjitha! Pas pak tha: "Të gjithë meshkujt le të zhvishen". Dhe u zhveshëm edhe meshkujt. Nuk kaloi shumë kohë, e fiki dritën e tha: "E tash, në punë...". Dhe unë erdha në punë!



Harku moral i universit përkulet para drejtësisë. (Martin Luther King Jr)

A E DINI SE...

BARSOLETA

THËNIA E DITËS